

RAPORT TEKNIK

KONFLIKTI NUK NA KA SJELLË LULE

Nevoja për reparacionet
gjithëpërfshirëse për të mbijetuarit
e dhunës seksuale që ndërlidhet me
konfliktin në Kosovë



RAPORT TEKNIK

KONFLIKTI NUK NA KA SJELLË LULE

Nevoja për reparacionet
gjithëpërfshirëse për të
mbijetuarit e dhunës
seksuale që ndërlidhet me
konfliktin në Kosovë



UN WOMEN

Prishtinë, korrik 2016



PËRMBAJTJA

FALENDËRIMET	5	A.Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës	53
SHKURTESAT DHE AKRONIMET	6	B. Për Qeverinë e Kosovës dhe institucionet jo-qeveritare dhe palët e përfshira	53
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7	C. Rekomandimet për Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës Çlirimtare të Kosovës	57
I. HYRJE DHE METODOLOGJIA	11	SHTOJCAT	58
A. Hyrje	11	Shtojca I: Përmbledhje e nismave reparative për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë	58
B. Metodologjia	13	Shtojca II: Përmbledhje e përfitimeve sipas ligjit nr. 04/L-054 dhe ligjit nr. 04/L-172	61
II. REPARACIONET PËR DHUNËN SEKSUALE QË NDËRLIDHET ME KONFLIKTIN: PËRKUFIZIMET, KORNIZA LIGJORE, SFIDAT DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA	17	Shtojca III: Lista e palëve të interesuara që janë konsultuar	61
A. Përkufizimet	17	Shtojca IV: Lista e dokumenteve kyçe të konsultuara	66
B. Korniza ligjore	19		
C. Sfidat për hartimin e reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin	20		
D. Praktikrat më të mira për qasje në reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin	22		
III. REPARACIONET PËR DHUNËN SEKSUALE QË NDËRLIDHET ME KONFLIKTIN NË KOSOVË	29		
A. Nismat aktuale të reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë	31		
B. Perspektivat e të mbijetuarve ndaj reparacioneve	39		
IV. REKOMANDIMET PËR NJË PROGRAM GJITHËPËRFSHIRËS TË REPARACIONEVE PËR VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE QË NDËRLIDHET ME KONFLIKTIN NË KOSOVË	53		

FALENDËRIMET

UN Women shpreh mirënjohjen për të mbijetuarit e dhunës seksuale, që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë, të cilët ndanë kohën, energjitë dhe ekspertizën e tyre për të bashkëpunuar dhe për të prodhuar këtë raport. Raporti ka për qëllim ti sjellë përpara zërat dhe kërkesat e tyre për reparacionet gjithëpërfshirëse dhe në kohë të duhur.

UN Women dëshiron të falenderoj organizatat dhe individët e përfshirë në hartimin e këtij raporti. Falënderim i veçantë shkon për autoren e raportit, Siobhan Hobbs. Po ashtu falënderimet shkojnë edhe për institucionet e Kosovës, zyrtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, veçanërisht për Presidenten e katërt të Kosovës Atifete Jahjaga, dhe për anëtarët e Këshillit Kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, për bashkëpunimin e ngushtë dhe mbështetjen e ofruar.

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk duhet të mirren në asnjë mënyrë si mendim zyrtar i Bashkimit Evropian.

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

DFDIL	Departamenti i Familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të Luftës
DhSNK	Dhuna seksuale që ndërlidhet me konfliktin
EULEX	Misioni i Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
Forumi ShCP	Forumi Shërbimi Civil Paqësor
GPNMBKP	Grupi Punues Ndërmintrosor për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtim
GPS	Gratë, Paqja dhe Siguria
KEGJFD	Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit Morocco's Equity and Reconciliation Commission (Acronym from French title: Instance Equité et Réconciliation)
Këshilli Kombëtar	Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
KMBP	Komisioni i Marokut për Barazi dhe Pajtim (KMBP) (Akronimi nga titulli frëngjisht: Instance Equité et Réconciliation)
KPVP	Komisioni për Pranim, të Vërtetën dhe Pajtimin (KPVP) në Timorin Lindor (Akronimi nga titulli në portugalisht: Comissão de Acolhimento, Verdade e Reconciliação)
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OHCHR	Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OShC	Organizatë e shoqërisë civile
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
TÍKA	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim
UÇK	Ushtra Çlirimtare e Kosovës
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSCR	Rezoluta e Këshilit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
USAID PRP	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar Programi i të Drejtave Pronësore

PËRMBLEDHJE

EKZEKUTIVE

Dhuna seksuale e ndërlidhur me konfliktin në Kosovë është sekret publik. Në vitet e para pas konfliktit në hapësirën publike ka patur raporte të pakta mbi dhunën seksuale, ndaj grave shqiptare, të kryer nga policia dhe forcat paraushtarake serbe. Aty nga mesi e deri në fund të viteve 2000, pëshpërma për dhunë seksuale ndaj grupeve të tjera etnike të Kosovës, romëve, ashkalinjve, egjiptianëve dhe serbëve; si dhe ndaj burrave dhe djemve kosovarë, janë dëgjuar në dhomat e pasme të organizatave që ofrojnë mbështetje për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Ofruesit e shërbimeve, grupet e grave të shoqërisë civile dhe akterët politikë, me kalimin e kohës, e kanë theksuar shfaqjen e dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë, duke sjellë vetëdijësimin publik dhe veprimin politik për nevojat e viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, gjatë konfliktit në Kosovë.

Të mbijetuarit e dhunës seksuale, që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë, ende sot përballen me sfida të mëdha. Perceptimet ose qëndrimet aktuale të komunitetit ndaj viktimave të dhunës seksuale kanë çuar në disa vdekje të shkaktuara nga vetëvrasja. Një numër shtesë, i vogël i tyre, ka vdekur si pasojë e dhunës në familje, të kryer kundër viktimave, në emër të nderit. Frika nga dhuna dhe nga stigma ka penguar shumë persona të kërkojnë shërbime. Qasja në shërbime shëndetësore, punësim, (ri)edukim dhe shërbimet e (ri)aftësimit është mjaft e vështirë për shumicën, veçanërisht për ata që ndodhen në zonat ku aktualisht nuk ka shërbime nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat ofrojnë shërbime shëndetësore dhe aktivitete të gjenerimit të të ardhurave në shkallë të vogël. Nevojat e atyre që janë identifikuar si të mbijetuar të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, nuk janë të njëjta. Qasja në kujdesin shëndetësor dhe në mjetet financiare janë përparësitë kryesore për shumë persona, megjithatë, të vejat, nënat ve-

tushqyese dhe ata që janë të martuar me persona të lënduar gjatë luftës apo me persona me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi shtesë. Të mbijetuarit me fëmijë përqendrohen kryesisht në aftësinë e tyre për ti ushqyer dhe për ti edukuar fëmijët, me shpresën se mund të ofrojnë një jetë më të mirë për ata.

Në vitet e fundit janë bërë përpjekje të mëdha nga shumë palë në Kosovë, për të përkrahur të drejtat e të mbijetuarve për reparacion dhe për të adresuar nevojat e tyre. Nga struktura inovative, si ajo e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë (Këshilli Kombëtar), e cila ka për qëllim identifikimin e nevojave të menjëhershme që të mbijetuarit kanë, tek entuziazmi i shoqërisë civile dhe deputetëve të Kuvendit që kërkojnë njohjen legjislative të të mbijetuarve, tek gatishmëria e autoriteteve qendrore dhe ministrive përkatëse që të përfshihen në proceset të cilat ju sjellin përfitime të mbijetuarve, deri tek liderët kryesorë të nivelit lokal të cilët tregojnë mbështetje publike për të mbijetuarit. Aktivitetet dhe nismat e deritanishme kanë demonstruar kapacitetin dhe vullnetin e autoriteteve kosovare për t'iu përgjigjur nevojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Megjithatë, të mbijetuarit kanë pasur përfshirje të kufizuar në këto aktivitete, nisma dhe procese, pasi që kërkesat e tyre për konfidencialitet dhe anonimitet shpesh janë interpretuar si tregues i dëshirës së tyre për të mos u përfshirë. Jashtë organizatave që i ndihmojnë ata, të mbijetuarit nuk kanë ndonjë hapësirë ku të ndajnë pikëpamjet e tyre mbi këto çështje, ose të marrin pjesë në proceset përkatëse të vendimmarrjes.

Një hap i parë i rëndësishëm, drejt garantimit të së drejtës së të mbijetuarve për reparacion, është ndërmarrë me miratimin e kornizës legjislative për të siguruar reparacionet për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me

konfliktin. Janë ndërmarrë hapa për zbatimin e kornizës ligjore dhe krijimin e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës (Komisioni). Stafi i sekretariatit të Komisionit është përzgjedhur, dhe proceset për të përzgjedhur dhe për të trajnuar anëtarët e Komisionit, stafin e sekretariatit dhe zyrtarët e autorizuar të shoqërisë civile dhe qeveritarët lokal është në proces e sipër. Megjithatë, hapa të tjerë kritik, siç është publikimi i ftesës për anëtarët e Komisionit që e mundëson zgjedhjen e tyre dhe një vendim i qeverisë për shumën e kompensimit që do t'ju ofrohet të mbijetuarve të verifikuar, po priten me padurim. Është me rëndësi që korniza aktuale ligjore të zbatohet shpejtë dhe të ndërmerren të gjitha proceset e nevojshme për ta bërë Komisionin funksional dhe në gjendje për të shpërndarë përfitimet aktualisht të akorduara sipas ligjit, për ti siguruar të mbijetuarit se përmbushja e të drejtave të tyre është një prioritet për qeverinë.

Në lidhje me ndërmarrjen e proceseve të përshkruara aktualisht me ligj janë rekomanduar disa ndryshime në kornizën ligjore për të siguruar se Komisioni mund të funksionoj pa diskriminim, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, dhe se mund ti plotësoj nevojat e të mbijetuarve. Këto ndryshime nuk duhet të ngadalësojnë ose në çfarëdo mënyre të pengojnë krijimin e Komisionit. Këto përfshijnë: korigjimin e dallimeve të përkthimit mes versioneve shqip, serbisht dhe anglisht të ligjit nr. 04/L-054 për të siguruar se përcaktimi i përfituesve është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare (ndryshuar me ligjin nr.04/L-172.); duke u siguruar që të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin janë të përjashtuar nga testi i invaliditeti (jo vetëm të mbijetuarit e dhunimit); dhe ndryshimin e afatit kohor për akte të dhunës seksuale, për ti përfshirë edhe aktet e dhunës seksuale që kanë ndodhur teksa po shkohej në konflikt dhe pas përfundimit formal të armiqësive, menjëherë pas konfliktit të armatosur.

Më tutje rekomandohet që dispozitat aktuale, në pajtim me ligjin nr. 04/L-054, të jenë të plotësuara për të siguruar që shumëllojshmëria e nevojave të të mbijetuarve mund të plotësohet

për t'ju mundësuar atyre që ta rindërtojnë jetën e tyre. Të mbijetuarit kanë nevojë për qasje në kujdesin shëndetësor në Kosovë si dhe kanë nevojë për (ri)arsimim dhe mundësi të punësimit. Për më tepër, duke ju siguruar të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, përfitimet që u takojnë grupeve të tjera, mund të ulët rrezikun që ata të identifikohen si të mbijetuar të dhunës seksuale, t'ju plotësohen nevojat e ndryshme, dhe të shmangët dërgimi i mesazhit së vlerës dalluese të vuajtjes.

Ndërkohë të mbijetuarit kryefamiljarë dhe ata me fëmijë kanë nevoja të veçanta shtesë. Përfitimet, siç është qasja në arsim dhe shëndetësi, aktualisht nuk janë në dispozicion për fëmijët e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, edhe pse ata kanë nevojë të jashtëzakonshme për këto shërbime. Në shumë raste të mbijetuarit e vlerësojnë fatin e fëmijëve të tyre më shumë se të vetin. Disa ndjehen fajtorë për vuajtjet, të cilave u janë nënshtruar, ngase kjo ka ndikuar në aftësinë e tyre për t'ju siguruar fëmijëve të tyre një të ardhme më të mirë. Ofrimi i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore për fëmijët e të mbijetuarve, është i dobishëm për të mbijetuarit, si dhe për ata fëmijë që janë të prekur si viktima indirekte të dhunës së përjetuar nga njëri ose të dy prindërit e tyre. Po ashtu, kjo është një mënyrë për tu siguruar që fëmijët e lindur nga dhunimi janë të përfshirë në masat e reparacionit, por që nuk janë të veçuar si fëmijë të lindur nga dhunimi. Sigurimi i qasjes në shërbime, për fëmijët e të mbijetuarve, po ashtu mund ta ulët rrezikun e diskriminimit mes gjeneratave dhe atë të stigmatizimit.

Reparacionet sigurojnë njohje për viktimat, jo vetëm si viktima, por edhe si mbajtës të drejtave. Njohja simbolike e shkeljes së të drejtave të tyre mund të shërbejë si vendosje në vend e të drejtave të tyre të barabarta si qytetarë dhe dërgon një mesazh të përkatësisë dhe dinjitetit për të dyja palët, si për të mbijetuarit ashtu edhe për komunitetin. (Ish) Presidentja Jahjaga ka bërë përpjekje të mëdha për të njohur shkeljen e të drejtave dhe vuajtjet e viktimave të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, megjithatë është e rëndësishme, për rindërtimin e besimit qytetar mes të mbijetuarve dhe qeverisë, që të

mbijetuarit të marrin njohjen zyrtare nga Kuvendi dhe zyrtarët aktual qeveritar. Njohja publike e nivelit të lartë mund të shërbejë si një shfaqje e angazhimit të një shteti për viktimat, të kontribuoj në shërimin shoqëror dhe pajtimin, dhe të përforcojë mesazhin e përkatësisë dhe dinjitetit.

Aktualisht të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë mendojnë se kanë hapësira të kufizuara për t'u dëgjuar apo për të kontribuar në proceset e rëndësishme që po ndërmerren në emër të tyre. Dështimi për të komunikuar si duhet dhe komunikimet e vonuara kanë ndikuar që të mbijetuarit të mos jenë në dijeni të fazave të ndryshme të procesit, teksa ndodhnin, duke shkaktuar ankth të mëtejshëm dhe pakënaqësi. Hartuesit e politikave, krijuesit e programit dhe zbatuesit mund ti adresojnë më mirë nevojat e të mbijetuarve nëse angazhohen direkt me të mbijetuarit, kuptojnë se çfarë të mbijetuarit konsiderojnë të rëndësishme në fushën e drejtësisë dhe reparacionit për veten dhe familjet e tyre, dhe ti dëgjojnë të mbijetuarit rreth sfidave me të cilat ballafaqohen sa i përket qasjes në dhe rritjes së qasjes në shërbime dhe përfitime.

Proceset që lidhen me sigurimin e reparacioneve vetë mund të jenë një mundësi për fuqizimin e të mbijetuarve. Pjesëmarrja kuptimplote e të mbijetuarve mund të ndihmojë në hartimin e programit të reparacionit dhe të rris efektin e masave të drejtësisë tranzicionale. Po ashtu mund të ndihmojë në përmirësimin e shtrirjes, plotësisë dhe gjithëpërfshirjes së programeve të reparacionit. Për më tepër, përfshirja e drejtpërdrejt me të mbijetuarit mund të ndihmojë në menaxhimin e pritjeve dhe për të rritur kuptimin e reparacioneve simbolike dhe materiale.

Është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht kornizës së fuqishme ligjore për çështjet e barazisë gjinore në Kosovë, në praktikë, pjesëmarrja e grave në proceset vendimmarrëse mbetet e kufizuar, sidomos në nivel të komunitetit. Të mbijetuarit vetë nuk janë të mësuar që të flasin hapur dhe shpesh e lejojnë liderin të vendos. Duhet të krijohen masa të përshtatshme për ti trajtuar shqetësimet e tyre, për tu angazhuar

me proceset që i prekin ata. Si e tillë qasja “mos bëj dëm” duhet të përdoret në të gjitha aktivitetet dhe proceset.

Dëmi i dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin nuk është i kufizuar në vetë aktin, por po ashtu mund të vijë nga trajtimi që të mbijetuarit e marrin në shtëpi dhe komunitet si pasojë e asaj përvoje. Shumë të mbijetuar i druhen dhunës, stigmës dhe izolimit, si rezultat i të qenit viktimë e dhunës seksuale. Siç ka deklaruar me elokuencë një e mbijetuar, është e rëndësishme që shoqëria të kuptoj se “konflikti nuk na ka sjellë lule”. Garancitë e mospërsëritjes së dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin kërkojnë çmontimin e strukturave sociale dhe të stereotipeve që përjetësojnë diskriminimin dhe dhunën ndaj grave dhe vajzave. Krijimi i fushave të vetëdijesimit në lidhje me faktet e dhunës seksuale dhe vuajtjet e viktimave duhet të bëhet në konsultim me të mbijetuarit për ti parandaluar dëmet e mëtejshme.

Të mbijetuarit vazhdojnë të përballen me sfida në të gjitha aspektet e jetës së përditshme. Pabarazitë ekzistuese gjinore, stigmatizimi në shtëpi dhe komunitet, dhe pasojat e tjera të zgjatura, me të cilat janë përballur të mbijetuarit, e kufizojnë aftësinë e tyre për t'u përfshirë si qytetarë të plotë në jetën ekonomike dhe sociale. Qasja në strukturat dhe programet që mund t'ju ndihmojnë në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre mbetet e vështirë.

Veprimet e synuara për të përmirësuar qasjen në drejtësi, për të mbijetuarit dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, janë duke u kryer nga përfaqësues të ndryshëm, nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me Planin e veprimit për qasje në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës. Veçmas këtyre nismave ka një numër të programeve dhe nismave në Kosovë që nuk i synojnë drejtpërdrejt të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, por mund të ofrojnë përfitime të rëndësishme transformuese duke ndihmuar me rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. Ato përfshijnë nisma për të inkurajuar dhe lehtësuar pronësinë e grave, aktivitetet e gjenerimit të të ardhurave, ofrimin e granteve të vogla, dhe qasje në programet e zhvillimit ekonomik

për grupet e marginalizuara në Kosovë.

Koordinimi i nismave ekzistuese të cilat mund të përshtaten për të përfiturar të mbijetuarit dhe lehtësimi i qasjes së të mbijetuarve, në këto nisma, do të ishte i dobishëm. Përfshirja e të mbijetuarve në kuadër të programeve dhe nismave, që synojnë audienca më të gjëra, do ta shmangte identifikimin dhe stigmatizimin e mëtejshëm.

Aq sa është e mundur duhet kërkuar sinergji në mes të reparacioneve dhe programeve të zhvillimit. Qeveria ka treguar vullnet politik që të siguroj të drejtën e reparacionit, duke krijuar një kornizë ligjore për të siguruar verifikimin dhe reparacionin për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Me këtë zotim shteti dhe palët e përfshira në zhvillim mund të punojnë së bashku për zbatimin e kësaj kornize ligjore dhe të rrisin efektivitetin e reparacionit për të mbijetuarit. Politikat e zhvillimit mund të plotësojnë shtrirjen e politikave të reparacionit për t'ju garantuar grupeve të marginalizuara të drejtat sociale dhe ekonomike.

Hapat paraprak që Kosova ka ndërmarrë mund dhe duhet të përcillen me zhvillimin e mëtejshëm dhe realizimin e të drejtave për të mbijetuarit. Duke vepruar kështu, Qeveria e Kosovës mund të sigurojë rikthimin adekuat, kompensimin, rehabilitimin, dhe garancitë për mospërsëritje për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Duke garantuar plotësisht të drejtën për reparacion, Qeveria e Kosovës mund ti ndihmojë të mbijetuarit që të rindërtojnë jetën e tyre, t'ju ndihmojë në kthimin e besimit qytetar mes të mbijetuarve dhe autoriteteve, dhe të bëjë përparim të mëtejshëm drejt ndërtimit të paqes së qëndrueshme. Nëse ndërmerren këto hapa të mëtejshëm, është e mundur që Kosova mund të shërbejë si një shembull pozitiv për vendet e tjera që janë duke u përpjekur për të trajtuar trashëgiminë e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.

Një seri rekomandimesh specifike për të garantuar më në plotësi të drejtën e reparacionit për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin janë të përfshira në seksionin V. Gjerësisht, këto rekomandime janë:

1. Të zbatohet korniza aktuale ligjore dhe të sigurohet që Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës mund të funksionoj në mënyrë efektive, efikase dhe pa diskriminim.
2. Të ndryshohet dhe të plotësohet korniza aktuale ligjore për të garantuar të drejtën për reparacion për të gjithë të mbijetuarit, dhe të sigurohen masa reparative që mund t'ju ndihmojnë të mbijetuarve në rindërtimin e jetës së tyre.
3. Të ketë prioritet njohja e shkeljes së të drejtave të të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin dhe të fuqizohet mesazhi i përkatësisë dhe i dinjitetit.
4. Të sigurohet që të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin janë të përfshirë në procesin e konsultimit dhe në fazat e vendimmarrjes në të gjitha proceset që i prekin ata. Pjesëmarrja duhet të përshtatet me aftësinë e zhvillimit të kapacitetit.
5. Të vazhdohet me edukimin e komunitetit rreth dhunës seksuale dhe të theksohet lidhja mes abuzimeve në të kaluarën dhe shkeljeve të vazhdueshme.
6. Të lehtësohet riintegrimi social dhe ekonomik i të mbijetuarve. Të sigurohet që të mbijetuarit të kenë qasje në programet ekzistuese dhe nismat si dhe të përkrahet dhe të lehtësohet pjesëmarrja e të mbijetuarve në hartimin e programeve në të ardhmen, të cilat mund ti ndihmojnë më mirë në rindërtimin e jetës së tyre.
7. Të kërkohet sinergji mes programit të reparacionit dhe programeve të zhvillimit, për ti maksimizuar resurset dhe për të siguruar angazhime afatgjata për qëllimet dhe objektivat reparative.

I. HYRJE DHE METODOLOGJIA

A. Hyrje

Lëvizja për të krijuar një Kosovë të pavarur u përshkallëzua në një konflikt të armatosur që ndodhi nga mesi i shkurtit të vitit 1998 dhe qershorit të vitit 1999. Atëherë provincë e Serbisë në kuadër të ish Republikës Federale të Jugosllavisë (që në atë kohë përbëhej nga Serbia dhe Mali i Zi), dhuna në Kosovë filloi kur Beogradi iu kundërvu rezistencës së organizuar të shqiptarëve. Në mesin e shumëllojshmërisë së abuzimeve, me të drejtat e njeriut, që janë raportuar se kanë ndodhur gjatë konfliktit, ndarja e burrave prej grave, nga forcat serbe, gjatë sulmeve në zonat etnike shqiptare, thuhet se ishte diçka e zakonshme.¹

Raportet e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin (DhSNK) para, gjatë dhe pas konfliktit po ashtu janë shfaqur me kalimin e kohës. Konflikti përfundoi kur Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) e mbështeti Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), me fushatën e bombardimeve të drejtuara kundër caqeve serbe në ish Republikën Federale të Jugosllavisë. Ndërhyrja e vitit 1999 çoi në tërheqjen e forcave jugosllave nga Kosova dhe vendosjen e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i cili e administroi qeverisjen e përkohshme në Kosovë. Menjëherë pas konfliktit, tekta refugjatët e zhvendosur nga dhuna filluan të kthehen, ka ndodhur një largim masiv kundërbalancues i forcave jugosllave dhe i serbëve etnik. Pavarësisht ndërprerjes formale të armiqësisë, raporte të shumta ofruan detaje të përhapjes së shtuar të sulmeve hakmarrëse të kryera nga të dyja palët.²

1 Andrew Testa, 'Endgame in Kosovo', *New York Times* (Online), 9 dhjetor 2007 http://www.nytimes.com/packages/html/world/20071209_KOSOVO_FEATURE/index.html

2 Në përpjekjet për të dokumentuar perspektivën,

Pas luftimeve, grupet e grave dhe të organizatave të shoqërisë civile ofruan shërbime emergjente për të mbijetuarit³ e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Ofruesit e shërbimeve, gjatë viteve, i janë përshtatur nevojave të të mbijetuarve, duke ofruar më vonë edhe mbështetje psiko-sociale si dhe kujdes shëndetësor në aspektin seksual dhe atë riprodhues. Gjatë kësaj periudhe, aktivistë të njohur, për të drejtat e grave, kanë udhëhequr fushata për të ngritur vetëdijen për gjendjen e të mbijetuarve, duke u përpjekur për të thyer heshtjen për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (DhSNK). Mes viteve 2008 dhe 2012, një rrjet i aktivistëve, për të drejtat e grave, filloi të koordinoj dhe kolektivisht të avokoj për nevojat dhe të drejtat e të mbijetuarve dhe për të thyer stigmën që ndërlidhet me dhunën seksuale gjatë konfliktit. Në vitin 2010, Gjykata Rajonale e Grave (një nismë rajonale e shoqërisë civile) filloi punë, duke ofruar hapësirë për diskutim për dhunën kundër grave gjatë dhe pas konflikteve të viteve 90-ta në Ballkanin Perëndimor.⁴ Në dhjetor të vitit 2010, Gjykata e Grave ka mbajtur seanca në Kosovë duke u fokusuar në DhSNK-në. Seanca të tjera janë mbajtur në të gjithë rajonin dhe kanë përfshirë edhe të mbijetuar të dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë, me seancën e fundit të mbajtur në maj 2015 në Sarajevë.

për këtë raport, dhuna seksuale brenda grupeve etnike dhe ndaj grupeve etnike, ka dalë në pah, ashtu siç ka ndodhur, në kontekstin e këtyre sulmeve hakmarrëse.

3 Fjalët "viktimitë" dhe "i mbijetuar" në Kosovë, janë përdorur si të njëjta në kontekstin e dhunës seksuale. Është pranuar se është çështje preference personale se si secili zgjedh për tu identifikuar. Për qëllimet e këtij dokumenti, personat të cilët kanë pësuar dhunë seksuale janë referuar si viktimë në kontekstin se kanë qenë të dhunuar, dhe si të mbijetuar në kontekstin e pas dhunimit.

4 Gjykata rajonale e Grave □ Një qasje feministe në drejtësi. Shih: <http://www.zenskisud.org/en/index.html>

Që kur Kosova e ka shpallur pavarësinë, në vitin 2008, autoritetet vendore kanë ndërmarrë shumë nisma që kanë për qëllim ballafaqimin me të kaluarën.⁵ Fushatat e avokimit, të fokusuara në dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, veçanërisht që nga viti 2012, kanë shërbyer për të thyer heshtjen e mëparshme shurdhuese mbi abuzimin seksual dhe për të përforcuar mbështetjen e qeverisë për të mbijetuarit. Në pak vite, diskutimi për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin është rritur, në mënyrë eksponenciale, në nivele të ndryshme të qeverisë. Me kalimin e kohës janë përshpejtuar përpjekjet si për të ofruar reparacionin ashtu edhe mbështetjen, për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin (DhSNK), si dhe për të kërkuar dhënien e përgjegjësisë nga ana e sulmuesve të tyre.

Në vitin 2012 filluan përpjekjet lobuese për të ndryshuar legjislacionin, duke i njohur dhe duke ju siguruar përfitime dëshmorëve, veteranëve të UÇK-së dhe viktimave civile (të vdekur, të zhdukur dhe të plagosur)⁶, me qëllim për të përfshirë po ashtu edhe viktimat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin (DhSNK). Kuvendi i Kosovës, gjatë vitit 2014, e ka miratuar një amendament përmes të cilit viktimat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, njihen si kategori dhe u mundësohen përfitimet përkatëse.⁷

Gjatë periudhës 2012-2013 Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), me mbështetjen e UN Women-it, ndërmori kërkime për ti përshkruar modellet dhe pasojat afatgjata të dhunës seksuale në

Kosovë, që kanë ndodhur ndërmjet shkurtit të vitit 1998 dhe qershorit të vitit 1999, për të identifikuar disponueshmërinë e shërbimeve dhe qasjen në drejtësi, për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, dhe për të identifikuar zbrazëtitrat në kornizën legjislative për qasje në drejtësi dhe masat për mbrojtje dhe reparacion.⁸

Mbështetja e fuqishme e shoqërisë civile, politikës dhe grupeve të tjera është shtuar edhe më tej në mars të vitit 2014, nga presidentja Atifete Jahjaga, kur me vendim të veçantë presidencial është themeluar **Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë** (Këshilli Kombëtar). Këshilli Kombëtar mbledhi së bashku përfaqësues të ministrive kryesore, që mund ti mbështesin të mbijetuarit e dhunës seksuale, shoqërinë civile dhe palë të interesuara ndërkombëtare, për të krijuar në reagim më të përmirësuar, dhe të koordinuar më mirë. Në mesin e shumë aktiviteteve të Këshillit Kombëtar ishte hartimi i një strategjie mbi qasjen e të mbijetuarve në drejtësi, zhvillimi i një Memorandumi të Mirëkuptimit me Ministrinë e Shëndetësisë për qasje në shërbimet shëndetësore, projekte për ngritje të vetëdijesimit dhe për fuqizimin ekonomik përmes nismave të shumë palëve të interesuara.

Presidenti dhe anëtarët e Këshillit Kombëtar gjithashtu kanë punuar ngushtë me Departamentin Ligjor të Zyrës së Kryeministrit, në hartimin e një rregulloreje, për të zbatuar ndryshimet legjislative, për ti njohur dhe për të siguruar përfitime për të mbijetuarit. E miratuar në dhjetor të vitit 2015, rregullorja parashikon krijimin e një komisioni për të verifikuar statusin e viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin (DhSNK) dhe për të siguruar shpërndarjen e përfitimeve të parashikuara me ligj. Zyra e Kryeministrit tashmë po ndërmerr hapa për krijimin dhe funksionalizimin e **Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës** ("komisioni")⁹.

8 Victoria S Rames, "Shërimi i shpirtit: Reparacioni për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin e armatosur në Kosovë" (2013).

9 Rregullorja e Kosovës nr. 22/2015 mbi definimin e

5 Një përshkrim i plotë i situatës në Kosovë, duke përfshirë të gjitha nismat që janë ndërmarrë deri më sot, mund të gjendet në seksionin IV. Konteksti i Kosovës dhe Shtojca I: Një përmbledhje e nismave repartive për të mbijetuarit e dhunës seksuale në Kosovë.

6 Ligji i Kosovës nr. 04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë të Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre i 8 dhjetorit 2011 [në vijim "ligji nr. 04/L-054"].

7 Ligji i Kosovës nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre i 20 marsit 2014 [në vijim "ligji nr. 04/L-172"].

Derisa ndryshimet legislative, deri më tani, kanë qenë hapa të mëdhenj përpara, korniza aktuale ligjore nuk e trajton vargun e plotë të nevojave të të mbijetuarve. Në një farë mase korniza ligjore është plotësuar me marrëveshjet ndërmjet Zyrës së Presidentit dhe ministrive përkatëse, për të siguruar qasje në shërbimet dhe ndihmën e drejtësisë, për të mbijetuarit e dhunës seksuale.¹⁰ Me përfundimin e mandatit të Presidentes Jahjaga, më 7 prill 2016, si dhe me shuarjen e Këshillit Kombëtar, një vlerësim i nis-mave reaprative, deri më sot, si dhe udhëzimet për hapat e mëtejshëm, për ti trajtuar nevojat e ngutshme të të mbijetuarve, është duke ndodhur në kohën e duhur.

Në këtë kontekst si anëtare e Këshillit Kombëtar UN Women në Kosovë e ka nisur këtë studim, për ti plotësuar nismat paraprake me hulumtime të përditësuara, duke u fokusuar në sjelljen e zërave dhe të perspektivave të të mbijetuarve, në ballë të politikave dhe hartimit të programeve të ardhshme. Ka për qëllim që të sjellë së bashku praktikën më të mira të reparacioneve, duke përfshirë edhe praktikën e paraqitura në *shkresën udhëzuese të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin*, të vitit 2014,¹¹ si dhe pikëpamjet, pritjet dhe nevojat e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë, për ti plotësuar përpjekjet e deritanishme dhe për të siguruar reparacion të plotë për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, që është proces transformues, i përqendruar tek viktima dhe i ndjeshëm në aspektin gjinor.¹² Ka

procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës i 2 shkurtit 2016 [në vijim "Rregullorja nr. 22/2015"], neni 3 (1.2).

10 Përshkruar në sesionin IV.

11 Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014).

12 Reparacionet mund të jenë transformuese kur kërkojnë që ti transformojnë pabarazitë strukturore, të cilat çuan në shkeljet e të drejtave të grave; u përgjigjen nevojave specifike të grave dhe e parandalojnë ripërsëritjen, në vend se të kërkojnë që të rivendoset situata që ekzistonte para dhunimit.

për qëllim plotësimin e masave ekzistuese dhe atyre të planifikuara, për të rritur efektivitetin e tyre, në adresimin e nevojave të të mbijetuarve, siç udhëzohet nga rrëfimet e të mbijetuarve.

A. Metodologjia

Këshilltarja e ka kryer hulumtimin në Kosovë nga 1 shtatori 2015 deri më 31 janar 2016. Gjatë kësaj periudhe informatat janë mbledhur nga seminare dhe takime me të mbijetuarit e dhunës seksuale, nga Këshilli Kombëtar, individualisht nga anëtarët e Këshillit, si dhe nga përfaqësues të ministrive dhe departamenteve.¹³

Hulumtimi ka filluar me shqyrtimin e të gjitha botimeve dhe dokumenteve informale, në dispozicion, për gjendjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale në Kosovë dhe angazhimin me anëtarët e Këshillit Kombëtar.¹⁴ Në fillim të tetorit 2015 u mbajt një seminar me Këshillin Kombëtar.

Gjatë kësaj punëtore Këshilli Kombëtar i ka përshkruar qëllimet e veta gjithëpërfshirës, të cilat do të jenë: zhvillimi i një qasje gjithëpërfshirëse të reparacionit për të mbijetuarit, për t'ju mundësuar atyre pjesëmarrjen e plotë në jetën familjare, në komunitet dhe në proceset kombëtare nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së jetës dhe fuqizimin e tyre; heqjen e pengesave për qasje në sistemin e drejtësisë, shëndetësisë dhe pavarësisë ekonomike; dhe përmirësimin e pranimit nga ana e komunitetit dhe mbështetjen për të mbijetuarit.

Një numër i nënobjektivave e plotësojnë qasjen gjithëpërfshirëse të ndërmarrë nga Këshilli Kombëtar:

- Të mbijetuarit të nxirren nga varfëria dhe t'ju sigurohet pavarësi ekonomike përmes mundësive ekonomike, përjashtimit nga taksat dhe mbështetjes ekonomike.

•13 Një listë e plotë e palëve kryesore të konsultuara mund të gjendet në Aneksin III.

14 Një listë e plotë e resurseve mund të gjendet në Aneksin IV.

- Të sigurohet që të mbijetuarit e dhunës seksuale të kenë qasje në standardet më të larta të mundshme të kujdesit shëndetësor.
- Të mundësohet qasja në drejtësi, për të mbijetuarit e dhunës seksuale, nëpërmjet mjeteve fizike dhe logjistike.
- Të adresohet turpi shoqëror dhe stigma që ndërlidhet me dhunën seksuale. Kjo përfshin ridrejtimin e turpit shoqëror dhe stigmës të ndërlidhur me dhunën seksuale nga të mbijetuarit dhe vendosjen e saj krejtësisht tek autorët e dhunës seksuale.
- Të fuqizohen të mbijetuarit që të përdorin zërin e tyre, në emër të vetin dhe atë të të mbijetuarve të tjerë, anëmbanë globit, dhe t'ju ndihmohet të mbijetuarve ta largojnë vetëdijshimin dhe turpin që u është vënë nga të qenit viktimë e dhunës seksuale.

Të mbijetuarit e dhunës seksuale janë vendosur në qendër të këtij hulumtimi kurse informacioni dhe komunikimi janë bërë në një dialog të dyanshëm, gjatë këtyre pesë muajve, për të kapërcyer distancën fizike dhe kulturore që i ka ndarë deri më sot të mbijetuarit nga vendimarrja. Përafërsisht 70 të mbijetuar kanë marrë pjesë në aktivitete me këshilltaren; 14 kanë marrë pjesë në një takim paraprak në tetor të vitit 2015, ndërsa në nëntor të vitit 2015 59 të mbijetuar kanë marrë pjesë në një punëtori dy ditore, e cila përbëhej nga gjashtë takime me grupe të fokusit dhe disa nga të mbijetuarit kanë marrë pjesë në të dyja aktivitetet. Këshilltarja gjithashtu është ndërlidhur me të mbijetuarit në aktivitete të Këshillit Kombëtar dhe në ngjarje të ndryshme të komunitetit.

Qasja dhe afrimi me të mbijetuarit u mundësua përmes katër organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime mbështetëse psiko-sociale për këtë pjesë të popullatës: Medica Kosova, Medica Gjakova, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRMT) dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave. Konfidencialiteti i të mbijetuarve, që kanë marrë pjesë në

hulumtim, ishte një shqetësim i dorës së parë. Detajet e seminareve dhe takimeve nuk janë bërë publike, emrat e pjesëmarrësve nuk janë përdorur për qëllime logjistike dhe nuk janë bërë fotografi. Pjesëmarrësit në të gjitha rastet kishin mundësi të angazhohen duke mbetur të pafidentifikuar gjatë seancave, nëse ata dëshironin kështu, dhe në çdo seancë u është siguruar një kuti të mbyllur, ku të mbijetuarit mund të vendosnin mesazhe anonime. Pasi që konfidencialiteti i të mbijetuarve mbetet një shqetësim kryesor, detajet që mund të identifikojnë të mbijetuarit individual apo vendet ku të mbijetuarit e vetëidentifikuar mund të banojnë janë hequr nga ky raport. Domosdoshmërisht, raporti mbetet i paqartë në disa fusha të veçanta, siç janë lokalitetet, ku të mbijetuarit e dhunës seksuale banojnë, dhe ku ata do të mund të përfitonin nga shërbimet komunale apo nga resurset. **Palët e interesuara në ndërmarrjen e aktiviteteve, që mund të ofrojnë shërbime të tilla, inkurajohen që ta kontaktojnë zyrën e UN Women në Kosovë për udhëzime në fushat me nevoja specifike.**

Gjatë punëtorisë dy ditore, me ligjërues të trajnuar në fushat përkatëse, janë mbajtur seanca të mirëqenies, si terapi arti, menaxhim i stresit dhe sesione të terapive trupore, të cilat janë organizuar njëkohësisht me seancat e grupeve të fokusit me këshilltarin, si një mjet tjetër për pjesëmarrje të dyanshme. Në këtë mënyrë të mbijetuarit, që kishin mundësi të jenë pjesë e procesit të hartimit të reparacioneve, janë pajisur me mjete për përmirësimin e shëndetit të tyre, të cilat i kanë marrë me vete në shtëpi, dhe seancat e përqendruara në dokumentimin e nevojave dhe zërave të tyre janë përshpejtuar me seancat miqësore dhe ato të relaksimit.

Të mbijetuarve nuk u janë bërë pyetje lidhur me përvojat e tyre specifike të dhunës seksuale. Megjithatë, disa të mbijetuar, sipas dëshirës së tyre, i kanë ofruar përvojat e tyre gjatë seancave në grup dhe disa të tjerë kërkuan takime private me këshilltaren për ti treguar detajet e përvojës së tyre dhe pasojat e veçanta të cilat janë të dokumentuara. Këto detaje nuk janë përfshirë në raport.

Nuk ka qenë e mundur për të patur qasje tek viktimat meshkuj, të dhunës seksuale, në mënyrë që të përfshihet edhe perspektiva e tyre. Kjo nuk sugjeron që burrat dhe djemtë nuk ishin viktimë të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin (DhSNK) në Kosovë. Në të vërtetë të mbijetuarit meshkuj u janë afuar ofruesve të shërbimeve për trajtim dhe kanë dalë në media për ti treguar historitë e tyre. Deri më sot në Kosovë vetëm një ofrues i shërbimeve ka patur kapacitet për të siguruar këshillime dhe shërbime shëndetësore për të mbijetuarit meshkuj. Ofruesit e tjerë nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë shërbime të tilla për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe hapësirave të sigurta dhe anonime për burrat dhe djemtë. Një tjetër ofrues i shërbimeve është duke u përpjekur që të ndërtoj kapacitete të tilla në mënyrë që, në një të ardhme të afërt, të ofrojë shërbime për të mbijetuarit meshkuj. Megjithatë duket se aktualisht shumë meshkujve, të mbijetuar të dhunës seksuale (DhSNK), u mungon qasja në shërbime të veçanta dhe të përshtatura. Andaj qasja dhe afrimi me të mbijetuarit meshkuj momentalisht është i vështirë.

Qëllimi i konsultimeve ka qenë për ti theksuar zërat e pjesëmarrësve dhe të shikohet shumëllojshmëria e nevojave. Pjesa më e madhe e punës, deri më sot në Kosovë, ka qenë e bazuar në supozimin se viktimat kanë një zë kolektiv. Realiteti është se më herët, sigurimi i informacioneve, që kanë të bëjnë me të mbijetuarit dhe nevojat e tyre, është i bazuar kryesisht tek anëtarët më me vetëbesim dhe më të zëshëm, të të dyja komuniteteve, të mbijetuarve dhe ofruesve të shërbimeve.

Gjithashtu janë zhvilluar edhe takime me secilën prej organizatave të shoqërisë civile që punon me të mbijetuarit. Çdo organizatë ka dhënë detaje të shërbimeve, që ofron për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, dhe informacione të ndryshme të lidhura me atë se pse këto shërbime janë identifikuar si të nevojshme. Pasi që raporti i OHCHR-së i ka dokumentuar këto shërbime, ato nuk janë përfshirë në këtë raport.¹⁵

15 Shih aneksin II të Rames, *Shërimi i shpirtit*.

Një konsideratë e rëndësishme e çdo hartimi të programit të reparacionit është kapaciteti dhe vullneti i secilës qeveri përkatëse për të siguruar reparacione. Për të përcaktuar këtë, janë mbajtur takime me përfaqësues të: Zyrës së Presidentit; Zyrës së Kryeministrit; Ministrisë së Shëndetësisë; Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; si dhe të Agjencisë për Barazi Gjinore. **Të gjitha subjektet qeveritare kanë shprehur gatishmëri dhe mirëfilltë për të gjetur zgjidhje, brenda portofoleve të tyre, ndaj sfidave me të cilat përballen të mbijetuarit.**

Në prill të vitit 2016 72 të mbijetuarve u janë prezantuar hulumtimi dhe rekomandimet. Duke u takuar në katër grupe, 68 nga 72 të mbijetuarit që kanë marrë pjesë në takimet e shqyrtimit në prill 2016, ku janë prezantuar përvojat e tyre, po ashtu kanë marrë pjesë në sesionet e grupeve të fokusit të mbajtura në nëntor të vitit 2015. Këto takime shërbyen për të konfirmuar gjetjet, nga punëtoritë e mëparshme, dhe të ofrohen sqarime të mëtejshme të perspektivave mbi disa pika.

II. REPARACIONET PËR DHUNËN SEKSUALE QË NDËRLIDHET ME KONFLIKTIN: PËRKUFIZIMET, KORNIZA LIGJORE, SFIDAT DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA

A. Përkufizimet

Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin¹⁶ e përdor përkufizimin e DhSNK-së që është hartuar në dokumentet analitike dhe konceptuale të OKB-së për DhSNK-në.¹⁷ Sipas këtij përkufizimi **dhuna seksuale që ndërlidhet me konfliktin** i referohet incidenteve apo formave të dhunës seksuale ndaj grave, burrave, vajzave apo djemve, që ndodhin në një mjedis ku ka konflikt, ose pas konfliktit, dhe të cilat kanë lidhje direkte ose indirekte me vetë konfliktin apo që ndodhin në situata të tjera shqetësuese në kontekst të represionit politik.¹⁸

Dhuna seksuale e ndërlidhur me konfliktin ka forma të shumta, duke përfshirë përdhunimin, shtatzëninë e detyruar, abortin e detyruar, sterilizimin e detyruar, lakuriqësinë e detyruar, prostitucionin e detyruar, shfrytëzimin seksual, trafikimin, skllavërimin seksual, synetin e detyruar, treshjen dhe forma të tjera të dhunës seksuale të rrezikshmërisë së krahasueshme.¹⁹

Viktimat²⁰ e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin përfshijnë gratë, vajzat, burrat dhe djemtë të cilët individualisht apo kolektivisht kanë vuajtur nga dhuna seksuale, si dhe anëtarët e familjes, po ashtu përfshijnë edhe fëmijët apo partnerët e tyre dhe fëmijët e lindur si rezultat i shtatzënisë nga përdhunimi.²¹

16 Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014)

17 Dokumenti analitik dhe konceptual i OKB-së që vë kornizat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2011).

18 Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014), faqe 3

19 Ibid., f. 2.

20 Shih parimet dhe udhëzimet themelore për të drejtën për zgjidhje efektive dhe reparacion për viktimat e shkeljeve të rënda sipas Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. (A/RES/60/147, 21 mars 2006), [në vijim "Parimet dhe udhëzimet themelore për të drejtën për zgjidhje efektive dhe reparacion"], parimet 8 dhe 9.

21 Ibid., parimi 8; dhe shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014), faqe 3.

Personat të cilët janë të varur nga viktimat e drejtpërdrejta të dhunës seksuale mund të jenë viktima, si pasojë e dëmit të shkaktuar me anë të dhunës. Viktimat mund të jenë edhe ata persona të cilët kanë pësuar lëndime duke tentuar që t'ju ndihmojnë viktimave në ankth, ose për të parandaluar viktimizimin.²² Në Kosovë fjalët “viktima” dhe “i mbijetuar”, në kontekstin e dhunës seksuale, janë përdorur si të njëjta. Është pranuar se është çështje e preferencës personale se si secili zgjedh për tu identifikuar. Për qëllimet e këtij dokumenti, personave që kanë pësuar dhunë seksuale iu referohemi si viktima, në kontekstin se kanë qenë të dhunuar, dhe se janë të mbijetuar në kontekstin e pas dhunimit.

Prandaj viktima të DhSNK-së në Kosovë janë të gjithë personat që kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës seksuale para, gjatë dhe pas periudhës formale të armiqësive, që kishin lidhje të drejtpërdrejta ose të tërthorta me konfliktin, duke përfshirë edhe aktet e dhunës seksuale ndaj dhe brenda grupeve etnike. Viktimat mund të jenë edhe femrat edhe meshkujt dhe mund ti përkasin cilitdo grupi etnik. Viktimat mund të jenë edhe anëtarët e familjes së viktimës direkte, dhe personat që varen nga viktima si pasojë e dëmtimit nga dhuna. Dëmtimi mund të përfshijë pasoja të menjëhershme dhe afatgjate: lëndime fizike dhe mendore; humbjen e mundësive ekonomike dhe arsimore; që kanë të bëjnë me shkelje të mëtejshme të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtën për jetë familjare; dhe dëmtimin moral përfshirë poshtërimin shoqëror, reputacionin e njollosur dhe frikën e ndërlikuar apo ankthin.

Në të drejtën ndërkombëtare **reparacionet** i referohen të gjitha masave, që mund të zbatohen, për të përmirësuar format e ndryshme të dëmeve që viktima mund ti ketë pësuar si pasojë e krimeve të caktuara.²³ Masat në fjalë mund të marrin forma të ndryshme, ndonëse tradicionalisht përfshijnë dëmshpërblimin, kompensimin, rehabilitimin, përmirësimin dhe garancitë për mospërsëritje.²⁴

22 Ibid.

23 Raporti i Raportuesit Special për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, reparacionit dhe garancitë e mospërsëritjes, të Asamblesë së Përgjithshme (A/69/518 14 tetor 2014), paragrafi. 19

24 Parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën për zgjidhje efektive dhe reparacion, 20, parimi 18.

- **Rikthimi** ka për qëllim që ti rikthejë viktimat në pozitën para ndodhjes së dhunës (aq sa kjo të jetë e mundur). Kjo mund të përfshijë rikthimin e lirisë, gëzimin e të drejtave të njeriut, jetën familjare dhe shtetësinë, rikthimin në punë si dhe kthimin e pronës.²⁵

- **Kompensimi** duhet të jepet për dëmin e vlerësuar ekonomik, të përshtatshëm dhe proporcional me seriozitetin e dhunës. Dëmtimi mund të përfshijë lëndime fizike dhe mendore; mundësitë e humbura, duke përfshirë humbjen e punësimit, arsimimit dhe përfitimit social; si dhe dëmin moral dhe shpenzimet e nevojshme për ndihmë.²⁶

- **Rehabilitimi** përfshin kujdesin mjekësor dhe psikologjik, si dhe shërbimet ligjore dhe sociale.²⁷

- **Përmirësimi** i referohet shprehjeve jo financiare të reparacioneve, të cilat mund të përfshijnë kërkimin e së vërtetës dhe zbulimit; deklaratat zyrtare për rivendosjen e dinjitetit, reputacionin dhe të drejtat e viktimës; kërkim faljen publike, duke përfshirë edhe njohjen e fakteve; si dhe përfshirjen e sqarimeve të sakta të dhunës në materialet edukative.²⁸

- **Garancitë për mospërsëritje** përfshijnë masat për të kontribuar në parandalimin e dhunës së mëtejshme ose dhunës në të ardhmen, si dhe reformat institucionale; promovimin e mekanizmave për monitorimin dhe parandalimin e konflikteve sociale; dhe promovimin e të drejtave të njeriut.²⁹

Këto forma të reparacioneve, të krijuara pa pasur ndonjë konsideratë të veçantë për dhunën gjinore, si të tilla mund të paraqesin sfida për korrigjimin e dëmit për DhSNK-në dhe specifikat e përvojave të grave. Aplikimi i tyre në kuadër të kornizës më të gjerë ligjore dhe përmes një qasjeje të ndjeshme gjinore diskutohet më poshtë.³⁰

25 Ibid., parimi 19.

26 Ibid., parimi. 20.

27 Ibid., parimi. 21.

28 Ibid., parimi. 22.

29 Ibid., parimi. 23.

30 Shih seksionin II. C dhe D.

B. Korniza ligjore

E drejta për zgjidhje efektive është e përcaktuar në Ligjin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe në të Drejtën Humanitare,³¹ si dhe me instrumentet rajonale.³² E drejta për zgjidhje efektive është shtjelluar tutje në jurisprudencë.³³ Në dhjetor të vitit 2005, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi *Parimet dhe udhëzimet themelore për të drejtën për zgjidhje efektive dhe reparacion për viktimat e shkeljeve të rënda sipas Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe shkeljeve të rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Parimet dhe udhëzimet themelore për të drejtën për zgjidhje efektive dhe*

31 Dispozitat kryesore në Ligjin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 8; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, neni 2; Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, neni 6; Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore në njerëz apo Trajtim Degradues apo Ndëshkim, neni 14; Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, neni 39; Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, neni 24. dispozitat kryesore në të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare gjenden në: Konventën e Hagës që rrespekton ligjet dhe traditat e luftës për toka të datës 18 tetor 1907 (Konventa IV), neni 3; Protokollin Shtesë i Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe në lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare (Protokollin I) i datës 8 qershor 1997, neni 91 (i aplikueshëm për konfliktet ndërkombëtare të armatosura, por tani detyrimi konsiderohet si pjesë e zakonshme e së Drejtës Ndërkombëtare të zbatueshme për konflikte të armatosura jo ndërkombëtare); Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, neni 68 dhe 75.

32 Instrumentet rajonale përfshijnë: Kartën Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve, neni 7; Konventën Amerikane për të Drejtat e Njeriut, neni 25; dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, neni 13. Për momentin, nuk ka ndonjë instrument rajonal i cili e pasqyron të drejtën për të kompensuar në të cilën Kosova është palë.

33 Shih për shembull komentin e përgjithshëm të Komitetit të të Drejtave të Njeriut nr. 31 të miratuar më 29 mars 2004 dhe komentin e përgjithshëm të Komitetit kundër Torturës nr. 3. Për një shembull të jurisprudencës që ka të bëjë me reparacionet shtet për shtet për shkeljen e Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare shih për shembull, *Aktivitetet e armatosura në territorin e Kongos* (Republika Demokratike e Kongos kundër Ugandës) (Meritat) [2005] ICJ Rep 116.

reparacion, janë një përmbledhje e të drejtave të miratuara nga bashkësia ndërkombëtare përmes Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Asamblesë së Përgjithshme.³⁴ Sipas të drejtës ndërkombëtare, mundësitë juridike, për shkelje të rënda të Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe për shkelje serioze të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, përfshijnë të drejtën e viktimës për:

- Qasje të barabartë dhe efektive në drejtësi;
- Reparacion të përshtatshëm, efektiv dhe të shpejtë për dëmin e pësuar;
- Qasje në informatat e rëndësishme në lidhje me shkeljet dhe mekanizmat e reparacionit.³⁵

Në pajtim me ligjin vendor dhe atë ndërkombëtar, shtetet duhet të sigurojnë reparacion për viktimat e shkeljeve të rënda të Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe të ligjeve ndërkombëtare humanitare që mund t'i atribuohen shtetit, siç janë personat dhe subjektet e gjetura përgjegjëse për shkeljet gjatë konfliktit. Në rast se një person ose subjekt është shpallur përgjegjës për reparacion ndaj një viktime dhe shteti ka dhënë reparacionin për viktimën, personi apo subjekti përgjegjës duhet të kompensojë shtetin.³⁶ Në rast se personat përgjegjës për të siguruar reparacionin nuk janë të gatshëm ose janë të paaftë për ti përmbushur detyrimet e tyre, shtetet duhet të përpiqen që të krijojnë programe kombëtare për reparacion dhe ndihma të tjera për viktimat.³⁷

Jurisprudenca konfirmon se detyrimi për të siguruar reparacionet përfshin më shumë se vetëm kompensimin monetar, përfshin edhe hetimin publik dhe përndjekjen; reformat ligjore; kthimin e lirisë, punësimit apo kthimin e pronës; kujdesin mjekësor; dhe kërkim faljen

34 Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 60/147.

35 Parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën për zgjidhje efektive dhe reparacion, parimi 11.

36 Ibid., parimi 15.

37 Ibid., parimi 16.

publike si dhe njihjen zyrtare të përgjegjësisë së shtetit për këto shkelje.³⁸

Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në agjendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, ofrojnë metoda për aprovimin e një qasje të ndjeshme gjinore për zbatimin e kornizës ligjore.³⁹ Veçmas Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave ("CEDAW") Komiteti po ashtu ka kontribuar edhe në të kuptuarit e kornizës ligjore përmes rekomandimit të tij të përgjithshëm nr.30 për Gratë në parandalimin e konfliktit, situatat e konfliktit dhe të pas konfliktit i cili rekomandon që shtetet të sigurojnë reparacione që janë të ndjeshme në aspektin gjinor, që promovojnë të drejtat e grave, dhe që i përfshijë gratë në hartimin e tyre.⁴⁰

C. Sfidat për hartimin e reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlihet me konfliktin

Format tradicionale të reparacioneve – rikthimi, kompensimi, rehabilitimi, përmbushja dhe garancitë për mospërsëritje, – nëse interpretohen ngushtësisht mund të bëhen problematike dhe joefektive në sigurimin e dëmshpërblimit për viktimat e DhSNK-së.

Synimi i rikthimit të individit në gjendjen para dhunimit (**rikthimi**) është problematik, ngase status quoja-ja për gratë para, gjatë dhe pas konfliktit shpesh është një nga disavantazhet sistematike që lidhet me krimet e dhunës seksuale. Pabarazitë para ekzistuese strukturore gjinore jo vetëm që mund ti shumëfishojnë pasojat e DhSNK-së, por po ashtu paraqesin sfida të rëndësishme në hartimin dhe zbatimin e masave me qëllim të trajtimit të dëmit të shkaktoar nga DhSNK-ja. Gratë përjetojnë pabarazi

38 A/69/518, para 17.

39 Në veçanti rezolutat vijuese të Këshillit të Sigurimit, UNSCR 1325 (2000), 1820 (2008), 1888 (2009), 1889 (2009), 1960 (2010), 2106 (2013), 2122 (2013), dhe 2242 (2015).

40 Komiteti i OKB-së për Eliminimin e diskriminimit ndaj grave (CEDAW), rekomandimi i përgjithshëm nr. 30 për gratë në parandalimin e konfliktit, situatat e konfliktit dhe të pas konfliktit (CEDAW/C/GC/30, 1 nëntor 2013).

dhe janë të cenueshme nga një sërë realitetesh të përditshme: diskriminimi dhe stereotipet në shtëpi, komunitet dhe në vend të punës; kufizimet kulturore dhe ligjore për pronësinë e femrave si dhe qasja në prona; kufizimet në baza gjinore në lëvizje dhe qasja në hapësirat publike; normat kulturore dhe besimet në lidhje me virgjërinë femërore dhe nderin; ekspozimi ndaj dhunës seksuale dhe dhunës në baza gjinore si dhe ndaj ngacmimit; dhe qasja e pabarabartë në shërbimet shëndetësore dhe arsim.⁴¹

Kompensimi për dëmin ekonomikisht të llogaritshëm kërkon të kuptuarit e dëmit të menjëhershëm, afatmesëm dhe afatgjatë, që mund të rezultojë nga DhSNK-ja, si dhe faktorët gjinor, të trashëguar nga pabarazia strukturore, që mund të ndikojnë në këto llogaritje. Dhuna seksuale mund të shkaktojë traumë afatgjate fizike, mendore dhe emocionale duke përfshirë edhe pamundësinë për të ngjizur, shterpësinë, si dhe probleme të shëndetit riprodhues; humbjen e mundësive të arsimit, humbjen e mundësive ekonomike dhe martesore; humbjen e pasurisë; shkelje të tjera të të drejtave të njeriut siç është e drejta për jetë familjare; dhe dëmi moral siç është poshtërimi shoqëror dhe reputacioni i dëmtuar.

Rehabilitimi për të mbijetuarit e dhunës seksuale kërkon të kuptuarit se *kush* mund të ketë nevojë për qasje, në *çfarë lloj* shërbimesh dhe se *sa* të arritshme janë këto shërbime. Shumë shpesh rehabilitimi kufizohet në ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe fiziologjike për gratë viktimat të DhSNK-së. Derisa dhuna seksuale ndaj burrave dhe djemve shpesh është e padukshme dhe/ose nuk është krejtësisht e raportuar, viktimat meshkuj të DhSNK-së shpesh nuk kanë qasje në shërbime të veçanta dhe në shërbimet e krijuara enkas për këto raste. Rehabilitimi për llojet e tjera të viktimave po ashtu mund të lihet pas dore. Viktimat po ashtu mund të përfshijnë anëtarët e familjes dhe personat që mund të va-

41 Raporti nga takimi i Grupit të ekspertëve të UN Women për Parandalimin e dhunës kundër grave dhe vajzave (2012), f. 8 □ 10. Qasja online në vegzën vijuese: <http://www.unwomen.org/-/media/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2012/11/Report-of-the-EGM-on-Prevention-of-Violence-against-Women-and-Girls.pdf>

ren nga viktimat e drejtpërdrejtë, si dhe personi i cili ka pësuar lëndime gjatë ndërhyrjes, për të ndihmuar viktimat në ankth ose për të parandaluar viktimizimin.⁴² Në mesin e shumë pasojave negative të dhunës seksuale, në jetën e të mbijetuarve, ndikimi emocional në pjesën tjetër të familjes mund të jetë shumë shkatërrues.⁴³ Qasja në shërbimet përkatëse të rehabilitimit për viktimat e tjera, përveç viktimës direkte, është kritike, sidomos për të adresuar dëmin e ndodhur mes gjeneratave që buron nga DhSNK-ja. Nëse konsiderohet më gjerësisht rehabilitimi po ashtu ka potencial për të përfshirë strategjitë për fuqizimin e viktimave, siç është lidhja e të mbijetuarit me arsimimin dhe mundësitë ekonomike⁴⁴. Në kontekste në të cilat të mbijetuarit e DhSNK-së vuajnë nga izolimi, i cili mund të çojë në mjerim, qasja në strehim mund të jetë një formë e rehabilitimit.

Koncepti i **përm bushjes**, si një formë e reparacionit, përfshin përpjekjet për ti pranuar dhe zbuluar faktet dhe rivendosjen e dinjitetit të viktimës. Ajo që mund të konsiderohet "përm bushje" ka të ngjarë të ndryshoj mes grave, vajzave, burrave dhe djemve. Të kuptuarit e turp-it shoqëror dhe stigmës është e një rëndësie të veçantë për hartimin e masave për të ofruar përm bushjen. Ndikimet shkatërruese fizike dhe fiziologjike të dhunës seksuale shpesh janë të përbëra nga stigma që ndërlidhet me të. Viktimat mund të përballen me frikën e abuzimit fizik, emocional dhe mendor, nga personat përreth tyre, gjë që në raste ekstreme të abuzimit fizik, mund të çojë edhe në vdekje apo në vetëvrasje. Për burrat dhe djemtë, viktimat e DhSNK-së, homofobia dhe konceptit i zhburrnimit ose i feminizmit të viktimave mund të çojë në stigmë dhe

42 Parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën për zgjidhje efektive dhe reparacion, parimi 8; dhe Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm për Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014), f.3

43 Cristián Correa, *Integrimi i zhvillimit dhe i reparacioneve për viktimat e krimeve në masë* (Universiteti Notre Dame, 2014), f. 9.

44 Fionnula Ní Aoláin, Catherine O'Rourke, Aisling Swaine, "Transformimi i reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin: Parimet dhe praktika", *Revista e Harvardit për të Drejtat e Njeriut*, vëllimi I. 28 (Korrik 2015), f. 121.

diskriminim shtesë.⁴⁵ Veçmas vetëcensurimit, për shkak të frikës së stigmatizimit, të mbijetuarit e dhunës seksuale mund të përballen me heshtjen aktive nga të afërmit e tyre si dhe nga komuniteti i gjerë. Frika e turp-it shoqëror dhe stigma po ashtu mund të parandalojë të mbijetuarit që të kenë qasje në mjetet efektive juridike, duke përfshirë edhe reparacionin.

Përpjekjet që synojnë për ti pranuar faktet dhe viktimat nuk duhet ti vendosin të mbijetuarit në pozitë të rrezikut të mëtejshëm nga lëndimi. Ato nuk duhet të identifikojnë, të stigmatizojnë më tej ose ti bëjnë të pafuqishme viktimat. Gratë dhe përvojat që ato kanë pasur shumë shpesh mungojnë në njohjet publike që ndërlidhen me konfliktin, dhe kur janë të pranishme, përqendrimi është në rrëfimet e grave si vetëm viktimat të dhunës. Njohja dhe përpjekjet për të rikthyer dinjitetin dhe reputacionin e të mbijetuarve duhet të jenë të ndjeshme në aspektin gjinor dhe të përqendrohen në përkrahjen e të drejtave të tyre si qytetarë të barabartë.

Koncepti i **garancive për mospërsëritje** ngjashëm është problematik nëse interpretohet ngushtësisht. Dhuna dhe pabarazia gjinore ndaj së cilës, në jetën e përditshme, ekspozohen gratë po ashtu ka një marrëdhënie simbiotike me dhunën që gratë përjetojnë gjatë konfliktit. Hulumtimet sugjerojnë se pabarazitë strukturore ekonomike dhe sociale ndaj grave krijojnë kushte të favorshme për dhunën në jetën e përditshme.⁴⁶ Po ashtu ka dëshmi se dhuna ndaj grave dhe vajzave është intensifikuar dhe përkeqësuar në situatat e stresit social-ekonomik, konfliktit dhe situatave të tjera të krizës.⁴⁷

45 Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm për Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014), f.5

46 Fionnula Ní Aoláin, Catherine O'Rourke, Aisling Swaine, "Transformimi i reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin: Parimet dhe praktika", *Revista e Harvardit për të Drejtat e Njeriut*, vol. 28 (Korrik 2015), f. 107

47 Raporti i UN Women-it nga takimi i Grupit të Ekspertëve për Parandalimin e dhunës kundër grave dhe vajzave (2012), f. 8 □ 10. Gjendet këtu: <http://www.unwomen.org/~media/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2012/11/Report-of-the-EGM-on-Prevention-of-Violence-against-Women-and-Girls.pdf>, p 8.

Dhuna seksuale që ndërlidhet me konfliktin ka qenë një karakteristikë e vazhdueshme e konflikteve gjatë epokave të ndryshme.⁴⁸ Një mënyrë për të siguruar reparacione të duhura - duke përfshirë edhe garancitë e mospërsëritjes, që është tejet e rëndësishme, është trajtimi i realiteteve strukturore të dhunës së përditshme, diskriminimit dhe pabarazisë në jetën e grave, si dhe dëmi që rezulton nga dhunimi.

D. Praktikën më të mira për qasje në reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin

Udhëzimi për hartimin e programeve kombëtare administrative për reparacion mund të gjendet në programet e reparacionit, që janë administruar deri më sot, në shtete të ndryshme.⁴⁹ Programet kombëtare administrative të reparacionit, specifiku për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, janë hartuar dhe zbatuar në shkallë të ndryshme në Peru (zbatim në shkallë të lartë), Kroaci (zbatim në shkallë të mesme në të lartë), Guatemalë (zbatim në shkallë të ulët në të mesme), Sierra Leone (zbatim në shkallë të ulët në të mesme), Bosnje dhe Hercegovinë (zbatim në shkallë të mesme), dhe Timori Lindor (nuk ka pasur zbatim fare).⁵⁰ Në vende të tjera dhuna seksuale nuk ishte një kategori eksplicite për reparacione, prandaj janë miratuar kategori më të gjëra (si viktimat të shkeljeve të të drejtave të njeriut). Sot disa vende më shumë janë në proces të hartimit të programeve administrative të reparacionit për dhunën seksuale që ndërlidhet me

konfliktin.⁵¹ Hartimi dhe zbatimi i programeve të reparacionit dallon nga vendi në vend pasi që ndryshojnë edhe lloji i konfliktit, konteksti historik, traditat ligjore, si dhe zhvillimet rajonale dhe socio-ekonomike.

Megjithatë mësimet e nxjerra nga çdo proces janë të vlefshme. Parimet dhe udhëzimet për hartimin e reparacioneve për DhSNK-të gjenden në *Parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën për zgjidhje efektive dhe reparacion*; shkresën udhëzuese të Sekretarit të Përgjithshëm për Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin; dhe Raportin e raportuesit special për promovimin e të vërtetës, drejtësisë, reparacionit dhe garancive për mospërsëritje, të Asamblesë së Përgjithshme të vitit 2014.⁵² Një përmbledhje e karakteristikave kryesore të programit të reparacioneve për DhSNK-në, bazuar në këto parime, praktika, dhe udhëzime ndodhet më poshtë.

1. Hartimi dhe zbatimi i programit të reparacionit duhet të udhëhiqet nga parimi “Mos bëj dëm”

Hartimi dhe zbatimi i programeve të reparacionit për DhSNK-në duhet të udhëhiqet nga parimi “mos bëj dëm”. Hartimi i këtij programi duhet të marrë parasysh sfidat specifike të qasjes dhe stigmatizimit. Kufizimi i qasjes në reparacione, nga një proces që kërkon regjistrimin e viktimave, mund të shfaq rrezikun e ekspozimit të viktimave, edhe nëse procesi i regjistrimit është konfidencial. Hartimi i një programi të reparacionit, në të cilin përfitimet janë në dispozicion për viktimat e dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktin, po ashtu edhe për kategori të personave të tjerë, mund të ndihmojë në fshehjen e identitetit të viktimave të dhunës seksuale, në një grup më të madh, duke shmanhur kështu stigmën.

48 Elizabeth D Heinman redaktore, *Dhuna seksuale në zonat e konfliktit: Nga bota antike deri tek epoka e të Drejtave të Njeriut* (2011).

49 Programet gjyqësore të reparacionit që përmenden, format e dhunës seksuale në mesin e listës së shkeljeve që kualifikojnë një viktimë për të marrë reparacion poashtu janë hartuar. Megjithatë, pasi që programet administrative të reparacionit kanë qasje më të gjerë, dhe Kosova ka hyrë tashmë në një proces të programit të reparacionit administrativ, këto nuk konsiderohen brenda fushëveprimit të këtij dokumenti.

50 Deri më sot, programi administrativ i reparacionit i Timorit Lindor nuk është zbatuar, megjithatë, në kuadër të mandatit të Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin, masa emergjente të reparacionit u janë siguruar viktimave që mendohej se kishin nevojë për ndihmë urgjente.

51 Siç janë Tunizia dhe Bregu i Fildishtë.

52 A/69/518.

Në Timorin Lindor, Komisioni për Pranim, të Vërtetën dhe Pajtimin (KPVP) rekomandoi që nënat beqare, të vejat dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale, që ndërlidhet me konfliktin, të pranojnë përfitime që mund t'ju ndihmojnë për të rindërtuar jetën e tyre, siç janë trajnimet për aftësi dhe për aktivitete fitimprurëse. Rekomandimi nuk ka shërbyer vetëm për t'i dhënë prioritet atyre personave, sfida më e madhe e të cilave ishte siguria financiare, por edhe për të ulur rrezikun e identifikimit të të mbijetuarve të dhunës seksuale duke mos i daluar ata.

Për programet e reparacionit, për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, që e kanë edhe procesin e regjistrimit, duhet të bëhet kujdes me rregullat procedurale për të mbrojtur interesat e viktimave, veçanërisht sigurinë dhe privatësinë e tyre. Është thelbësore që për barrën e provës të miratohen masa të arsyeshme dhe të përshtatshme.

Në Peru për regjistrimin e viktimave, është përdorur një shumëllojshmëri e mekanizmave, duke përfshirë edhe deklaratat e udhëheqësve të komunitetit dhe analizimin e informatave kontekstuale. Në Kili pagesa e reparacioneve për torturë nuk kërkonte që viktimat të japin të dhëna për përvojat e veta, apo që të dëshmojnë torturën që e kanë përjetuar. Fakti që ata janë ndaluar në një qendër të njohur, për përdorimin e torturës, ka nënkuptuar që kompensimi është bërë pa qenë nevoja të ballafaqimit me barrën e provës.

2. Hartimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i programit të reparacionit duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe i orientuar kah viktima

Reparacionet janë masa e vetme e drejtësisë tranzicionale të hartuara për përfitim direkt të mbijetuarve. Prandaj është e rëndësishme që të dëgjohen pikëpamjet e të mbijetuarve,

për forma të veçanta të reparacionit, dhe për ti dhënë prioritet resurseve, për tu siguruar që reparacionet janë efektive.⁵³ Të gjithë të mbijetuarit, e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në proceset e reparacionit dhe të trajtohen me respekt dhe kujdes për t'ju shmangur shkaktimin të ndonjë dëmi dhe traume shtesë. Pjesëmarrja dhe konsultimi duhet të lehtësohen pa pasur diskriminim në baza gjinore, identitetit, përkatësisë etnike, racës, përkatësisë politike, klasës, statusit martesor, orientimit seksual, kombësisë, fesë, dhe (pa) aftësisë, apo ndonjë statusi tjetër.

Të siguruarit që viktimat mund të marrin pjesë, në mënyrë të duhur, dhe ti kenë të përfshira perspektivat e tyre në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve të reparacionit kërkon: dhënie informacionit të duhur përmes mjeteve në të cilat mund të kenë qasje të gjitha viktimat potenciale; identifikimin e pengesave ligjore, kulturore, sociale, ekonomike, dhe të tjera, me të cilat përballen viktimat; duke i dëgjuar dhe duke i ndihmuar lidhur me shqetësimet e tyre; dhe duke ju siguruar mjedis të sigurt që lehtëson pjesëmarrjen në ato mënyra, të cilat janë të pranueshme për kulturën dhe fenë e pjesëmarrësve, dhe me numrin e madh të familjes, punës dhe detyrimeve sociale që pjesëmarrësit mund të kenë.

Vetë procesi i reparacionit, në të gjitha fazat, duhet të tentojë të rrisë përfshirjen dhe autonominë e viktimave, dhe të përshtatet me kapacitetet në zhvillim. Vetëm grupet e fokusit të grave, gjatë konsultimeve të komunitetit, mund të lehtësojnë zhvillimin e autonomisë së gruas. Të siguruarit që proceset e vendimmarrjes janë të balancuara në aspektin gjinor, mund të shërbejë për ti fuqizuar gratë që të marrin pjesë.

53 Parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën për zgjidhje efektive dhe reparacion; Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm për Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014); Raporti i Raportuesit special për promovimin e të vërtetës, drejtësisë, reparacionit dhe garancitë e mospërsëritjes, për Këshillin e të Drejtave të Njeriut A/HRC/21/46 (9 gusht 2012); dhe A/69/518.

3. Reparacionet duhet të jenë të ndjeshme në aspektin gjinor

Hartimi i një programi të reparacionit, që është i drejtë, kërkon të kuptuarit e natyrës gjinore si dhe pasojat e lëndimit të pësuar nga gratë dhe vajzat, si dhe nga burrat dhe djemtë. Pabarazitë gjinore po ashtu duhet të merren parasysh për të siguruar që reparacionet nuk marginalizojnë, izolojnë, penalizojnë ose i përjashtojnë gratë, vajzat si dhe burrat apo djemtë.⁵⁴ Duhet të merret parasysh ndërlidhja e gjinisë me format e tjera të identitetit (siç janë etnia ose feja) dhe pozicionet strukturore (siç janë mosha, arsimi apo statusi martesor).⁵⁵

Për shembull një qasje e ndjeshme gjinore, në llogaritjen e reparacionit për DhSNK-në kundër grave, duhet të marrë parasysh rëndësinë shoqërore të pjellorisë së gruas, dëlirësinë, nderin dhe rolin në shoqëri si bashkëshorte dhe nënë; pasojat e DhSNK-së për mundësitë për martesë të një gruaje; dhe faktori i mungesës së shpërblimit financiar për punën e grave në sferën private.

Ngjashëm një qasje e ndjeshme gjinore drejtë rehabilitimit duhet të marrë parasysh vështirësitë shtesë, me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit meshkuj, në qasjen e shërbimeve që ata kërkojnë. Burime shtesë mund të jenë të nevojshme për të mundësuar pjesëmarrjen e burrave dhe djemve në proceset për reparacion.

4. Reparacionet duhet të tentojnë të jenë transformuese

“Reparacionet duhet të shkojnë përtej arsyes dhe pasojave të menjëhershme të krimeve dhe dhunimeve; duhet të synojnë trajtimin e pabarazive politike dhe strukturore që e formësojnë negativisht jetën e grave dhe vajzave”. Deklarata e Nairobi për të drejtën e grave dhe vajzave për zgjidhje efektive dhe reparacion

54 Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm për Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014), f. 5.

55 A/69/518, para. 70.

Dhuna seksuale shpesh rezulton nga diskriminimi dhe e ndikon diskriminimin ekzistues dhe nënshtrimin strukturor.⁵⁶ Dhuna seksuale kundër meshkujve shpesh mund të krijohet nga stereotipet rreth maskulinitetit dhe konstrukcioneve gjinore, identitetit seksual rreth fuqisë dhe dominimit.⁵⁷ Prandaj programet e drejta dhe efektive të reparacionit, duhet të kërkojnë që ti prishin – sa më shumë që të jetë e mundur – këto struktura të diskriminimit dhe të pabarazisë.⁵⁸ Duhet të përpiqen që ti trajojnë si shkaqet ashtu edhe pasojat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Nuk duhet të rivendosin ose të përforcojnë kushtet strukturore, brenda një shoqërie, të cilat mund të kontribuojnë në vazhdimësinë e dhunës seksuale apo diskriminimin ndaj viktimave të dhunës seksuale.⁵⁹

Deri më sot aftësia e programeve të reparacionit për të qenë transformuese ka qenë e kufizuar. Megjithatë shumë është shkruar, përmes udhëzimit, për mënyrën se si programet e reparacionit, sidomos për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, mund të jenë transformuese.⁶⁰

Hapi i parë në hartimin e reparacioneve transformuese, për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, është identifikimi i themeleve politike, ekonomike, sociale dhe kulturore që

56 Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm për reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014), f.8

57 Ibid.

58 CEDAW / C / GC / 30 (2013), para. 77

59 Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm për Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014), f. 8; dhe A/69/518, para. 72.

60 Shih për shembull: Melanie Hyde, Emma Palmer dhe Sarah Williams, Reparacionet transformuese për dhunën seksuale dhe dhunën në baza gjinore në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias: Raporti i punëtorisë (28 nëntor 2014); Fionnula Ní Aoláin, Catherine O'Rourke dhe Aisling Swaine, “Transformimi i reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin”; Ruth Rubio-Marin, “Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin dhe dhuna riprodhuese: Rregullat themelore” *Revista e grave dhe drejtësisë William & Mary* (2012) 19(1), p. 69; A/69/518; Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm për Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin (qershor 2014).

mund të kontribuojnë në shkaqet themelore strukturore të pabarazisë dhe diskriminimit. Hartimi i programeve të reparacionit po ashtu kërkon pjesëmarrjen e viktimës për tu siguruar që pabarazitë mund të adresohen në mënyrë të duhur dhe të mos përkeqësohen. Kërkon rish-përndarjen e burimeve për të fuqizuar dhe për të ndikuar ndryshimin social.

Komisioni i Marokut për Barazi dhe Pajtim (KMBP) është përpjekur që të kontribuoj, me anë të mandatit të vet, në përpjekjet për të ndryshuar praktikat diskriminuese. Për shembull, KMBP-ja nuk i përdori modelet e skemave të mëparshme të kompensimit, të bazuara në ligjet e trashëgimisë tradicionale, që i parandalojnë gratë e të zhdukurve apo të vrarëve nga përfitimi i kompensimit. Përkundrazi, duke aplikuar parimet jo diskriminuese, KMBP-ja, ju dha grave reparacion duke u bazuar në rolin e tyre si bashkëshorte të viktimave. Më pas ky vendim është përdorur nga lëvizja e grave në fushatën e tyre për të ndryshuar ligjet diskriminuese të familjes.

Veçmas kësaj pasojat në shëndetin dhe mirëqenien e viktimave, diskriminimi afatgjatë dhe stigmatizimi mund të parandalojnë përparimin shoqëror dhe ekonomik të viktimave.⁶¹ Në aspektin e fuqizimit të të mbijetuarve ndarja e projekteve, sigurimi i përfitimeve të herëpashershme dhe dhënia e projekteve autonome për fuqizim, siç janë programet e kredive të vogla në kombinim me trajnime specifike, kanë treguar të jenë më të dobishme dhe më të qëndrueshme, se sa dhënia e një pagese të vetme ose nga përfitimet e njëhershme.⁶² Ofrimi i kujdesit shëndetësor dhe strehimit si dhe përfitime të tjera të nevojshme, po ashtu janë të rëndësishme për të mbijetuarit që të jenë në gjendje të përfitojnë nga këto programe. Qasja në kujdesin shëndetësor, mundësitë e arsimimit dhe të trashëgimisë për fëmijët e viktimave mund të ndihmojnë, për ti ndaluar pasojat afatgjate dhe ato mes brezave që mund të burojnë nga DhSNK-ja, si

61 Cristián Correa, *Integrimi i zhvillimit dhe i reparacioneve për viktimat e krimeve në masë*, f.13.

62 A/69/518, para. 73.

dhe të parandalojnë pabarazitë strukturore ndërmjet gjeneratave.

Qëllimi i reparacioneve transformuese është për të trajtuar si shkakun ashtu dhe pasojat e dhunës dhe/ose shkeljes. Përcaktimi i një standardi, për të udhëhequr zhvillimin dhe zbatimin e reparacioneve, mund të ndihmojë në trajtimin e shkaqeve dhe pasojave të dhunës. Correa me elokucencë sugjeron se një standard i përshatshëm, për reparacionet, është ofrimi i një mesazhi konkret të përkatësisë dhe dinjitetit⁶³. Duke qenë se shkeljet e rënda të drejtave të njeriut, si dhuna seksuale që ndërlidhet me konfliktin, mund të shihen si mesazh që e mohon dinjitetin dhe përkatësinë e viktimës në bashkësi, si dhe mosveprimi apo keqtrajtimi i mëtejshëm mund ta përforcojë këtë mesazh, andaj qëllimi i reparacioneve duhet të jetë ofrimi i së kundërtës të mesazhit. Për këtë arsye, të gjitha masat reparative, duhet të synojnë dhënien dhe përforcimin e mesazhit të përkatësisë dhe dinjitetit.

5. Reparacioni i duhur, për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, kërkon një kombinim të formave të ndryshme të reparacioneve

Reparacionet mund të marrin forma të ndryshme, dhe në përgjithësi kategorizohen si materiale, simbolike, individuale ose kolektive. Format e reparacionit material mund të përfshijnë pagesat me para në dorë ose shërbime dhe përfitime siç janë kujdesi shëndetësor, strehimi apo arsimimi. Format e reparacioneve simbolike mund të përfshijnë kërkim faljen zyrtare, vendosjen e memorialëve dhe/ose dedikimin e hapësirave publike (siç janë muzetë, parqet ose ndryshimi i emrave të rrugëve), ditët përkujtimore ose masat rehabilituese si rikthimi i dinjitetit dhe i nderit viktimave. Reparacionet individuale janë për të mirën e individëve të veçantë kurse reparacionet kolektive janë për grupe të veçanta ose komunitete. Reparacionet individuale dhe kolektive duhet të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra tjetrën. Programet e repara-

63 Cristián Correa, *Integrimi i zhvillimit dhe i reparacioneve për viktimat e krimeve në masë*, f.12

cionit, veçmas përfshirjes së elementeve materiale dhe simbolike, të individëve dhe kolektiviteve, mund të jenë po ashtu më efektive kur i kombinojnë përfitimet e menjëhershme dhe ato të vazhdueshme.

Në Kolumbi, 25 maji është shpallur "Dita Kombëtare për dinjitetin e grave viktime të dhunës seksuale të shkaktuara nga konfliktet e brendshme të armatosura". Dita përkujtimore është një nga masat e reparacionit kolektiv të propozuar nga një i mbijetuar i DhSNK-së, për të njohur vuajtjet fizike të përjetuara nga viktimat e DhSNK-së dhe për të rivendosur dinjitetin e tyre.

Derisa një program efektiv i reparacionit shpërndan përfitime, në aso mënyre që çdo i mbijetuar të kthehet në përfitues,⁶⁴ kombinimi i formave të ndryshme të reparacioneve mund të ndihmojë për të arritur rezultate maksimale. Kombinimi i formave po ashtu mund të shërbejë edhe për ti shumëfishuar resurset pasi që programet, nga të cilat përfitojnë të dyja palët, si individët ashtu edhe kolektivitetet, mund të mbulojnë një numër më të madh të të mbijetuarve.⁶⁵ Derisa jo të gjithë të mbijetuarit, e dhunës seksuale që ndërlikohet me konfliktin, mund të duan të identifikohen si të tillë (edhe nëse proceset e identifikimit janë konfidenciale), kombinimi i formave po ashtu ndihmon për të arritur deri te ata që nuk dëshirojnë të aplikojnë për përfitime individuale. Përfshirja e masave të shumta reparative brenda një pakoje të reparacioneve – për shembull pagesat, kujdesi shëndetësor, bursat, qasja në strehim dhe format simbolike të reparacioneve – po ashtu ofron ndihmë për nevoja të ndryshme, pa pasur nevojë që të dërgohet një mesazh i një vlere tjetër të vuajtjes.⁶⁶

64 A/69/518 para 23.

65 Ibid., para 31.

66 Cristián Correa, *Integrimi i zhvillimit dhe i reparacioneve për viktimat e krimeve në masë*, f.12.

Në qershor të vitit 2015 Parlamenti i Kroacisë miratoi një ligj i cili të gjitha viktimave të dhunës seksuale të luftës u ofron një pagesë të njëjshme, si dhe një kompensim mujor për gjithë jetën e tyre dhe qasje në ndihmë juridike, sigurim të detyrueshëm dhe sigurim shtesë shëndetësor, kontrolle vjetore mjekësore dhe strehim në institucionet që ofrojnë shërbime dhe ndihmë për veteranët e luftës dhe viktimat e luftës.

Edhe pse format materiale të reparacionit janë shpesh të parat që vijnë në mendje, reparacionet simbolike janë mjete të rëndësishme, nëpërmjet të cilave mund të adresohen dëmet dhe lëndimet, që nuk mund të riparohen me para (siç është stigma), dhe komunitetet mund të ndihmohen, për ti dhënë kuptim ngjarjeve të dhimbshme të së kaluarës, dhe mesazhi i përkatësisë dhe dinjitetit mund të përforcohet.⁶⁷ Njohja nga ana e shtetit është një formë kyçe e reparacionit simbolik, gjë që është e rëndësishme në trajtimin dhe luftimin e stigmës dhe rivendosjen e viktimës në një pozicion të vlefshëm.⁶⁸ Afirmimi i shpeshtë i mesazhit të përkatësisë dhe dinjitetit mund të shërbejë për ta përforcuar atë.⁶⁹ Format simbolike të reparacionit janë një pjesë integrale e reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlikohet me konfliktin; megjithatë në hartimin e formave simbolike të reparacionit, nevojitet kujdes, për të mos rritur edhe më tej stigmën dhe stereotipet që iu bashkangjiten të mbijetuarve.⁷⁰ Perspektivat nga të mbijetuarit, për formën e reparacionit simbolik, janë të rëndësishme për të siguruar së kjo formë është kuptimplote dhe e padëshme.

67 Ibid.; A/69/518, para 33

68 Fionnula Ní Aoláin, Catherine O'Rourke dhe Aisling Swaine, "Transformimi i reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlikohet me konfliktin", f. 118.

69 Cristián Correa, *Integrimi i zhvillimit dhe i reparacioneve për viktimat e krimeve në masë*, f.17.

70 Shkresa udhëzuese e Sekretarit të Përgjithshëm për Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlikohet me konfliktin (qershor 2014), f.7.

6. Lidhja e reparacioneve me zhvillimin

E drejta për reparacion dhe e drejta për zhvillim janë të drejta të dallueshme. Shtetet e kanë përgjegjësinë kryesore për të siguruar reparacionet për viktimat e shkeljeve të rënda të Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe të shkeljeve serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.⁷¹ Politikat e zhvillimit shpesh kanë një fokus më të gjerë, duke synuar grupe të mëdha dhe komunitete të cilët mund të vuajnë nga marginalizimi dhe nga varfëria. Programet e zhvillimit nuk duhet të përdoren si zëvendësim për programet e reparacionit, përkundër këtij argumentimi, funksionet dhe qëllimi i programeve të reparacionit dhe zhvillimit mund të lidhet me përfundimin e përbashkët dhe afatgjatë, duke siguruar ndikime pozitive afatgjata për mirëqenien e të mbijetuarve dhe të komuniteteve.

Hartimi i programit të reparacionit duhet të marrë parasysh kapacitetin e shtetit për të siguruar reparacione. Ka pak dobi në hartimin e një programi të reparacionit ku ka pak vullnet politik ose kapacitet për ta zbatuar. Duke vepruar kështu pritjet e viktimave mund të pësojnë disfatë dhe të dëmtohet qëllimi i reparacioneve, duke shkaktuar mosbesim mes viktimave dhe shtetit. Palët e përfshira në procesin e zhvillimit mund t'ju ndihmojnë autoriteteve, që ti zhvillojnë kapacitetet, për të ofruar reparacione dhe të përforcojnë programet e reparacionit nëpërmjet infrastrukturës, që mund të ofrojnë reparacionin, siç janë shkollat, spitalet dhe shpërndarja e informacionit për përfituesit e mundshëm.

Programet e reparacionit dhe programet e zhvillimit mund të rrisin efikasitetin e njëri tjetrit. Për shembull, programet e reparacionit, veçanërisht për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, mund të ndihmojnë zhvillimin duke fuqizuar të mbijetuarit, të cilët mund të marrin pjesë në vendimmarrje lidhur me zhvillimin, dhe të përfitojnë në mënyrë më të drejtpërdrejt nga programet e zhvillimit. Ngjashëm programet e

zhvillimit mund të ndihmojnë për të rritur efikasitetin e resurseve, në dispozicion për reparacionin, dhe të vazhdojnë të përforcojnë qëllimet dhe objektivat e programeve të reparacionit në një periudhë afatgjate. Kjo ka rëndësi për trajtimin e dëmit afatgjatë dhe sidomos diskriminimin ngase nuk është diçka që mund të zgjidhet në një periudhë të shkurtër kohore.

71 Parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën për zgjidhje efektive dhe reparacion.

III. REPARACIONET PËR DHUNËN SEKSUALE QË NDËRLIDHET ME KONFLIKTIN NË KOSOVË

Ky raport fokusohet në të drejtat dhe nevojat që i kanë sot, 16 vjet pas përfundimit të konfliktit në Kosovë, të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, si dhe flet për mënyrat se si këto çështje duhet të trajtohen përmes një programi gjithëpërfshirës të reparacionit.⁷² Domosdoshmërisht fokusohet në perspektivat dhe zërat e grave të mbijetuara ngase vetëm ato ishin në gjendje të marrin pjesë në konsultimet për hartimin e një programi për reparacion. Por kjo nuk duhet të kuptohet, si sugjerim, se të gjitha gratë kosovare kanë përjetuar dhunë seksuale, ose që viktimat e dhunës seksuale nuk kanë pësuar përvoja të tjera gjatë konfliktit. Në të vërtetë, aktivizmi i jashtëzakonshëm i grave, gjatë konfliktit në Kosovë, ka qenë mirë i dokumentuar.⁷³ Gratë ishin të angazhuara në kontrabandimin e mallrave nëpër pikat e kontrollit duke shpërndarë ndihma humanitare, në vijat e frontit, dhe duke u kujdesur për të plagosurit në ditët e para të konfliktit. Pasi që luftimet u intensifikuan organizatat e grave i kanë dhënë ndihmë njerëzve që iknin nga dhuna, duke iu ndihmuar të zhvendosurve me ushqim, strehim, mbështetje, kujdes mjekësor dhe nevoja të tjera, si dhe duke punuar me OJQ-të ndërkombëtare për të monitoruar dhe raportuar mbi shkeljet e të drejtave të njeriut. Gjatë kaosit

të konfliktit shumë gra e kanë vërejtur nevojën për të punuar në shërimin e traumave dhe kanë zhvilluar metoda për t'ju dhënë mbështetje njerëzve me trauma.⁷⁴ Ky aktivizëm erdhi me një çmim, megjithatë për shumicën e këtyre grave burgosja, marrja në pyetje, ngacmimet e policisë si dhe lodhjet fizike dhe psikologjike nuk ishin të panjohura. Si pasojë e konfliktit shumë gra (duke përfshirë të mbijetuarat e dhunës seksuale) u bënë kryefamiljare, të cilat, në të njëjtën kohë, duhet të merreshin me traumat dhe me përgjegjësitë e reja ekonomike.

Të fokusuarit në perspektivat e grave po ashtu nuk sugjeron se vetëm gratë kanë përjetuar dhunë seksuale. Të mbijetuarit meshkuj, të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, kanë folur për përvojat e tyre dhe disa nga ata kanë kërkuar shërbimet e organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë mbështetje psiko-sociale.⁷⁵ Për fat të keq, infrastruktura, për ti mbështetur burrat dhe djemtë që kanë përjetuar dhunën seksuale, ka qenë e kufizuar dhe përvojat e burrave nuk kanë qenë në qendër të përpjekjeve të dokumentimit. Deri më sot vetëm një ofruer i shërbimeve, ka qenë në gjendje që t'ju ofroj ndihmë të mbijetuarve meshkuj. Thuhet se një ofruer tjetër është kontaktuar nga disa të mbijetuar meshkuj për

72 Duke pasur parasysh sa kohë ka kaluar nga konflikti, fëmijët viktimat, të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, sot janë të rritur dhe për këtë arsye iu referohemi si gra dhe burra të mbijetuar.

73 Shih për shembull: Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Historia është edhe tregimi i saj: Historia e Grave në Shoqërinë Civile në vitet 1980 - 2004, (Prishtinë/ Priština, 2008).

74 Ibid., p 132

75 Një shembull i kohëve të fundit i rrëfimit të një burri për dhunën seksuale që ai e ka përjetuar gjatë luftës mund të gjendet në raportimin medial: Arton Konushevc, 'Rrëfimi i një burri, viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë' (2016), (23 mars) Radio Evropa e Lirë.

ndihmë, por nuk e ka pasur kapacitetin për të reaguar. Gjatë diskutimeve në grup një grua, e mbijetuar e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, vuri në dukje se një i afërm i saj i ri për nga mosha, po ashtu ka pësuar nga dhuna seksuale gjatë konfliktit, por nuk ka qenë e mundur që ai të lidhet me ndonjë nga ofruesit e shërbimeve, kryesisht për shkak të frikës që do të bëhet e njohur dhuna e ushtruar kundër tij, dhe për shkak të pasojave të mundshme shoqërore që mund të rrjedhin nga ky identifikim.

Dhuna seksuale që ndërlidhet me konfliktin ka ndodhur në tërë Kosovën para, gjatë dhe pas konfliktit. Megjithatë deri më sot nuk ka pasur asnjë dokumentim sistematik apo hulumtim mbi dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë. Pjesa më e madhe e dokumentimit, të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, e ka përshkruar dhunën seksuale të kryer nga policët ose nga paraushtarakët serbë, ndaj grave shqiptare. Besohet që dhunimi të jetë përdorur për të çnjerëzuar shqiptarët e Kosovës, sidomos gratë potencialisht ishin në shënjestër të përpjekjes për të penguar aktivizmin dhe mbështetjen e tyre për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Megjithatë ka pasur gjithashtu raportime për dhunë seksuale, ndaj grave romë, ashkallie, egjiptiane dhe serbe, nga autorë të tjerë të këtyre veprave.⁷⁶ Po ashtu ka pasur dhunë seksuale kundër meshkujve por është raportuar dhe dokumentuar në nivel edhe më të ulët.

Brenda rrëfimeve të dokumentuara, të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, janë identifikuar forma të ndryshme të dhunës seksuale.⁷⁷

Megjithatë disa nga ofruesit e shërbimeve dhe

76 Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Historia është edhe tregimi i saj; Fondi për të Drejtën Humanitare, "Romët e Kosovës: Shënjestër e abuzimit dhe dhunës, 24 mars - 1 shtator 1999". Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.greekhelsinki.gr/english/reports/hlc-march-sept-1999.html>; dhe një ofrues i shërbimeve në Kosovë ka raportuar që ofron shërbime për romët, ashkallinjë dhe egjiptianët të cilët janë të mbijetuar të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.

77 Shih për shembull: Human Rights Watch, "Kosova: Dhunimi si armë e spastrimit etnik", (2000). Në dispozicion në vegzën vijuese <http://www.hrw.org/legacy/reports/2000/fry/index.htm#TopOfPage>

palët e përfshira, të cilët janë të angazhuar në përpjekjet e avokimit, për njohjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, kanë pikëpamje të kufizuara për dhunën seksuale, duke e menduar vetëm përdhunimin (aktet e penetrimin). Për shembull, thuhet se një organizatë ka refuzuar ofrimin e shërbimeve për viktimat e lakuriqësisë së detyruar dhe i ka përjashtuar ato nga aktivitetet tjera.

Ngjashëm njohja e veprimeve të kryera pas përfundimit formal të luftimeve mbetet sfiduese. Dihet gjerësisht se dhuna seksuale ka vazhduar edhe pas përfundimit zyrtar të luftimeve dhe konsiderohet se kjo është mundësuar nga mungesa e infrastrukturës, menjëherë pas luftës, siç janë ndërprerjet e energjisë dhe ndriçimi i dobët.⁷⁸ Megjithatë korniza aktuale ligjore, për njohjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, për sigurimin masave reparative, është e kufizuar për personat që kanë pësuar dhunë seksuale ndërmjet 27 shkurtit të vitit 1998 dhe 20 qershorit të vitit 1999.⁷⁹

Nga dhuna seksuale që ndërlidhet me konfliktin ka pasur pasoja të rënda në Kosovë. Viktimat kanë pësuar lëndime fizike dhe trauma psikologjike. Shumë gra kanë kërkuar të kryejnë aborte në situata dëshpëruese dhe të tjera kanë lindur fëmijë që kanë qenë fryt i dhunimit.⁸⁰ Turpi social dhe stigma, me të cilën përballen viktimat e dhunës seksuale, e ka penguar shumicën prej tyre për të pasur qasje në shërbimet e kujdesit dhe rehabilitimit. Perceptimet ose qëndrimet aktuale të komunitetit, ndaj të mbijetuarve të dhunës seksuale, kanë çuar në disa vdekje të shkaktuara nga vetëvrasja. Një numër tjetër i vogël ka vdekur nga dhuna në familje e kryer

78 CIVPOL ka regjistruar 362 raste të dhunës/sulmit seksual nga viti 2000-2002 (raportet vjetore); Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Historia është edhe tregimi i saj, f. 275.

79 Ligji nr. 04/L-172 neni 4 (3.6).

80 Sipas gazetës angleze The Guardian, organizatat humanitare si Kryqi i Kuq Ndërkombëtar kanë vlerësuar se në janar të vitit 2000 në Kosovë kanë lindur afërsisht njëqind foshnja si rezultat i dhunimit: Helena, S., "Viktimat e dhunimit" Foshnjat paguajnë çmimin e luftës ", *The Guardian*, 16 prill 2000.

kundër viktimave, në emër të nderit. Për disa kjo e ka kufizuar ose ka fshirë tërësisht të drejtën e tyre për t'u martuar, duke ndikuar edhe më tej në statusin e tyre në shoqëri. Të tjerat janë refuzuar nga burrat e tyre, ose janë bërë barrë financiare dhe burim i mbetur i turpit për familjet e tyre. Ende shumë prej tyre, pas 16 vjetësh, nuk kanë treguar përvojat e veta nga frika e pasojave, si izolimi, nga komunitetet e tyre apo edhe nga vetë familjet. Të mbijetuarit kishin, dhe në shumë raste vazhdojnë të kenë, nxitës të fuqishëm që të heshtin për përvojat e tyre, gjë që ua ka përkeqësuar traumat e tyre psikologjike.⁸¹ Duhet theksuar se kjo nuk është situata për të gjithë të mbijetuarit. Një numër i vogël e gëzon mbështetjen e anëtarëve të familjes dhe kanë përfituar shumë nga shërbimet psiko-sociale dhe shërbimet e tjera të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile.

Pjesa më e madhe e mbështetjes, për të mbijetuarit e dhunës seksuale, ka ardhur nga organizatat të shoqërisë civile të drejtuara nga gratë. Gjatë konfliktit ato u bënë hapësira për gratë të mblidhen në një vend dhe ti ndajnë përvojat e tyre. Shërbimet dhe nismat e avokimit, të këtyre organizatave, kanë evoluar me kalimin e kohës, nga ofrimi i kujdesit për traumat gjatë dhe menjëherë pas konfliktit, tek shërbimet psiko-sociale, dhe kohëve të fundit edhe në mundësi për gjenerimin e të hyrave në shkallë të vogël. Këto organizata, veçanërisht ato katër që ofrojnë shërbime sot - Medica Kosova, Medica Gjakova, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave - si dhe grupet e avokimit dhe mbështetjes dhe rrjete të ndryshme si Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, kanë qenë të jashtëzakonshme në përshtatjen e tyre me nevojat në zhvillim të të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.

81 Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Historia është edhe tregimi i saj, f. 276.

A. Nismat aktuale të reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë

Palë të ndryshme, të përfshira në këto procese, kanë ndërmarrë një sërë hapash për të arritur njohjen dhe reparacionin për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë. Një listë e plotë e këtyre nismave është përfshirë në Shtojcën I. Duke qenë se obligimi për të përmbushur të drejtën e reparacionit, për viktimat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, është detyrim shtetëror, fokusi i këtij seksioni është në hapat e ndërmarrë, deri më sot, nga autoritetet e Kosovës për të përmbushur këtë detyrim.

Në pak vite, autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për ti trajtuar të drejtat dhe nevojat e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Këto hapa mund të përmbledhen si më poshtë:

Më 4 qershor 2012, në Kosovë, u krijua Grupi Punues Ndërministror për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin (GPNM BKP) me qëllimin kryesor për hartimin e një "strategjie të drejtësisë tranzicionale".⁸² Në strukturën e vet grupi punues ka katër nëngrupe të punës, për katër shtyllat tradicionale të drejtësisë tranzicionale: nëngrupi për të drejtën për reparacion; nëngrupi për të drejtën për drejtësi; nëngrupi për të

82 Grupi Punues Ndërministror për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin (GPNM BKP) në Kosovë është themeluar me vendim të Qeverisë nr. 03/77 (04 qershor 2012). GPNM BKP-ja përbëhet nga 16 përfaqësues të institucioneve qeveritare, si dhe 8 përfaqësues të shoqërisë civile, duke përfshirë përfaqësues në cilësinë e ekspertëve dhe vëzhguesve në aktivitetet dhe mbledhjet e tij. Takimi i parë i GPNM BKP-së u zhvillua më 18 mars 2013. Më 15 tetor 2014, Qeveria miratoi Rregulloren e punës për GPNM BKP-së (vendimi nr. 02/200 15 tetor 2014) i cili përcakton mandatin e GPNM BKP-së, detyrimet e anëtarëve, sekretariatit dhe udhëheqjen; dhe Planin e Punës të GPNM BKP-së, për vitet 2015-2017 (vendimi nr. 03 /200 i datës 15 tetor 2014) i cili i përcakton aktivitetet për hartimin e Strategjisë së drejtësisë tranzicionale dhe afatin kohor për zbatimin e secilit aktivitet. Rregullorja GRK Nr. 18/2014 (7 nëntor 2014) përshkruan punën e GPNM BKP-së.

drejtën për të ditur; dhe nëgrupi për garantitë e mospërsëritjes. Këto grupe kanë mbajtur takime gjysmë të rregullta, të cilat kanë kulmuar në skicimin e objektivave për punën e tyre, kanë hartuar nismat e drejtësisë tranzicionale dhe kanë identifikuar çështjet kryesore për drejtësinë tranzicionale në Kosovë. GPNM BKP-ja, për tu ballafaquar me të kaluarën dhe pajtimin, aktualisht është në proces të përgatitjes së konsultimeve kombëtare, të cilat janë menduar të nisnin në vitin 2016.

- Më 29 janar 2014 Qeveria e miratoi planin e veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila përfshin si njërin nga tre rezultatet e saj, ofrimin e reparacionit për të mbijetuarit e dhunës seksuale dhe të dhunës mbi baza gjinore, që ndërlidhen me konfliktin.
- Më 5 mars 2014, Presidentja e Kosovës, me një dekret të veçantë presidencial, e ka themeluar Këshillin Kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë (Këshilli Kombëtar). Këshilli Kombëtar i ka bërë bashkë përfaqësuesit e ministrive kyçe, të shoqërisë civile dhe zyrtarë ndërkombëtarë që mund ti mbështesin të mbijetuarit e dhunës drejt një reagimi më të përmirësuar dhe më mirë të koordinuar. Anëtarët e Këshillit përfshijnë ministra, përfaqësues të gjyqësorit dhe prokurorë, si dhe organizata të shquara të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare.
- Më 20 mars 2014, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar *Ligjin nr. 04 / L-172 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/ L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre*, i cili ligjërisht e njeh statusin e viktimave civile, të dhunës seksuale, gjatë konfliktit të fundit të armatosur në Kosovë.
- Më 30 dhjetor 2015, Qeveria e Kosovës miratoi një rregullore për të zbatuar ndryshimet e Ligjit nr. 04/L-054, në mënyrë

specifike për të njohur dhe për të siguruar përfitimet e parashikuara me ligjin nr. 04/L-172. *Rregullorja nr. 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës Çlirimtare të Kosovës*, përcakton kriteret dhe procedurat për verifikimin e viktimave të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Gjithashtu e siguron autoritetin për themelimin e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës Çlirimtare të Kosovës.

- Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës është në proces të themelimit. Zyra ligjore e Kryeministrit është duke i udhëhequr proceset e nevojshme për themelimin e këtij Komisioni.

1. Korniza aktuale ligjore vendore për trajtimin e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin

Procesi i arritjes së reformës legjislative për ti njohur të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë, ndonëse ka pasur një fillim të ngadalshëm, është një testament për forcën e shoqërisë civile, gatishmërinë e partive dhe autoriteteve politike, dhe aftësinë e të dy grupeve për të punuar së bashku, në mënyrë efikase dhe efektive për një qëllim të përbashkët.⁸³ Ndryshimi i ligjit nr. 04/L-054 për të siguruar njohjen ligjore, për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, në Kuvendin e Kosovës, është dërguar në mars të vitit 2013, nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. Komisione të ndryshme parlamentare i kanë bërë ndryshimet e mëtejshme në amendamentin para se i njëjti të bëhet *Ligji nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre* dhe që hyri në fuqi në mars të vitit 2014.

⁸³ Hapat e ndërmarrë nga palë të ndryshme të përfshira në proces janë paraqitur në Shtojcën I

Legjislacioni zbatues për amendamendimin e ligjit nr. 04/L-054, përkatësisht *Rregullorja nr. 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës Çlirimtare të Kosovës*, është hartuar në një proces gjithëpërfshirës, nën udhëheqjen e Zyrës ligjore të Kryeministrit. Një grup pune i Këshillit Kombëtar, i përbërë nga përfaqësues të ministrive të ndryshme dhe përfaqësues të shoqërisë civile, ka bashkëpunuar në hartimin e draftit dhe ka nxjerr mësimet e duhura nga një proces i ngjashëm në Bosnjë dhe Hercegovinë. Rregullorja nr. 22/2015 hyri në fuqi në shkurt të vitit 2016.

Një përmbledhje e përfitimeve, për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, në të cilat ata do të kenë të drejtë pasi që të verifikohen nga Komisioni, së bashku me përfitimet për kategoritë e tjera të personave të parashikuara sipas ligjit nr. 04/L-054, mund të gjendet në Shtojcën II. Si përfundim, dispozitat e ndryshimeve legjislative për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin janë si në vijim:

Përfituesit: “Viktimë e dhunës seksuale të luftës” definohet personi i cili i ka mbijetuar abuzimit seksual dhe përdhunimit brenda periudhës 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999.⁸⁴ Përfituesit e ligjit do të përcaktohen pas rishikimit të rasteve nga komisioni përgjegjës qeveritar.⁸⁵

Përfitimet:

1. Pensionet.⁸⁶ (Do të përcaktohet nga vendimi i qeverisë)⁸⁷
2. Përfitime të tjera:⁸⁸
 - a. Shërbimet shëndetësore jashtë vendit, për trajtim të gjendjes së përkeqësuar, që janë pasojë e luftës, për të cilën nuk ka shërim në Kosovë.⁸⁹

84 Ligji nr. 04/L-172 neni 4 (3.6).

85 Ligji nr. 04/L-172 art 7, që ndryshon Ligjin nr. 04/L-054 neni 14 (i shtuar si 2.8).

86 Ligji nr. 04/L-054 art 5 (1.2.3).

87 Ligji nr. 04/L-172 art 7, që ndryshon Ligjin nr. 04/L-054 neni 14.

88 Seksionet e aplikueshme të nenit 6 të ligjit nr. 04/L-054.

89 Ligji nr. 04/L-054 art 6 (1.5).

b. Përparësi në punësim, në sektorin publik dhe atë privat, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-19 për aftësim, rehabilitim profesional dhe punësim.⁹⁰

c. Lirimi nga tatimi në pronë për viktimat të cilat kanë kushte të vështira ekonomike.⁹¹

d. Përkujdesje për banim në qendrat kolektive të banimit social për personat që janë në gjendje të rëndë ekonomike.⁹²

3. Rregullorja nr. 22/2015 i mundëson komisionit të marr parasysh rastet që kanë nevojë urgjente për ndihmë mjekësore.⁹³

Ndryshimet legjislative janë hapa të mëdhenj pozitivë drejt njohjes dhe trajtimit të nevojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Megjithatë ndërtimi i kufizuar i përfituesve dhe përfitimeve paraqet disa vështirësi.

Afati kohor për përfituesit, të cilët kualifikohen për përfitime, është shumë i ngushtë. Dhuna seksuale ka ndodhur teksa shkohej në konflikt dhe pas përfundimit formal të luftimeve, menjëherë pas konfliktit të armatosur. Kufizimi i përfituesve të mundshëm, vetëm për personat që i mbijetuan abuzimit seksual dhe përdhunimit brenda periudhës 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999, i përjashton personat që kanë përjetuar dhunën seksuale, si rezultat i këtij konfliktit, jashtë këtij afati kohor. Veçanërisht e përjashton dhunën seksuale që ka ndodhur gjatë sulmeve hakmarrëse, ku preken personat e të gjitha grupeve etnike, por sidomos serbët. Sipas ligjit nr. 04/L-172, civilët e humbur janë ata që janë raportuar të humbur nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000. Është sugjeruar se kjo është një kornizë, më e përshtatshme kohore, për njohjen e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.

Në kohën e shkrimit të këtij dokumenti shuma e pensionit, që do të merret nga viktimat e verifikuara të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, ende nuk është përcaktuar. Prandaj nuk dihet se sa efektive kjo do të jetë në tra-

90 Ligji nr. 04/L-054 art 6 (1.8).

91 Ligji nr. 04/L-054 art 6 (4).

92 Ligji nr. 04/L-054 neni 6 (6).

93 Rregullorja nr. 22/2015, neni 28.

jtimin e nevojave të të mbijetuarve.

Ofrimi i qasjes në shërbimet shëndetësore pa pagesë jashtë Kosovës, në shikim të parë, duket të jetë i dobishëm. Megjithatë mungesa e qasjes në kujdesin shëndetësor pa pagesë, brenda Kosovës, paraqet një sfidë të madhe për të mbijetuarit. Për më tepër e drejta për shërbime shëndetësore jashtë vendit është e lidhur ngushtë me gjendjen e përkeqësuar, për të cilën është duke u kërkuar kujdesi shëndetësor, e cila gjendje rezultoi nga dhuna seksuale. Ky është pothuajse një prag i pamundur, për tu përmbushur, për shumë nga të mbijetuarit që vuajnë nga sëmundje të rënda siç janë kanceri, epilepsia, ose problemet me zemrën.

Përderisa diskriminimi pozitiv për të mbijetuarit është krijuar dhe tërheqës, në praktikë dhënia e përparësisë, për viktimat që tashmë janë të verifikuara, në fushën e punësimit, është e vështirë për tu bërë pa e zbuluar identitetin e pranuesit (të punës) si një i mbijetuar i dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Ngjashëm përfitimet nga qasja në lirime nga tatimet dhe qasja në banim social për të mbijetuarit, në kushte të vështira ekonomike, do të jetë e vështirë për tu zbatuar, pa i zbuluar aplikuesit si të mbijetuar të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Lirimi nga taksat e banimit (tatimi në pronë) është shërbim i kufizuar, pasi që shumica e të mbijetuarve janë gra, dhe tradicionalisht gratë nuk zotërojnë pronë në emrin e tyre. Qasja në strehim mund të jetë me dobi të madhe për disa prej të mbijetuarve; megjithatë, është e paqartë nëse të mbijetuarit do të përfshihen në grupin e prioritetizuar të personave që e gëzojnë këtë të drejtë,⁹⁴ dhe aktualisht qasja në këtë lloj strehimi është i kufizuar.

Rregullorja nr. 22/2015 ofron një kornizë për proceset administrative, të komisionit qeveritar, për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, duke përfshirë edhe formularin e aplikimit që do të përdoret. Komisioni, pasi të themelohet, do të përcaktoj specifikat e

94 Ligji nr. 04/L-054 parasheh prioritetimin në qasje në banim social i cili do të sigurohet për familjet e martirëve dhe për familjet e personave të zhdukur, dhe invalidët: neni 6 (6)(6.1).

procesit të aplikimit dhe kriteret sipas të cilave do të vendoset për aplikimet. Përderisa definimi i përfituesve, në të gjitha versionet e ligjit, parashikon për viktimat e abuzimit seksual dhe dhunimit,⁹⁵ emri i Komisionit (siç përcaktohet në ligjin nr. 04/L-172), në gjuhët zyrtare të Kosovës, shqip dhe serbisht, e rrit shqetësimin rreth asaj se si komisioni, për qëllime të verifikimit, do të përcaktoj dhunën seksuale.⁹⁶ Titulli i Komisionit në të dy versionet e ligjit, shqip dhe serbisht, është përkthyer kështu “Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës” (nënvizimi i shtuar)⁹⁷. Në versionin anglisht të ligjit titulli është “Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës Çlirimtare të Kosovës” (nënvizimi i shtuar).

Një vështirësi tjetër, që vjen nga përkthimet e ndryshme, ka të bëjë me përjashtimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, sipas shkallës së invaliditetit që aplikohet për viktimat e llojeve të tjera të dhunës. Viktimat civile dhe ato nga rradhët e UÇK-së, me aftësi të kufizuara që i atribuohen konfliktit, sipas ligjit kategorizohen në bazë të shkallës së tyre të invaliditetit, me përfitime të ndryshme sipas kategorisë.⁹⁸ Në versionin anglisht të ligjit nr. 04/L-172, neni 7 parashikon se “viktimat e dhunës seksuale të luftës, do të përjashtohen nga shkalla e invaliditetit” (nënvizimi i shtuar). Ky besohet të jetë qëllimi prapa kësaj dispozite; megjithatë, e njëjta dispozitë, në versionet shqip dhe serbisht, përkthehet në: “viktimat e përdhunimit të luftës do të përjashtohen nga shkalla e invaliditetit” (nënvizimi i shtuar).⁹⁹ Ky gabim në përkthim ose dështim për të vërejtur gabimin, mund të çojë në interpretimin se vetëm të mbijetuarit

95 Ligji nr. 04/L-054 neni 4 (3.6).

96 Gjuhët zyrtare në Kosovë janë shqipja dhe serbishtja: Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve zyrtare, neni 2.1.

97 Shqip: Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës. Serbisht: Vladina Komisija za priznavanje i verifikaciju statusa osoba silovanih tokom Oslobođilačkog Rata na Kosovu: Ligji nr. 04/L-172 neni 8.

98 Shih Shtojcën II.

99 Shqip: përjashtim nga shkalla e invaliditetit bëjnë personat e dhunuar gjatë luftës. Serbisht: Za lica silovana tokom rata ne primenjuje se stepen invalidnosti Ligji nr. 04/L-172, neni 7 (2.6).

e dhunimit, dhe jo të formave të tjera të dhunës seksuale, janë të përjashtuar nga të qenit të kategorizuar në bazë të shkallës së invaliditetit. Kjo e ngritë shqetësimin për atë se si mund të vlerësohet, përveç përdhunimit, shkalla e invaliditetit për një të mbijetuar të dhunës seksuale. Mund të supozohet se ky vlerësim, do të jetë jo vetëm një detyrë e vështirë për tu kryer, por edhe do të dekurajoj të mbijetuarit e dhunës seksuale që të aplikojnë tek komisioni për verifikim, në mënyrë që ti marrin përfitimet që ju takojnë sipas ligjit.

Procesi i aplikimit për verifikim, nga ana e komisionit, është hartuar në konsultim me përfaqësuesit e shoqërisë civile, që ofrojnë shërbime për të mbijetuarit, dhe në bazë të mësimave të nxjerra nga programe të tjera të reparacionit, veçanërisht programi i Bosnjës dhe Hercegovinës. Aplikuesit mund të paraqesin formularin me shkrim për aplikim (i bashkangjitur në Rregulloren nr.22/2015) tek komisioni nëpërmjet tri metodave: nëpërmjet një OJQ-je të autorizuar, nëpërmjet zyrës rajonale të departamentit të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës (DFDIL); ose direkt tek sekretariati i komisionit me postë ose personalisht.¹⁰⁰ Këto metoda janë përcaktuar për të shmangur stigmatizimin e mëtejshëm të aplikuesve. Lokacionet e përdorura, të cilat tashmë janë të vizituara nga të mbijetuarit, mund të sigurojnë një nivel më të lartë të konfidencialitetit, si dhe ofrimi me shkrim i informacioneve është rregulluar për të parandaluar identifikimin e panevojshëm të të mbijetuarve. Do të jetë e rëndësishme së veçantë që të gjithë personat, që mund të kenë kontakt me të mbijetuarit përmes aplikimit dhe procesit të verifikimit (OJQ-të, DFDIL-i dhe personeli i komisionit), të trajtohen si duhet për të drejtat e njeriut, për mënyrat e ndjeshme në aspektin gjinor të ndërveprimit me viktimat dhe për kërkesat e mbajtjes së konfidencialitetit.

2. Këshilli kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës

Këshilli Kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë ("Këshilli kombëtar") është themeluar nga Presidentja Jahjaga në mars të vitit 2014. E shqetësuar nga përpjekjet që lëvizin ngadalë deri në atë kohë, për ma-

100 Rregullorja 22/ 2015, neni 25.

sat reparative për viktimat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin dhe disa nga pikat e diskutimit, të bëra në Kuvend në procesin e hartimit dhe miratimit të ligjit nr. 04/L-172, në vitin 2013 Presidentja filloi të kërkojë mënyra përmes të cilave Presidenca mund të ofroj fuqinë e saj për ti mbështetur të mbijetuarit. Në tetor të vitit 2013, Presidentja thirri në takim një grup të mbijetuarve për të marrë informata konkrete mbi situatën dhe nevojat e tyre. Gjatë takimit, Presidentes i është kërkuar, nga shumica dërrmuese e të mbijetuarve, që t'ju ndihmohet në katër fusha të përfitimit: njohjen ligjore dhe qasjen në drejtësi; mbështetjen ekonomike dhe fuqizimin e tyre; kujdesin shëndetësor; si dhe ngritjen e vetëdijes në trajtimin e stigmës dhe diskriminimit me të cilat ata përballen. Fillet e Këshillit Kombëtar u nisen nga ky takim, dhe zyrtarisht u hap më 5 mars 2014.

Këshilli Kombëtar kishte dy tipare unike dhe shumë efektive. E para është se në përbërjen e komisionit kishte përfaqësues të institucioneve kryesore, të qeverisë dhe të shoqërisë civile, dhe komisioni gëzonte mbështetje të fuqishme nga të dyja këto sektore. Tipari i dytë i rëndësishëm ishte se i kishte katër grupe punuese të përqendruara rreth nevojave të artikuluara nga vetë të mbijetuarit. Mbështetja e fuqishme nga Presidentja, qeveria dhe shoqëria civile, së bashku me grupet e punës të fokusuar në tema të caktuara, ka rezultuar me një numër të nismave dhe arritjeve të rëndësishme.

a. Njohja ligjore dhe qasja në nisma të drejtësisë

Pak kohë pas miratimit në Kuvend, më 20 mars të vitit 2014, të ligjit nr. 04/L-172, u formua një grup punues i Këshillit Kombëtar për tu angazhuar në legjisllacionin zbatues. Grupi punues, i kryesuar nga drejtori i Zyrës ligjore të Kryeministrit, ka miratuar një qasje gjithëpërfshirëse për hartimin e rregullores, duke u konsultuar gjerësisht mbi përmbajtjen e saj. Rregullorja u miratua në dhjetor të vitit 2015 kurse hyri në fuqi në shkurt të vitit 2016. Janë duke u ndërmarrë hapat e duhur për funksionalizimin e Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës.

Grupi punues për qasje në drejtësi, i kryesuar nga Ministria e Drejtësisë, përfshinte përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Policisë së Kosovës, Misionit të Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Zyrës së Presidentit, Zyrës së Kryeministrit, organizatat e shoqërisë civile, të cilat punojnë me të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, dhe të UN Women-it. Grupi ka hartuar një plan veprimi për qasje në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, i cili identifikon pengesat që të mbijetuarit i kanë, për të pasur qasje në drejtësi, dhe i fuqizon kapacitetet e institucioneve të drejtësisë për t'u marrë me rastet e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Plani i veprimit paraqet 16 aktivitete dhe 26 veprime ose hapa që duhet të ndërmerren në drejtim të përmbushjes së tre objektivave: reformës ligjore dhe institucionale; zhvillimin e kapaciteteve të palëve të përfshira relevante; dhe mbështetja për fuqizimin e viktimave dhe ngritjen e vetëdijes publike për të drejtën e viktimave për drejtësi. Gjithashtu përmban indikatorët, kornizat kohore, si dhe institucionet përgjegjëse për të ndërmarrë veprimet. Një numër i veprimeve, të përfshira në planin e veprimit, janë ndërmarrë, duke përfshirë disa trajnime, të organizuara nga UN Women dhe EULEX-i, për ngritjen e kapaciteteve për anëtarët e Gjyqësorit, Prokurorisë dhe Policisë së Kosovës, për hetimin dhe ndjekjen penale të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Plani i Veprimit është miratuar zyrtarisht në nëntor të vitit 2015 nga Ministria e Drejtësisë, e cila do të vazhdojë zbatimin e këtij plani.

b. Aktivitetet e fuqizimit ekonomik

Organizatat e shoqërisë civile, që ofrojnë shërbime psiko-sociale dhe shërbime të tjera për të mbijetuarit kanë filluar, me grupe të vogla të të mbijetuarve, ofrimin e një shumëllojshmërie të aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura. Për disa vite Medica Kosova i ka ndihmuar gratë e prekurra nga konflikti, duke përfshirë edhe të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, me disa aktivitete që gjenerojnë të ardhura të vogla. Pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve

janë të natyrës bujqësore, duke përfshirë bletarinë, prodhimin e mjaltit, produkte të qumështit, prodhim të djathit dhe kultura bujqësore. Medica Kosova i ka ndihmuar gratë që të trajnohen dhe të kenë mundësi në zhvillimin e aftësive, si dhe e ka lehtësuar ofrimin e produkteve dhe pajisjeve të kërkuara siç janë pesticidet, lopët, bletët, kosheret e bletëve, traktorë dhe pajisje të tjera nga zyrat komunale bujqësore dhe donatorët. Disa nga pajisjet më të mëdha si traktorët, për bartjen e drurit për shitje, janë duke u përdorur në përputhje me një plan të rotacionit, duke iu siguruar qasje dhe mundësi të mëvonshme të gjenerimit të hyrave një numri të madh të grave.

Në vitet e fundit, Medica Gjakova, po ashtu i ka ndihmuar gratë e mbijetuara me aktivitete bujqësore për gjenerimin e të hyrave; QKRMT-ja së bashku me Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave kanë krijuar një punëtori të vogël të tekstilit, në të cilën të mbijetuarit kanë prodhuar sasi të vogla të veshjeve si funde dhe fustane, dhe kanë kapacitet për të bërë veshje të ndryshme dhe produkte të tjera me porosi.

Këto aktivitete të gjenerimit të të hyrave nuk kanë kaluar pa vështirësi. Qasja në të dhëna cilësore, kontroll të cilësisë, qasje në tregje për të shitur prodhimet, qasje në tokë dhe prona për ti ndërmarrë këto aktivitete mbetet sfiduese. Ofruesit e shërbimeve kanë kërkuar që ti trajtojnë këto sfida në mënyra inovative, për shembull Medica Kosova në stafin e vet e ka një agronom, për të ndihmuar me planifikimin bujqësor dhe kontrollin e cilësisë, kurse Medica Gjakova ka siguruar ndihmën e shoqatës së grave të biznesit për të këshilluar për kontrollin e cilësisë dhe teknikave të menaxhimit të biznesit të vogël. USAID-i në Kosovë e ka një pilot projekt për ti kuptuar të gjitha vështirësitë, me të cilat gratë përballen, në qasjen në tokë dhe pronë, me qëllim të trajtimit të këtyre problemeve në nivel të sistemit. Pavarësisht këtyre nismave aktiviteteve aktuale të gjenerimit të të hyrave të vogla, për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, nuk u ofrojnë atyre burime të rregullta të të ardhurave jetësore.

Nëpërmjet Këshillit Kombëtar Presidentja Jahjaga ka ndihmuar, për të përmirësuar mundësitë e gjenerimit të të hyrave, duke tërhequr fonde nga donatorët për të rritur kapacitetet e të dyja projekteve ekzistuese, dhe pilotimin e një nisme të re. Nëpërmjet Presidentes është siguruar fondi për të mbështetur një plan bashkëpunues, të themeluar nga Medica Gjakova, dhe mbështetje për projektin e tekstit të themeluar nga QKRMT-ja dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave. Financimi dhe mbështetja presidenciale ka qenë gjithashtu e rëndësishme, për zhvillimin e një nisme të re, një projekt në bashkëpunim me një subjekt privat, për të trajnuar një grup të vogël të mbijetuarve me qëllim të gjetjes së një vendi të punës për ata.

Projekti në bashkëpunim me subjektin privat ishte inovativ. Përfshinte një program trajnimi tre mujor për 20 të mbijetuar, katër prej të cilëve më vonë janë punësuar nga ky subjekt. Përfaqësuesit e organizatave dhe institucioneve të përfshira në planifikimin dhe organizimin e këtij projekti kanë dhënë komente të ndryshme. Duke qenë se shumë prej të mbijetuarve nuk jetojnë në afërsi të vendit të trajnimit, disa prej tyre shpesh vinin me vonesë dhe kohë pas kohe nuk ishin në gjendje të merrnin pjesë. Si pasojë rreth 13 nga 20 pjesëmarrës e kanë përfunduar trajnimin. Përveç kësaj, ndonëse subjekti privat nuk ka pasur obligim të punësojë të gjithë pjesëmarrësit të cilët e përfunduan trajnimin, vetëm katër prej tyre u punësuan pas përfundimit të kursit. Trajnimi ishte specifik për vendin e punës dhe është e panjohur se sa prej aftësive të zhvilluara, gjatë trajnimit, janë të transferueshme tek rolet tjera. Megjithatë është raportuar se projekti ka pasur një ndikim pozitiv tek të gjithë pjesëmarrësit, të cilët përshkruan ndjenjat e tyre të "normalizimit" duke qenë se duhej të ishin diku dhe të bënin diçka gjatë orarit të punës. Punësimi i qëndrueshëm i katër pjesëmarrësve, të mbetur në subjektin ekonomik, është raportuar të ketë qenë përvojë që iu ka ndryshuar jetën. Integrimi në një subjekt ekzistues, me fuqi të madhe punëtore e ka ndihmuar riintegrimin e të mbijetuarve. Kjo ka rezultuar në përmirësim të rëndësishëm të

gjendjes së tyre ekonomike dhe rrjedhimisht mbi statusin e tyre social dhe mirëqenien.

c. Qasja në nismat shëndetësore

Për disa vite organizatat e shoqërisë civile kanë siguruar mbështetje psikologjike dhe sociale për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, për ata të cilët i kanë kërkuar shërbimet e tyre. Të dyja si QKRMT-ja ashtu edhe Medica Gjakova, në stafin e tyre, i kanë mjekët që ofrojnë diagnostikim të përgjithshëm dhe shërbime referimi. Përveç kësaj Medica Gjakova është në gjendje të ofroj një numër të kufizuar të shërbimeve të ekzaminimit shëndetësor (kryesisht gjinekologjik) për të mbijetuarit e dhunës seksuale. QKRMT-ja ka një memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Shëndetësisë për të ofruar ilaçe, që janë në listën esenciale, për të mbijetuarit, ndonëse shpesh këto ilaçe nuk janë në dispozicion.

Nevojat shëndetësore të shumicës së të mbijetuarve janë të mëdha si dhe qasja në trajtime mjekësore dhe ilaçe mbetet e vështirë për shumicën. Presidentja Jahjaga me zell i ka adresuar nevojat më të ngutshme shëndetësore të të mbijetuarve si dhe ka kërkuar zgjidhje afatgjate për heqjen e pengesave, me të cilat përballën të mbijetuarit, gjatë qasjes në kujdesin cilësor shëndetësor. Disa iniciativa të vogla, që kanë për qëllim të ndihmojnë të mbijetuarit specifik, janë lehtësuar nga Këshilli Kombëtar gjatë viteve 2014 dhe 2015. Me mbështetjen e Këshillit Kombëtar, Medica Gjakova ka qenë gjithashtu në gjendje që të sigurojë një marrëveshje me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), për të siguruar disa furnizime mjekësore dhe produkte të higjienës për gra. Në një aspekt edhe më të rëndësishëm, TIKA dhe ambasada turke në Prishtinë/Priština, nëpërmjet objekteve mjekësore turke në Kosovë, do të ofroj një numër të caktuar të rezultateve të testit (si PAP testi dhe teste të gjakut), gjë që e rrit në mënyrë dramatike numrin e grave të cilave Medica Gjakova mund t'ju ofroj shërbime të testimit.

Duke kërkuar një zgjidhje afatgjate për problemin e qasjes në kujdesin shëndetësor që nuk po iu ofrohet të mbijetuarve, sipas ndryshimeve legislative, një zgjidhje kreative është duke u hulumtuar nga Këshilli Kombëtar. Presidenca ka negociuar një marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë për të ndryshuar rregulloren e zbatimit të ligjit për sigurime shëndetësore, në mënyrë që të përfshijë edhe të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, dhe lirimin e tyre nga participimi i kërkuar. Aspektet praktike të kësaj marrëveshje janë duke u punuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Zyra e Presidentit. Është e rëndësishme që metodat e përcaktuara, për zbatimin e kësaj marrëveshje, nuk do të çojnë në identifikimin e panevojshëm të të mbijetuarve.

d. Aktivitetet vetëdijësuese

Disa liderë të komunitetit si kryetarë të komunnave, deputetë të kuvendit, në kapacitetet e tyre individuale, ministra, persona të famshëm dhe aktivistë të komunitetit, kanë shprehur mbështetjen e tyre për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Disa zëra të shquar janë përpjekur për ta trajtuar stigmatizimin, e viktimave të dhunës seksuale, me financim dhe mbështetje për fushata duke shfrytëzuar forma kreative të artit si këngën “Heshtja e Këngës”,¹⁰¹ filmin “Tri dritare dhe një varje”,¹⁰² si dhe teatrin dhe shfaqjet në rrugë.¹⁰³

101 Kënga nga Eliza Hoxha, “Heshtja e Këngës”, video dhe ekspozita e kësaj kënge në Prishtinë janë përkrahur nga ministrja e atëhershme e Integritetit Evropian, Vlora Çitaku. Këngën mund ta gjeni në vegzën vijuese: <https://www.youtube.com/watch?v=Kv7Qhid8PhE> dhe informata më të hollësishme në: KosovoLive. Eliza Hoxha theu “Heshtjen e Kenges”, 14 maj 2014, mund ta gjeni në vegzën vijuese <http://www.kosovalive360.com/eliza-hoxha-theu-heshtjen-e-kenges.html>

102 Me regji të Isa Qosja (2015) filmi “Tri dritare dhe një varje”, Kosovë. Informatat janë në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.arpafilmfestival.com/feature-film-three-windows-and-a-hanging-2015-arpa-film-festival-selection/>; Alissa Simon, Kritikati e filmit: Tri Dritare dhe një Varje”, 9 tetor 2014. Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://variety.com/2014/film/festivals/film-review-three-windows-and-a-hanging-1201315280/>

103 Siç është edhe shfaqja teatrale “The Valley of her

Që nga themelimi i Këshillit Kombëtar është rritur numri i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijësimin duke prekur ndoshta edhe audiencë më të gjerë, për shkak të mundësive kolektive të anëtarëve të Këshillit dhe rëndësisë së Presidentit të Kosovës. Aktivitetet sensibilizuese, të ndërmarra nën patronazhin e Këshillit Kombëtar përfshijnë: teatrin e komunitetit, diskutimet në panel, shfaqjen e filmave, debatet publike dhe një instalacion artistik.

Instalacioni “Mendoj për Ty”, u mbajt në qershor të vitit 2015, nën patronazhin e Presidentes Jahjaga. Ngjarja fitoi vëmendjen lokale, rajonale dhe mbarëbotërore dhe u raportua nga të gjitha mediat kryesore botërore.¹⁰⁴ Artistja e lindur në Kosovë, Alketa Xhafa-Mripa organizoi dhurimin dhe më vonë instalimin e mijëra fustaneve dhe fundeve, si një mjet për të rritur vetëdijen dhe për të siguruar mbështetje për të mbijetuarat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Mijëra njerëz në Kosovë dhe jashtë vendit iu përgjigjen thirrjes së Presidentes për të dhuruar fustane, si një shenjë solidariteti me të mbijetuarit. Gjatë periudhës së grumbullimit të fustaneve, anëtarët e komunitetit dhe liderë të komunitetit, siç është anëtari i shquar i familjes

sufferings (Lugina e vuajtjeve të saj)” nga grupi teatral Artpolis, informata të tjera në dispozicion në vegzën vijuese: <http://kvinnatillkvinna.se/en/2011/07/04/theatre-tour-on-womens-experiences-of-war/> dhe performanca në rrugë “Ekzaminimi” nga grupi Haveit, informata të tjera në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.women-snetwork.org/?FaqlD=1&n=65>

104 Shih për shembull: Cristina Marí, “Mendoj në Ty: Shërimi kolektiv në mesin e fustanëve”, Kosovo 2.0, 11 qershor 2015. Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.kosovotwopointzero.com/en/article/1689/thinking-of-you-a-collective-healing-among-skirts>; Kate Booth, “5000 fustane kanë transformuar stadiumin e futbollit në Kosovë në një vend që e trajton dhunimin gjatë kohës së luftës”, The New York Times, 12 qershor 2015. Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://nytlive.nytimes.com/womenintheworld/2015/06/12/5000-dresses-transform-soccer-stadium-in-kosovo-to-venue-for-addressing-wartime-rape/> dhe Natalia Zaba, “Si i ka thyer, ekspozimi i fustaneve, tabutë e dhunimit gjatë kohës së luftës”, Balkan Insight, 6 qershor 2016 në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.balkaninsight.com/en/article/how-a-dress-display-broke-wartime-rape-taboos-06-06-2016>.

Jashari¹⁰⁵, kryetarë komunash, deputetë të Kuvendit, në kapacitetet e tyre individuale, ministra, ambasadorë, aktivistët të shquar dhe njerëz të famshëm shprehën mbështetjen e tyre për të mbijetuarit. Më pas fustanet janë varur nëpër tela të rrobave, në stadiumin e futbollit të Prishtinës/Priština. Instalacioni ka synuar si “nxjerrjen në shesh të rrobave të palara” ashtu edhe për të sjellë veshjet e grave, në një arenë kryesisht të dominuar nga meshkujt, si një mjet për të sjellë vëmendjen, për gjendjen e të mbijetuarve, dhe për ta nxjerrë këtë çështje jashtë shtëpisë në arenën publike.

Po aq të rëndësishme kanë qenë vizitat dhe takimet me ish-Presidenten, në cilësinë e Udhëheqëses së Shtetit. Presidentja Jahjaga është përpjekur që të jetë në dispozicion për të mbijetuarit, duke mbajtur takime gjysmë të rregullta me grupet dhe kohë pas kohe duke i vizituar të mbijetuarit në komunitetet e tyre lokale. Kjo duket të ketë pasur ndikim në statusin e shumë të mbijetuarve, brenda familjeve të tyre dhe komuniteteve lokale. Thuhet se anëtarët e familjes me krenari kanë njoftuar se gruaja nuk është në shtëpi sepse po takohet me Presidenten. Poashtu thuhet se vizitat në lokalitete jashtë Prishtinës/Priština kanë shërbyer për ngritjen e vetëdijes për nevojat që të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlihet me konfliktin, kanë në komunitet, duke hapur rrugën për dialog në komunitet dhe për një rritje të statusit social për të mbijetuarit.

105 Producentja dhe artistja e fushatës “Mendoj në Ty” u takua me Rifat Jasharin, vëllain e heroit më të famshëm të Kosovës (të cilit shpesh i referohen si babai i UÇK-së). Komenti i zotëri Jasharit ishte “më në fund ka ardhur koha për të përkrahur motrat dhe bijat tona dhe t’ju themi që nuk ishte faji i tyre.” Adem Ferizaj, “Dhunimi gjatë kohës së luftës nuk po mbahet më i fshehur në Kosovë”, *Open Democracy*, 1 korrik 2015. Në dispozicion në vegzën vijuese: <https://www.opendemocracy.net/5050/adem-ferizaj/wartime-rape-is-no-longer-kept-under-wraps-in-kosovo>; dhe Cristina Marí, “Mendoj në Ty: kolektiv në mesin e fustanëve”, *Kosovo 2.0*, 11 qershor 2015. Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.kosovotwopointzero.com/en/article/1689/thinking-of-you-a-collective-healing-among-skirts>.

B. Perspektivat e të mbijetuarve për reparacionin

Konsultimet me të mbijetuarit kanë ndodhur nga tetori i vitit 2015 deri në janar të vitit 2016. Kjo ishte një periudhë që kategorizohej me optimizëm, pasiguri dhe pakënaqësi. Për pjesën më të madhe, të mbijetuarit dukeshin si të çliruar me njohjen e dhunës seksuale që ka ndodhur gjatë konfliktit, dhe me rritjen e vetëdijesimit për thirrjet e tyre, megjithatë, ndjenjat e zhgënjimit dhe zemërimit janë shprehur edhe në ritmin e përpjekjeve për të siguruar përfitime materiale, për të mbijetuarit, dhe për mungesën e vazhdueshme të njohjes politike në Kuvend. Të mbijetuarit angazhoheshin në diskutimin e një numri temash. Perspektivat dhe zërat e tyre mbi këto tema janë të përshkruara më poshtë.

1. Heterogjeniteti i zërave dhe Agjencitë e të mbijetuarve

Të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlihet me konfliktin në Kosovë - siç do të pritej në shumë vende - nuk e ndajnë një histori të përbashkët, si dhe nuk e kanë një zë kolektiv. Shumë nga nismat e deritanishme janë bazuar në të mbijetuarit, që kanë qenë më të zëshem dhe që kanë pasur më shumë siguri në vete, si dhe nga ofruesit e shërbimeve. Në mesin e ofruesve të shërbimeve është një formë e paqartë e kolektivitetit abstrakt (kryesisht e formuar nëpërmjet Këshillit Kombëtar) megjithatë terapistë dhe profesionistë të tjerë, të angazhuar për të punuar me të mbijetuarit, nuk e ndajnë një zë kolektiv apo qasje të barabartë (gjeografike dhe politike) për të informuar vendimmarrjen qendrore. Zërat në këtë seksion janë të atyre 70 pjesëmarrësve që morën pjesë në konsultime.¹⁰⁶ Është me rëndësi të theksohet se të mbijetuarit, të lidhur me ofruesit e shërbimeve, janë po ata që janë vetëidentifikuar si viktima/ të mbijetuar të dhunës seksuale që ndërlihet me konfliktin dhe të cilët kanë kërkuar ndihmë.

Të mbijetuarit gjatë konsultimeve shprehën mirënjohjen për mbështetjen nga disa akterë të

106 Shih seksioni II. A. Metodologjia

shoqërisë civile, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime siç janë shërbimet mjekësore dhe mundësitë psiko-sociale dhe ekonomike. Megjithatë mosbesimi, ndërmjet organizatave civile, duket se ka dalur jashtë kufijve organizativ, ku disa të mbijetuar i kanë përsëritur deklaratat e pakënaqësisë që për cak kishin organizatat me të cilat ata nuk janë të lidhur. Për fat të keq, kjo ka shërbyer për të rritur mosbesimin në mesin e të mbijetuarve në vend që ata të ndihmohen që të veprojnë si kolektiv. Sidoqoftë, në kohën e shkrimit të këtij raporti nga të mbijetuarit janë duke u ndërmarrë përpjekje të përtërira, për tu lidhur me organizata të ndryshme që merren më çështjet e të mbijetuarve. Shpresohet që organizatat e shoqërisë civile, në të ardhmen, mund të jenë në gjendje të lehtësojnë më mirë ndërveprimin mes të mbijetuarve.

Pjesëmarrësit në konsultime shprehën frustrimin lidhur me atë se deri më tani angazhimi i tyre në proceset, që ndikojnë drejtpërdrejt tek ata, ka qenë i kufizuar në tregimin e përvojave të kaluara të tyre. Pengesat e tilla si mungesa e qasjes në hapësirat vendimmarrëse dhe mungesa e mjeteve krijuese, përmes të cilave pjesëmarrja mund të arrihet pa çuar në stigmë, vazhdojnë të ndodhin, siç ndodhë me izolimin dhe frikën nga dhuna.

- “Gratë këtu janë të lodhura nga e kaluara e tyre dhe duke folur në lidhje me atë të kaluar. Ato nuk duhet të merren vetëm me të kaluarën, por edhe me të ardhmen - kështu që është e shumë mirë kur ka punëtori [konsultime] si kjo”.
- “Gjithmonë, organizatat kanë folur në emrin tonë. Ne kurrë nuk kemi pasur guxim sikur veteranët e luftës të flasim publikisht dhe të kërkojmë të drejtat tona nga institucionet e tjera. Ka pasur shumë dëshmi. Shumë dokumentarë. Por ka qenë gjithmonë njëjtë, ku të mbijetuarit kanë qenë në ‘prapaskenë’. Unë kurrë nuk do të mund të shfaqesha publikisht si një veteran. Ne kurrë nuk e kishim atë guxim”.

Një numër i vogël i të mbijetuarve janë bërë udhëheqës në komunitetet e tyre. Këto gra kanë treguar se si të qenit lidere, në grupet e tyre të vogla, iu ka ndihmuar atyre dhe të tjerave.

- “[I]deja më erdhi që të jem lidere dhe të ndihmoj secilën grua në këtë kategori. Së pari, ne kemi nevojë për të pasur guximin që të mos shikojmë kurrë më prapa. Të mos pengohemi nga e kaluara, pavarësisht nga rrethanat. Në qoftë se ju shihni përpara, dhe dëshironi ti ndihmoni të tjerët nga thellësia e zemrës suaj, ju mund të kapërceni këtë gjendje.

Të mbijetuarit kërkojnë që të përfshihen në proceset që i prekin. Ata kanë nevojë që siguria dhe privatësia e tyre të mbrohen teksa veprojnë kështu. Për fat të keq, në disa raste, avokatë qëllimshëm si dhe përfaqësues të mediave kanë dështuar që ta mbrojnë identitetin e të mbijetuarve, duke çuar në zbulimin dhe dëmtimin e të mbijetuarve.

- “Nëse ne nuk avokojmë për të drejtat tona, kush do ta bëjë këtë?”
- “Çështja është se ne nuk kemi besim në shoqërinë civile/institucionet lokale Ne duam të kemi një përfaqësues tonin në Komisionin [që do të krijohet për të verifikuar të mbijetuarit]. Të gjitha kategoritë e tjera e kanë këtë përfaqësues. Pse ne nuk e kemi?”
- “Unë dua të emërojë një grua e cila do të jetë lidere e të mbijetuarve të dhunës seksuale. Vetëm një grua mund ta bëjë këtë”.

Ata duan përkrahje për ti zhvilluar rrjetet e tyre, dhe të zhvillojnë zërat e tyre. Shumë nga ata kanë kërkuar, në mënyrë specifike, organizimin e më shumë takimeve mes tyre.

- *“Një shoqatë e viktimave të dhunës seksuale që ndërlihet me konfliktin është e nevojshme. Ne do të jemi shumë më të forta dhe shumë më të sigurt. Sa më shumë shoqata të kemi, aq më mirë mund të jemi. Mungesa e vazhdimit të përparimit është për shkak*

të mungesës së parave dhe jo për shkak të mungesës së vullnetit [të të mbijetuarve]”.

- *“Gjithmonë ka bashkëpunim shumë të mirë mes grave. Ne nuk duam t’ja dijme për mosmarrëveshjet mes organizatave. Ne duhet të mendojmë me kokën tonë”.*

2. Njohja zyrtare

Njohja, përpjekjet dhe vëmendja e Presidentes Jahjaga janë pranuar dhe vlerësuar mirë nga të mbijetuarit. Shumë të mbijetuar individualisht dhe kolektivisht, tek këshilltarja, i kanë shprehur pikëpamjet pozitive për përpjekjet dhe vëmendjen e Presidentes Jahjaga. Komente të ndryshme si *“nga qeveria, vetëm Presidentja është interesuar”* ishin të zakonshme. Disa mendonin se fakti që presidenti ishte grua e ka bërë dallimin, ngase si grua ajo ishte në gjendje të kuptoj shkallën e vuajtjeve të tyre. Deklaratat si *“Ajo është një grua, ajo e kupton”* dhe *“Një grua e kupton një grua ndryshe, burrat janë tallur me ne”*, ishin të zakonshme nga të mbijetuarat.

Fundi i mandatit të Presidentes Jahjaga ka shkaktuar shqetësime në mesin e të mbijetuarve të cilët druajnë se pa mbështetjen e fuqishme të Presidentes, proceset reparative do të ngecin. Në fjalët e një të mbijetuarë, *“Ne jemi me fat të kemi presidenten grua, e cila e ka themeluar Këshillin. Pasi kemi kuptuar që mandati i saj është vetëm deri në prill, na është ngrirë gjaku”.*

Shumë të mbijetuar, veçanërisht ata që kanë qenë të përfshirë në nisma avokuese për disa vjet, ndjehen të zhgënjyer me mungesën e mbështetjes dhe njohjes nga zyrtarët e zgjedhur, veçanërisht nga ata në Kuvend. Gjatë konsultimeve, disa të mbijetuar që kanë qenë më të zëshëm e kanë shprehur fuqishëm pakënaqësinë e tyre me komentet e kuvendarëve të bëra gjatë debatit, për ndryshimet në ligjin nr. 04/L-054, rreth të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.¹⁰⁷

107 Disa nga pakënaqësitë me Kuvendin përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm në, edhe mënyrën se si është bërë diskutimi për përfshirjen në ligjin themelor numër 04/L-54. Disa nga komentet

- *“Më e keqja është njohja politike. E dyta është pozita e gruas. Barazia gjinore. Edhe pse ata thonë se ne jemi të barabartë, ne nuk e ndjejmë atë. Së treti, ata na shohin si kafshë. Ne jemi më të forta se të tjerët. Vetëm Presidentja na mbështet. Qëndrimet e komunitetit janë një problem i madh”.*

- *“Ne nuk kemi mbështetjen e Kuvendit dhe të deputetëve. Ne do të donim të shohnim mbështetjen e Kuvendit për ne”.*

- *“Ne duam njohjen nga Qeveria, si edhe [nga Kuvendi], Shteti ynë nuk na njeh; Qeveria po ashtu duhet të kërkojë falje”.*

“Unë do të ndjehesha e lehtësuar, pothuajse sikur krimi të mos kishte ndodhur, nëse qeveria jonë do të njihte atë që ka ndodhur. Kjo është ajo që më shqetëson më së shumti, fakti që ata nuk na njohin as si qenie njerëzore”.

Kërkesa më urgjente e të mbijetuarve (pas asaj për sigurimin e përfitimeve financiare nëpërmjet krijimit të Komisionit) është një njohje zyrtare dhe kërkim falje nga kuvendarët dhe nga Qeveria. Kjo është forma më e dëshiruar e reparacionit simbolik. Njohja duhet të jetë e qartë, të pranohen të mbijetuarit e të gjitha grupeve, dhe qartësisht të përforcoj faktin se ata janë viktima të konfliktit. Të mbijetuarit ishin të qartë se jo vetëm gratë shqiptare janë abuzuar seksualisht, dhe jo vetëm serbët ishin autorët: *“ne jemi dhunuar edhe nga shqiptarët, jo vetëm nga serbët! Nga romët gjithashtu. Asnjë nga ne nuk e dinte se kush ishte kush”.*¹⁰⁸

ishin të pavenda duke shprehur dyshimet për pretendimet e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin dhe të cilat komente kanë sugjeruar që të mbijetuarit të kontrollohen nga mjeku për të verifikuar nëse ata kanë përjetuar abuzim seksual. Shih: Kuvendi i Republikës së Kosovës, “Transkript i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 14, 15 dhe 19 mars 2013. Në dispozicion në vegzen vijuese: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2013_03_14_10_4805_al.pdf

108 Disa nga të mbijetuarat nuk e dinë se kush ka abuzuar seksualisht me ato, por kjo nuk ishte temë e diskutimit gjatë konsultimeve

Të mbijetuarit besojnë se një njohje e tillë do të shërbente për të forcuar të drejtën e tyre për reparacion adekuat, dhe të ndihmoj për të ndryshuar qëndrimet shoqërore ndaj tyre.

3. Komisioni dhe kompensimi

Gjatë diskutimeve në fokus grupe, Rregullorja nr. 22/2015 ka qenë në vetëm draft dhe të mbijetuarit ishin të etur për ta parë atë rregullore të miratuar zyrtarisht. Pjesa më e madhe e diskutimit, në fazat e hershme të konsultimit, u fokusua në vullnetin politik për të miratuar rregulloren dhe për të krijuar Komisionin qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, dhe të ofrohen përfitime siç kërkohet me ligj. Rregullorja që nga atëherë ka kaluar në ligj, i cili ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2016. Pasi që verifikimi nga ana e Komisionit do të siguroj qasje në një numër të përfitimeve materiale, të mbijetuarit, të cilët morën pjesë në konsultime, ishin gjithashtu mjaft të shqetësuar se vetëm “viktimat e vërteta” të njihen. Mungesa e sqarimit në lidhje me shumën që do të merret (e cila shumë do të përcaktohet me vendim të Qeverisë)¹⁰⁹ duket se e përkeqëson shqetësimin pasi që shumica kanë frikë se shuma mund të varet nga numri i të mbijetuarve të cilët aplikojnë për verifikim.

- *“Ata na thanë shkurtin e kaluar [2015] se ne do të merrnim para. Por kjo nuk ndodhi asnjëherë”.*
- *Ne të gjitha jemi të frustruara për shkak se po merr shumë kohë për të krijuar Komisionin”.*

Në kohën e finalizimit të këtij raporti, qeveria ende nuk e ka përcaktuar shumën e pensionit, që do të merret nga të mbijetuarit në përputhje me ligjin. Kjo vazhdon të shkaktoj pakënaqësi dhe ankth në mesin e të mbijetuarve dhe ofruesve të shërbimeve, të cilët mund ti përceptojnë vonesat e vazhdueshme të Qeverisë për të finalizuar përfitimet e premtuara në ligj, si një mjet për të penguar procesin. Derisa të mbijetu-

109 Ligji nr. 04/L-172, Shtojca 1; Rregullorja nr. 22/2015, neni 34.

arit nuk e kanë vënë në pikëpyetje prioritizimin e përfitimeve materiale, për veteranët dhe familjet e tyre, disa kanë theksuar se ndihma e të mbijetuarve ka qenë shumë më e ngadalshme dhe se të mbijetuarit janë në gjendje të përdorin të njëjtat taktika, si edhe veteranët, për të tërhequr vëmendjen për nevojat e tyre.

- *“Për veteranët u veprua më shpejt”.*
- *“Ne nuk mund të dalim në rrugë dhe të protestojnë sikur ata [veteranët]. Njerëzit mund të na njohin neve dhe zërat tanë”.*
- *“Unë e dua kompensim tim. Të drejtat e mia. Unë nuk dua të jetoj pa energji elektrike më. Nuk kam asgjë kundër veteranëve - ata e meritojnë atë që marrin. Por kjo kategori, është më e lënduar në shpirt e në gjak. Dhe nëse ministri ka menduar ndonjëherë për këtë kategori... Ku mbeten shpresat tona? Ku mund të gjejmë mbështetje? Ne kemi nevojë për kompensim sa më shpejt të jetë e mundur”.*
- *“Askush nuk brengoset për viktimat civile. [Ata brengosen] vetëm nëse ju keni qenë në UÇK”.*

Pjesëmarrësit në diskutimet, në grupet e fokusit, kanë shprehur gjithashtu shqetësim në lidhje me proceset e Komisionit. Ata kanë frikë se aplikimi tek Komisioni, ose përpjekja për të fituar të drejtën e tyre mund të çojnë në identifikimin e tyre publik. Shqetësimi kryesor i të mbijetuarve duket të jetë nëse personat, të cilët punojnë ose janë të ndërlidhur me punën e Komisionit, do të respektojnë konfidencialitetin. Të mbijetuarit vënë në dukje se si Kosova është një vend i vogël, mundësitë e një personi për të njohur në person tjetër janë mjaft të larta dhe është e zakonshme për të ndarë informata, që në mjedise të tjera, mund të konsiderohen konfidenciale. Për sigurinë e aplikantëve dhe besueshmërinë e Komisionit, është e rëndësishme që personat që kanë të bëjnë me Komisionin, të kuptojnë fuqitë e konfidencialitetit dhe të mbahen përgjegjës për çfarëdo shkelje të tij (siç parashikohet në ligj).

- “Ne e dimë se Komisioni nuk mund të funksionojë pa pasur informatat dhe të dhënat, por ky proces është shumë i hapur. Familjet tona mund të përfundojnë duke i ditur gjërat”.
- “Unë mendoj se njerëzit mund ta dijnë se kush janë viktimat. Edhe pse unë nuk flas, dhe ju nuk flisni, të tjerët mund të flasin.”
- “Ne nuk mund ti ndryshojmë qëndrimet e njerëzve. Nëse për 16 vjet unë e kam quajtur veten veterane atëherë kam mundur të jem krenare - ndërsa një i mbijetuar i dhunës seksuale nuk është i fuqizuar fare dhe jeton në heshtje. Edhe paratë nuk do të na japin lumturi. Por kjo do të na e lehtësojë barrën. Plagët nuk mund të shërohen.”

Disa pjesëmarrës në diskutimet e grupeve të fokusit gjitashu kanë shprehur shqetësim për atë se si ata do t’ia shpjegojnë familjeve të tyre se nga ku po vijnë paratë, të cilat ata do ti marrin si kompensim, ose si ata mund ta fshehin këtë nga familjet e tyre. Shumë frikësohen se kjo mund të çojë në identifikimin e tyre, stigmatizimin e mëtejshëm dhe dhunë potenciale. Gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 04/L-54 Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim ka pranuar dëshmi të dhunës në familje, që ndodhte, për pensionet dhe për përfitimet për të mbijetuarit e luftës dhe familjet e tyre.¹¹⁰ Është e rëndësishme që fushatat sensibilizuese në komunitet të përdoren për të thyer stigmën lidhur me dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, para, gjatë dhe pas themelimit të Komisionit dhe verifikimit të të mbijetuarve. Është thelbësore që informacionet lidhur me dënimin për dhunën në familje të shpërndahen në të njëjtën kohë, dhe që çdo keqbërës të mbahet përgjegjës.

- “Ne jemi të shqetësuar për shumë arsye. Veteranët e luftës kanë përfituar për vite me radhë. Ne jo. Edhe nëse janë vetëm 10 € që veteranët i marrin, kjo bën një dallim. Edhe në qoftë se një e mbijetuar e dhunës seksuale merr 500 € ajo turpërohet. Veteranët janë të punësuar, [ata janë] taksistë, agjentë turistik. Ata janë shumë të fuqizuar. Gjithashtu përfitimet e veteranëve merren si trashëgimi. Jo për ne”.

110 Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim, raporti për ligjin: Monitorimi i Ligjit nr. 04 /L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre (mars 2014), shqip, faqe 43; anglisht f. 89; dhe serbisht f. 136

4. Qasja në informata

Në përgjithësi të mbijetuarit e kanë të vështirë për të pasur qasje në informata, që kanë të bëjnë me kornizën ligjore, për të siguruar verifikimin zyrtar i të qenit i mbijetuar i dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, dhe me proceset që po ndërmerren për të krijuar Komisionin dhe përfitimet. Ata nuk janë të përfshirë në proceset vendimmarrëse dhe janë të kufizuar në marrjen e informatave përkatëse nga dora e dytë apo e tretë. Dezinformatat në media, në lidhje me proceset, edhe më tej e komplikon këtë sfidë dhe rrit frustrimet. Për shembull, disa raportime në media kanë cituar se pensionet mujore, për t’ju dhënë të mbijetuarve, janë caktuar kur kjo nuk ka ndodhur.¹¹¹ Përveç dezinformatave, disa të mbijetuar kohë pas kohe i kanë keqinterpretuar informacionet, për shembull, “në vitin 2015 ka pasur një lajm se ishin dhënë 24 milion euro për viktimat e dhunës seksuale” dhe se “Presidentja na premtoi në vitin 2011 se ligji do të miratohej dhe tashmë jemi gati në vitin 2017.” Keqinformimi dhe keqinterpretimi i informacioneve është një burim kryesor i pakënaqësisë me qeverinë.

- “Tashmë është bërë gati një vit prej kur një numër i organizatave na kanë vizituar me

111 Shih për shembull: Amra Zejnli, “Sa gjatë mund të mbash një sekret? Për viktimat e dhunimit të kohës së luftës në Kosovë, përgjigja është: ndoshta përgjithmonë” Radio Evropa e Lirë, 29 maj 2014, i cili raport tregon që ligji parasheh pagesë prej 400 dollarësh në muaj. Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.rferl.org/content/kosovo-war-time-rape-victims-kept-secret/25403115.html> dhe Adem Ferizaj, “Dhunimi i kohës së luftës nuk po mbahet i fshehur më në Kosovë”, 50:50 Inclusive Democracy, 1 korrik 2015, i cili raporton se ka pagesë mujore prej 350 eurosh. Në dispozicion në vegzën vijuese: <https://www.opendemocracy.net/5050/adem-ferizaj/wartime-rape-is-no-longer-kept-under-wraps-in-kosovo>

premtimin se ajo çka iu takon veteranëve, do të na përkasë edhe neve, madje edhe një kartë identiteti e një viktime. Në mars [2015], kur erdhën ata, na thanë se do ta dërgojnë çështjen në Kuvend dhe do ta bëjnë të njohur për botën... Por ku jemi tani? Politikanët nuk i përmbushin premtimet”.

Qasja në informata kërkon ofrimin e kanaleve të qarta të komunikimit, të cilave të mbijetuarit mund ti qasen, dhe në rastin më ideal, të angazhohen në komunikim të dyanshëm për ti shmangur keqinterpretimet. Ofrimi i informacionit në mënyrë sporadike përmes kanaleve joformale, në vetëm në një drejtim, i rrit gjasat e keqinformimit dhe të keqinterpretimit të asaj informate.

Të mbijetuarit po ashtu do të dëshironin të shihni përpjekje të shtuara për të shpërndarë informacione të sakta në lidhje me dhunën seksuale gjatë konfliktit. Me fjalët e një të mbijetuarë “njerëzit duhet të dinë se çfarë kemi përjetuar dhe jo të qeshin me ne, sepse edhe ne jemi njerëz, ne jemi gra”. Përveç përdorimit të mesazheve të sakta, që mund të zhvendosin turpin dhe stigmën nga të mbijetuarit tek kryesit e veprës, shumica e të mbijetuarve do kishin dëshirë të shihnin dokumentime të sakta historike të përvojave të tyre, që i japin njohje të barabartë shkëlqes së të drejtave të tyre, së bashku me shkëlqjen e të drejtave të viktimave të llojeve të tjera të dhunës. E drejta për tu kompensuar përfshin të drejtën për qasje në informata të rëndësishme lidhur me dhunimet dhe me mekanizmat e reparacionit. Është e rëndësishme që të mbijetuarve t’ju mundësohet qasje e drejtpërdrejt në informata mbi procesin e verifikimit dhe të drejtave, si dhe që informatat lidhur me dhunimet të botohen me saktësi.

5. Qasja në kujdesin shëndetësor

Një shqetësim shumë i madh për shumicën e të mbijetuarve është qasja praktike në kujdesin mjekësor dhe atë psikologjik. Të gjithë pjesëmarrësit i vlerësojnë shumë shërbimet e këshillimit, që ata, i marrin nga organizatat e shoqërisë ci-

vile: *“Organizatat lokale na kanë shpëtuar”*. Megjithatë, ata vlerësojnë se këta ofrues të shërbimeve gjithashtu kanë kufizimet e tyre. Qasja në shërbimet e kujdesit mjekësor, për rastet me kushte të rënda dhe masa parandaluese, është problematike për shkak të mungesës së pajisjeve të specializuara dhe mungesës së vendndodhjes së objekteve të tilla. Të mbijetuarit me sëmundje të rënda kanë nevojë për qasje në spitale më të mëdha në kryeqytet apo jashtë vendit. Shërbimet e incizimeve për sëmundjet e parandalueshme po ashtu janë të kufizuara. Për shembull, edhe pse në teori, gratë kanë qasje në ekzaminimet për kancerin e gjirit, në të vërtetë, ka shumë pak vende ku mund të bëhet një mamografi. Në Kosovë është vetëm një mamografi mobile, që shpesh nuk është në gjendje ti përmbush kërkesat për ekzaminime në çdo vend. Kur kjo mamografi është funksionale nuk është në gjendje ti shërbej të gjithë ato, në komunitetet rurale, që kërkojnë ekzaminime. Edhe pse pothuajse të gjithë të mbijetuarit fizikisht mund të hyjnë në një spital të përgjithshëm, mungesa e burimeve financiare në mënyrë efektive i ndalon ata nga pranimi i trajtimit mjekësor, ose mungesa e mjeteve financiare për ti siguruar ilaçet e nevojshme për trajtim. Në Kosovë aplikohet një sistem për qasje në ilaçe, që janë në listën “esenciale të ilaçeve”. Në teori, nëse ilaçi i përshkruar është në këtë listë, duhet të jetë në dispozicion pa pagesë; megjithatë, në praktikë këto ilaçe shpesh nuk janë në dispozicion dhe për këtë arsye shumë njerëz janë të detyruar ti blejnë ato nëpër farmaci private. Gjithashtu ekziston edhe një sistem i rimbursimit për ilaçet që nuk janë të disponueshme, por pak njerëz dijnë për të dhe po ashtu pak njerëz mund ti përmbushin kërkesat që duhen plotësuar (letra e mjekut dhe formularë nga zyra komunale duhet të dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë).

- “Ne duam që të mbijetuarit të kenë qasje në ilaçet e listës esenciale. Në ligjin e kujdesit shëndetësor, pensionistët me sëmundje kronike dhe sëmundje gastrointestinale janë përmendur. Ne duam që edhe ne të përfshihemi”.

- “Ne duam vizita mjekësore. Ne e dimë situatën në kujdesin shëndetësor që ofrohet nga shteti. Kushte shumë të varfra! Asgjë nuk është projektuar për ne. Por kur nuk ka trajtim të ofruar nga shteti, ne duam të kemi mundësi të shkojmë në spitalet private me një zbritje në çmimet e trajtimeve. Apo ndoshta një numër i caktuar i spitalëve private që ofrojnë këtë mundësi”.
- *“Ne duam që t’ju sigurojmë të mbijetuarve të njëjtin sigurim shëndetësor/trajtim si të veteranëve. Ne duam që të trajtohem si prioritet”*
- *“Kam pësuar lëndime të mëdha - Unë kam qenë katër herë në vit në spital. E vetmja gjë që e gëzoj është pensioni për shkak të statusit të invalidit. Në mënyrë që të marrë trajtim në spital, kam nevojë për të paktën € 150 - dhe pensioni është € 70! Më është dashur ta ndërpresë trajtimin. Dhe për të mos përmendur pagesën e vizitës tek psikologut! Ne duam që statusi jonë dhe të drejtat tona të përcaktohen”.*
- “Unë i kam lopët e mia – I shes produktet e qumështit, por ndoshta unë mund të punoj si pastruese”.
- “Unë do të doja të gatuoja ëmbëlsira si dhe të kem biznesin tim të vogël”.
- “Unë kam qenë në shkollën e mesme të mjekësisë - doja të bëhesha infermiere. Por më është dashur të kujdesem për fëmijët e mi pa burrë! Unë ende dua të punoj si infermiere”.
- “Ëndrra ime ishte të punoja me fëmijë në kopsht. Por unë nuk mund të arsimoja veten. Tani unë do të kisha një biznes, ose do të bëja çkado nëse qeveria do të më mbështeste! Unë ende dua të kem një kopsht fëmijësh”.
- Unë gjithmonë kam dashur të jem e shkolluar. Unë kam kryer shkollën fillore. Tani, në këtë moshë, unë nuk mendoj se mund të udhëtojë për në punë për shkaqe shëndetësore. Nëse do të mund të ëndërroja, do të bëhesha mjekë. Ndoshta kjo nuk është e mundur më. Ndoshta nëse do të mund të punoja në një fabrikë, do ta bëja atë. Por qyteti im është pak larg për këto... Unë do të doja të punoja me orar të shkurtuar për shkaqe shëndetësore”.
- “Unë kam shumë dëshirë të mësoj të qep me një makinë-rrobaqepësinë”.
- “Unë qep dhe kam disa të hyra të vogla, por unë do të doja që prodhimet e mia ti shes jashtë vendit. Unë do të doja të kisha kontakte për ta bërë këtë. “
- “Kënaqësia më e madhe për mua do të ishte të bëja më shumë për gratë dhe të bëjë më shumë projekte – unë dua të bëjë më shumë për gratë. Ka aq shumë tokë të lërueshme që mund të punohet. Ne kemi nevojë për mbështetje.”
- “Unë mund të bëjë gjithçka - unë do të bëja gjithçka! kam diplomuar në xxx, por ajo çfarë kam dëshiruar është zhdukur. Nuk e di nëse burri im do të më lejoj të punoj”.

6. Qasja në arsim, në trajnime dhe në mundësi punësimi

Pothuajse të gjithë të mbijetuarit, të cilët kanë marrë pjesë në konsultime, kanë dëshirë që të punojnë. Shumica e kanë aftësinë fizike për ta bërë këtë. Aspiratat e punës së të mbijetuarve janë të ndryshme, dhe kryesisht varen nga vendi i tyre i banimit (rural/urban). Këto punë përfshijnë: bujqësinë, rrobaqepësi, parukeri, bletari, zejtari, kujdesi për të moshuarit, biznes të vogël (dyqan), kultivim të barishteve, dhe të punuarit/menaxhimi në një kopsht për fëmijë (çerdhe). Pamundësia për të pasur qasje në arsim, trajnime dhe mundësi të punësimit ka pasoja negative për të mbijetuarit dhe familjet e tyre. Kjo po ashtu ka potencial për ti kaluar brezat, duke i kufizuar mundësitë dhe mbijetesën e brezave të ardhshëm.

- “Unë nuk jam e shkolluar. Kam vetëm 8 vjet shkollë fillore, por unë kam pasione të forta”.

Një numër i konsiderueshëm i të mbijetuarve kanë raportuar se kanë marrë pjesë në trajnime të shumta. Një numër shumë i vogël i tyre treguan se aftësitë, e mësuara gjatë trajnimeve, u kanë mundësuar punësim, si dhe të hyrat e gjeneruara nga punësimi ua kanë ndryshuar jetën. Shumë të tjerë kanë vënë në dukje se nuk kanë qenë në gjendje të shfrytëzojnë aftësitë, për të krijuar të hyra, që nga trajnimi. Një i mbijetuar ka raportuar se kishte kryer 14 trajnime për bërjen e djathit, por se nuk ka treg për këtë. Të mbijetuarit e angazhuar në prodhimin e punimeve artizanale dhe qepjes së rrobave, në vazhdimësi i përsërisin shpresat e tyre që të lidhen me tregjet për shitjen e mallrave të tyre.

- “Unë nuk marr ndihma sociale, edhe pse unë jam një nënë e vetme e një vajze... Burri im vdiq ... Unë kurrë nuk e kam marrë pasurinë e burrit tim. Kam qëndruar në shtëpinë e babait tim. Për fat të mirë unë e kam xx për mbështetje. Unë kam qenë me fat – kam pasur mundësi të jem në një pozitë më të mirë me makinën time të qepjes”.

Disa të mbijetuar janë të angazhuar individualisht ose kolektivisht në aktivitete të biznesit të vogël, siç janë prodhimi i mjaltës, puna bujqësore dhe rrobaqepësia/qepja. Secila prej organizatave, që ofrojnë shërbime për të mbijetuarit, në njëfarë mënyre kanë punuar me grupe të vogla të të mbijetuarve, për të zhvilluar aktivitete të gjenerimit të të ardhurave. Këto procese janë në faza të ndryshme të zhvillimit. Duke pranuar se strategjitë e fuqizimit ekonomik bien jashtë linjës së saj kryesore të aktivitetit, Medica Gjakova ka angazhuar një shoqatë lokale të biznesit të grave për të ndihmuar një grup të të mbijetuarve të themelojnë dhe të mbajnë një kooperativë. Edhe pse projekti sapo ka filluar, shpresohet që partneriteti me shoqatën e biznesit të grave, e cila ka një reputacion të gjatë në mbështetjen e grave ndërmarrëse, do ta sigurojë qëndrueshmërinë e kooperativës.

Të mbijetuarit e kanë shumë të vështirë qasjen në fonde për krijimin e bizneseve të vogla apo

zgjerimin e bizneseve ekzistuese. Pa pronë e cila mund të përdoret si kolateral, për marrjen e një kredie, shuma të mëdha të parave nuk janë në dispozicion, ndërsa thuhet se shumata e vogla, jo të siguruara, kërkojnë pagesa më të larta të interesit. Në përgjithësi, pronësia e grave në Kosovë është shumë e ulët. Vetëm 3.8 për qind e grave në Kosovë trashëgojnë pasuri të paluajtshme nga prindërit e tyre; dhe vetëm 2 për qind e grave kanë kredi kolaterale bankare, ku kolaterali është pasuria e paluajtshme.¹¹²

Qasja në grante të vogla, apo në mundësi mikrofinanciare, është po ashtu sfiduese, për shkak se në pjesën më të madhe ka mungesë të informacionit rreth programeve në dispozicion. Të mbijetuarit janë skeptik që skemat e granteve dhe mundësitë mikrofinanciare mund të jenë të arritshme. Disa sugjeruan se qasja në këto mundësi financiare bazohet në atë se kush e njeh kënd, megjithatë këto opinione më shumë mund të jenë një tregues i korrupsionit të perceptuar sesa i korrupsionit aktual, si rezultat i mungesës së informacionit dhe transparencës, lidhur me aplikimin dhe procesin e përzgjedhjes për grantet dhe mundësitë mikrofinanciare.

- “Unë do të doja të marrë kredi me një normë më të ulët të interesit. Unë e kuptoj se për grante ashtu funksionon, por ju merrni grante në Kosovë vetëm kur i njihni njerëzit”.
- “Kam marrë një kredi prej 500 eurosh dhe duhet të paguaja 750 euro”.

7. Qasja në drejtësi dhe shërbimet ligjore

Rreth 75 pë qind e të mbijetuarve, që kanë marrë pjesë në grupet e fokusit, kanë shprehur shpresat e tyre që ti shohin kryesit e veprave,

¹¹² USAID PRP Sondazhi bazë, në nivel kombëtar, mbi të drejtat pronësore në Kosovë, qershor 2015. Të dyja, edhe GIZ-i dhe USAID-i i kanë përqendruar përpjekjet e tyre në rritjen e qasjes së grave në pronë në Kosovë. Një nga katër shtyllat e tanishme, të Programit për të Drejtat Pronësore të USAID-it, ka të bëjë me nxitjen dhe lehtësimin e qasjes së grave në tokë dhe të pronësisë së grave në tokë dhe pronë të tjera.

të dhunës seksuale, të përndiqen ligjërisht. Qëndrimet e komunitetit ndaj të mbijetuarve të dhunës seksuale dhe mungesa e mbështetjes nga familja, për shumicën e tyre, mund ta bëjnë të vështirë dhënien e dëshmisë. Disa tregojnë se nëse qëndrimet e komunitetit dhe të familjes ndryshojnë, atëherë ata mund ta marrin në konsideratë edhe dhënien e dëshmisë në gjykatë. Realiteti për shumicën është se ata nuk e dinë se kush ishte autori i krimit dhe për këtë arsye ndiejnë se ka pak dobi që të angazhohen me mekanizmat e hetimit dhe të ndjekjes penale. Disa nga të mbijetuarit, që morën pjesë në grupet e fokusit, kanë dhënë deklaratat për EULEX-in, por sipas informatave, që ata i kanë, nuk është bërë asgjë me rastet e tyre.

- “Ne kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me EULEX-in – ne i dhamë dëshmitë tona – por që nga atëherë nuk kanë ndodhur shumë gjëra”.
- “Gjëja më e mirë që qeveria mund të bëjë është të bëjë një padi penale”.

Qasja në drejtësi, për zgjidhjen e çështjeve të tjera, po ashtu është një shqetësim i madh i të mbijetuarve. Qasja në shërbime ligjore, të cilat mund të ofrojnë mbështetje për mosmarrëveshjet, që kanë të bëjnë me pronën, mbështetjen e fëmijëve dhe ankesat e familjes, kryesisht është e vështirë, për shkak të mungesës së burimeve financiare. Duket se në qytetet e mëdha, ndihma ligjore është në dispozicion, megjithatë nga zonat rurale është e vështirë të ketë qasje fizike. Për shkak të këtyre nevojave, Medica Gjakova dhe Medica Kosova kanë kërkuar që të mbijetuarit, që i kanë këto nevoja, ti vendosin në kontakt me praktikuesit ligjor, të cilët mund t’ju ndihmojnë.

8. Të mbijetuarat kryefamiljare

Të mbijetuarat e dhunës seksuale, që ndërlihet me konfliktin, të cilat janë edhe nëna të vetme, të veja apo të martuara me persona me aftësi të kufizuara, përballen me vështirësi të shumta. Ato përballen me mungesë të mjeteve financia-

re për të mbështetur veten dhe familjet e tyre dhe mungesën e mbështetjes emocionale për t’u marrë me shumë sfida të jetës.

- “Djali im vuan nga [një sëmundje e rëndë]. Pesë vjet më parë i ndaluan përfitimet që ai kishte. Tani nuk marrë asgjë. Pesë vjet më parë, burri im ka vdekur. Nga fshati ndonjëherë marr bamirësi. Unë do të doja të kemi një lopë”.
- *“Unë jam mbajtësja e familjes. Burri im është vvarë. Anëtarët e tjerë të familjes kanë vdekur. Unë jam e sëmurë. Unë kam [sëmundje], kam ankthe. Nuk kam para. Dhe unë nuk kam para për të bërë kontrollë mjekësore”.*
- “Çfarë mund të bëjmë më tej, pa burra, dhe me një shumë kaq të vogël të mirëqenies sociale?”
- “Gratë, burrat e të cilave janë veteranë, marrin disa përfitime. Por ne ... asgjë!”
- “Burri im është me aftësi të kufizuara dhe është i sëmurë. Kështu që ai nuk mund të më ndihmojë. Unë i ndihmoj atij. Im bir ka xx vjet, bija ime ka xx vjet.”

Shumica e pjesëmarrësve, në fokus grupe, ishin të mendimit se të mbijetuarat, të cilët janë edhe kryefamiljare, duhet të marrin mbështetje shtesë, për shkak të vështirësive shtesë që ato i kanë shkak i situatës së tyre.

- “[Marrja e përfitimeve shtesë] është e drejtë. Ne po luftojmë për t’i ndihmuar ato”.
- “Kur burrat janë paksa të sëmurë ne jemi të humbura pa ata. Paramendoni se si ndihen ato pa burra fare”!
- “Ne nuk jemi të prekura aq keq sa ato gra që nuk kanë burra. Ato janë me të vërtetë në një pozitë shumë më të keqe” .
- “Në grupin tonë, ne i kemi dy gra, burrat e të cilave janë vvarë. Ne nuk mund tu the-

mi atyre se unë jam e lumtur që e kam një burrë”.

- “Shumica prej nesh i kemi burrat me probleme dhe të cilët nuk punojnë, por edhe përkundër kësaj është shumë më keq të jesh pa burrë”.
- “Unë jam kryefamiljarja; Unë i kam rritur fëmijët e mi pa burrin tim. Fëmija më i madh e ka një punë, tashmë barra ime është më e vogël kështu që pse dikush tjetër të mos përfitoj më shumë sesa unë?”
- “Unë pajtohem që ato, që kanë më shumë nevojë, të marrin më shumë mbështetje”.

Përafërsisht 86 për qind e vdekjeve dhe të zhdukjeve, gjatë konfliktit në Kosovë, ishin burra.¹¹³ Kjo sugjeron se gratë përbëjnë shumicën e anëtarëve të familjes të lënë pas. Duke pasur parasysh afërsinë e atyre që janë lënë pas, me vdekjen dhe zhdukjen, si dhe raportet e femrave dhe meshkujve, të cilët janë ndarë gjatë sulmeve, është e mundur se ka një përkim të konsiderueshëm, në mes të personave që kanë vuajtur nga dhuna seksuale, gjatë konfliktit, dhe të atyre që kanë mbetur prapa. Diskriminimi social dhe ekonomik me të cilin përballen të mbijetuarit e dhunës seksuale, mund të rëndohet më tej nga humbja e një anëtari të familjes.¹¹⁴

9. Të mbijetuarat me fëmijë

Të mbijetuarat me fëmijë kanë raportuar shqetësim të madh për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Asnjëra nuk kanë qenë në gjendje të kenë qasje në shërbimet mjekësore ose psikologjike për fëmijët e tyre. Një e mbijetuar tregoi se një anëtar i ri mashkull i familjes, mund

113 11, 674 burra dhe 1,874 gra (civil dhe nga forcat e armatosura) janë raportuar të vdekur ose të zhdukur gjatë konfliktit: Fondi për të drejtën humanitare, Libri i kujtimet i Kosovës 1998 -2000, Në dispozicion në vegzën vijuese: http://www.kosovomemorybook.org/?page_id=48&lang=de.

114 Grupi punues i Kombeve të Bashkuara për Zhdukjen e detyruar, Komenti i Përgjithshëm për Gratë (A / HRC / WGEID / 98/2, 14 shkurt 2013) para. 12 thekson sfidat e veçanta të grave të lëna më pas, si pasojë e zhdukjeve të detyruara.

të jetë sulmuar seksualisht, dhe se ka nevojë për kujdes psikologjik, por nuk ka ku ta dërgoj atë. Qasja në arsim, sidomos arsimimi i mesëm dhe ai terciar është i vështirë, në mos i pamundur për shumicën. Përafërsisht gjysma e fëmijëve, të pjesëmarrësve, nuk kanë qenë në gjendje të përfundojnë shkollimin për shkak të kufizimeve financiare. Si pasojë, këta fëmijë përballen me diskriminim dhe mundësi të kufizuara në jetë. Pasojat e këtyre shkeljeve vërehen në efektet mes brezave. Shumë të mbijetuar kanë shprehur ndjenjën e fajit në lidhje me paaftësinë për të siguruar jetë më të mirë për fëmijët e tyre.

- “Nëse unë nuk mund ti ndihmojë fëmijët e mi që të shkojnë në shkollë dhe në universitet, cili është atëherë qëllimi i jetës? Unë jam shumë e kujdesshme kur është fjala për shkollim. Unë nuk mund ti jap vajzës sime dhuratën e një shkollimi të mirë. Unë vetëm shpresoj që ajo të ketë një fat më të mirë se unë”.

- “Ne të gjitha kemi fëmijë. Ne të gjitha kemi nevojë për mbështetjen e qeverisë. Ne jemi shumë të kënaqura që organizatat po na ndihmojnë. Të gjitha organizatat që na bëjnë bashkë – ne jemi të lumtura. Por ajo që në të vërtetë na duhet është mbështetja e qeverisë. Ne duhet të sigurojmë përditë ushqim për fëmijët tanë! Unë kam një vajzë me nota të larta, por unë nuk mund ta përballojë që ta dërgoj në shkollim të mëtejshëm dhe më të mirë. Unë nuk mund të investoj në të. Pa pagë, asgjë në shtëpi- Si të mbijetojë?”.

- “Ata [fëmijët] kanë nevojë për qasje në kujdes shëndetësor.”

Pjesëmarrëset kanë shpjeguar se shkollimi për fëmijët është pa pagesë, por qasja në shkollat e mesme (nga klasa e dhjetë e në vazhdim) është e vështirë. Shkollat që ofrojnë klasën e dhjetë dhe më tej janë më larg dhe nevojitet transport për të pasur qasje, dhe kjo krijon shpenzime shtesë.

- “Unë kam xx fëmijë. Nëse nuk keni pagë, si mund të vazhdohet tutje? Ne nuk kemi asnjë mundësi që ti arsimojmë ata përtej klasës së nëntë”.
- “Klasa e 10 është të paktën tri kilometra larg nga shtëpia ime. Fëmijët e mi duhet të shkojnë me autobus. Për disa edhe shkolla për klasët më poshtë se klasa e nëntë është larg nga shtëpia”.
- “Vajza ime u diplomua nga shkolla e mesme xx por për shkak të mungesës së mjeteve, ajo nuk mundi të vazhdonte më tutje.”
- “Vajza ime ka studiuar xx për katër vjet, por unë nuk pata mundësi ta dërgoj në Prishtinë/Priština për të vazhduar më tej”.

Dërgimi i fëmijëve në shkollë përfshin shpenzime të tjera, të cilat të mbijetuarit nuk mund ti përballojnë. Sigurimi i veshjeve dhe resurseve të tjera, për fëmijët e tyre, mund të jetë sfidues dhe mungesa e mundësive mund të çojë në diskriminim ndaj fëmijëve të tyre.

- “[Fëmijët] e mi i shohin të tjerët në shkollë me më shumë [veshje etj]. Ata janë të tallur dhe të diskriminuar”.
- “Unë po kam probleme në shtëpi. Asgjë për të veshur, nuk ka para për ushqim - nuk mund t’ju jap atyre as nga një euro për drekë. Kështu që ata nuk duan të shkojnë më!”
- “Në xx [vend], ata na kërkuan para për ti blerë perdet e shkollës dhe për ti lyer muret.”

Të mbijetuarit gjithashtu ndjenjë keqardhje për mungesën e mundësive të punësimit për fëmijët e tyre. Kosovarët në përgjithësi kanë lidhje të forta familjare dhe familja është burimi kryesor i sigurisë. Pa mundësi punësimi, për fëmijët e tyre, siguria e të ardhmes së familjeve të tyre është e pasigurt. Disa pjesëmarrës vunë në duk-

je se fëmijët e tyre kanë kërkuar të ikin jashtë vendit, për tu liruar nga situata ku ndodhen.

- “Ka qenë me të vërtetë e vështirë për fëmijët më të rritur që të gjejnë një punë.”
- “Vajza ime e madhe është në kërkim të një pune – nuk kemi të holla që ajo ti vazhdoj studimet”.
- “Djali im dëshiron të shkojë jashtë vendit për shkak të kushteve të këqija të jetës”.

Pjesëmarrësit po ashtu shprehën shqetësimin për fëmijët e të mbijetuarve, të cilët tashmë kanë vdekur. Ata do të donin që këta fëmijë të kenë qasje në shërbimet shëndetësore, arsim dhe në mundësi të punësimit.

- “Ne gjithashtu i kemi edhe ata, të cilët kanë vdekur që nga përvojat e tyre të dhunshme. Ne do të donim që pasardhësit e tyre të kenë përfitime. Për fëmijët e tyre. Fëmijët e mitur nuk e dinë. Ne nuk guxojmë t’ju tregojmë atyre! Vetëm fëmijëve më të rritur”.

10. Frika nga dhuna dhe/ose izolimi

Frika nga dhuna dhe izolimi në shtëpi dhe/ose nga komuniteti është shumë reale për shumë të mbijetuar. Shumica frikësohen se do ti largojnë nga shtëpitë e tyre. Nuk është e zakonshme që gratë të jenë titullare të ndonjë prone, dhe ato kanë pak qasje në drejtësi nëse detyrohen të largohen nga shtëpitë e tyre. Shumë raportuan se po ngacmohen nga pjesëtarët e komunitetit, dhe në një rast nga një oficer policie. Përqeshja e fëmijëve, të të mbijetuarve, ka çuar në disa braktisje të shkollës dhe nuk kanë qenë në gjendje për t’u angazhuar me fëmijët e grup moshës së njëjtë. Të mbijetuarit gjithashtu ishin kategorik në raportimin e tyre për viktimat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, të cilët e kanë humbur jetën nga dhuna në shtëpi dhe nga vetëvrasja.

- Të mbijetuarat, në një rajon, frikësohen se mos burrat e tyre zbulojnë se ato kanë qenë të abuzuara seksualisht. Burrat e tyre mendojnë se shëndeti i tyre i lig i atribuohet stresit të konfliktit. Gratë kanë frikë se, nëse kjo zbulohet, ato do ti humbasin familjet dhe shtëpitë e tyre.
- Një pjesëmarrëse tregonte se frikësohej nga disa anëtarë të komunitetit të saj, të cilët e dinë se ajo ka pësuar abuzim seksual gjatë konfliktit. Komuniteti i saj i ka thënë asaj se nëse ajo dëshmon atëherë ata do ta vrasin. *“Dua që të më dërgojnë jashtë vendit. Unë dua të largohem”.*
- Një tjetër pjesëmarrëse tregoi për një anëtare të familjes, që është abuzuar seksualisht gjatë konfliktit, e cila i ka treguar një anëtarit tjetër të familjes së saj për këtë përvojë të hidhur. Anëtarit i familjes, i cili e ka dëgjuar rrëfimin për ngjarjen, që nga atëherë më nuk i ka folur të mbijetuaraes.

Është e rëndësishme të theksohet se disa të mbijetuara e kanë mbështetjen e fortë të burrave të tyre dhe nuk i frikësohen dhunës në shtëpi. Një numër i vogël ia atribuojnë fuqinë e tyre për t'u angazhuar, në aktivitete lobuese dhe avokuese, mbështetjes që kanë nga bashkëshortët e tyre.

- “Për mua ishte më e lehtë ngase burri im është i arsimuar. Por në disa zona, është më e vështirë për të ngritur këto çështje. Ata nuk duan të dëgjojnë për historitë e njerëzve të tjerë, e lëre më për gratë e veta! Nëse ata do ta dinin nuk do ti lejonin ato që të punojnë. Ata mund të kenë një mentalitet të tillë që vetëm për shkak të kësaj çështjeje, ata do ti mbyllnin ato në shtëpi pa asnjë mbështetje. Por ju duhet ta kuptoni këtë kategori të grave”.
- “Në fshatin tim kemi xx shtëpi. Të gjitha gratë janë të martuara. Vetëm disa prej neve jemi në gjendje të vijmë këtu. Askush tjetër nuk do të lejohej apo nuk do të guxonte! Ne jemi tallur gjithmonë, por unë e kam mbështetjen e familjes kështu që unë ndjehem në rregull”.

Stigmatizimi, izolimi dhe frika nga dhuna, janë shkaqe dhe efekte të pabarazisë dhe të diskriminimit, më të cilat përballën të mbijetuarit. Është e rëndësishme që fushatat sensibilizuese ti synojnë këto forma të pabarazisë dhe të diskriminimit. Trajnimi i profesionistëve dhe zyrtarëve, që punojnë me të mbijetuarit, është gjithashtu i rëndësishëm për të shmangur stigmatizimin e mëtejshëm.

11. Fushatat e vetëdijesimit

Temat e fushatave të vetëdijesimit kanë shkakuar reagime të përziera nga pjesëmarrësit në grupet e fokusit. Disa pjesëmarrës mendojnë se fushatat e përgjithshme sensibilizuese do të jenë të dobishme. Shumica kanë shprehur shqetësimin se fushatat mund të përkeqësojnë diskriminimin me të cilin ato përballen dhe për këtë arsye do të jetë e rrezikshme nëse kjo çon në identifikimin e të mbijetuarve.

- “Ne nuk duam ngritjen e vetëdijes duke u bazuar në tregime individuale, por nëse bëhet në terma të përgjithshëm, atëherë është në rregull. Për shembull mediat, që i transmetojnë këto fushata, ti bëjnë qytetarët të vetëdijshëm se e gjithë kjo na ka ndodhur pa vullnetin tonë.”
- “Ne kemi nevojë ti edukojmë ata se grave konflikti nuk u ka sjellë lule, por vuajtje. Dhe se të njëjtin fat mund të kenë pasur gratë apo nënat e tyre. Është shumë e vështirë, sepse në qoftë se ju prekni në nderin e një gruaje shqiptare dhe në qoftë se një kriminel abuzon seksualisht me një grua, ai ndikon direkt në nderin e familjes. Dhe kështu një burrë nuk duhet haptazi ti pranojë këto gjëra .”
- “[Fushatat] janë një problem, sepse të gjithë fëmijët tanë janë të rritur tani...fëmijët tanë mund të kenë probleme me miqtë e tyre, sepse ata mund të thonë se ai/ajo është fëmija i një gruaje që...”

Ka pasur përgjigje të përziera lidhur me atë se si aktivitetet e përgjithshme, të ngritjes së vetëdijës, mund t'ju ndihmojnë (nëse munden)

të mbijetuarve që të ndajnë përvojën me burrat e tyre ose anëtarët e tjerë të familjes. Disa ishin të mendimit, se para se t'ju tregojnë burrave të tyre, është e rëndësishme që në përgjithësi vetëdija duhet të jetë më e ngritur lidhur me këtë temë. Të tjerët ndjenin se marrja e mbështetjes, fillimisht nga familja, mund të ndihmoj në rritjen e vetëdijesimit të komunitetit, por disa vunë në dukje se ato ndjehen të papërgatitura për t'u angazhuar në këtë temë me burrat e tyre ose anëtarët e tjerë të familjes.

- “Ka disa zona në Kosovë ku burrat nuk duan t’ja dinë dhe disa gra nuk guxojnë as ta përmendin këtë përvojë”.
- “Nëse ne kemi një fushatë publike të vetëdijesimit – dhe burrat ende nuk e dinë, por janë të vetëdijshëm dhe mbështetës ndaj viktimave në përgjithësi, por pasi ata e kuptojnë se bëhet fjalë për gratë e tyre - atëherë! Ata nuk do ta miratojnë këtë. Pra fushatat mund të jenë të rrezikshme. Nëse kështu ua thonë burrave dhe ata përgjigjen keq..”

Të mbijetuarat, që e gëzojnë mbështetjen e burrave të tyre dhe të anëtarëve të familjes, në përgjithësi vunë në dukje se nëse anëtarët e familjes, ishin të përfshirë në fushatat për ngritjen e vetëdijesimit, atëherë kjo mund ti ndihmoj anëtarët e komunitetit të pajtohen me atë që ka ndodhur. Përderisa disa treguan se burrat e tyre ka të ngjarë të jenë të gatshëm për të ndihmuar, të tjerat supozuan se burrat e tyre, dhe anëtarët e tjerë të familjes, nuk do të jenë të gatshëm.

- “Edhe ata të cilët na kanë mbështetur tashmë janë lodhur prej nesh. Pa marrë parasysh se kush jeni, në fund, ju jeni një nënë dhe ju keni detyrimet familjare. Burrim mund të lodhet nga këto gjëra!”

Konsensusi i përgjithshëm, në mesin e të mbijetuarve, për fushatat e vetëdijesimit, është se ata duhet të jenë të përfshirë në hartimin e këtyre fushatave, për t’ju shmangur stigmatizimit të mëtejshëm. Dhënia e mundësisë, që të

mbijetuarit të marrin pjesë në procesin e hartimit, kërkon marrjen në konsideratë të nevojave dhe shqetësimeve të tyre. Është thelbësore që të merren masat e duhura, për ta mbrojtur sigurinë dhe privatësinë e tyre, duke mundësuar pjesëmarrjen anonime, lirimin nga detyrimet për t’u fotografuar dhe kërkesat e tjera, të cilat shpesh ndërlidhen me detyrimet e raportimit të institucioneve dhe të organizatave.

12. Përkujtimi

Përkujtimi për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin është një temë që ka krijuar rezultate të përzieria, të cilat vazhdojnë të ndryshojnë. Në diskutimet e para me të mbijetuarit, pothuajse të gjitha të mbijetuarit, që i kemi konsultuar (nëse jo të gjithë) kanë bërë shumë të qartë se nuk duan asnjë nismë, të përkujtimit, gjatë jetës së tyre. Reagime të tilla ndaj konceptit të një memoriali fizik, të dhunës seksuale të ndodhur gjatë konfliktit, ka të ngjarë që të jetë e lidhur me faktin se në Kosovë përkujtimoret janë kryesisht për personat e vdekur.

Aktualisht ekziston një memorial fizik që thuhet se i është përkushtuar të mbijetuarave të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë, statuja “Heroinat” në Pejton, Prishtinë/Priština.¹¹⁵ Megjithatë pasi që memoriali nuk e ka një pllakë të caktuar, që i shpjegon qëllimet e veta, shpjegimet se kujt i dedikohet statuja ndryshojnë, nga memorial që e përfaqëson kontributin e grave gjatë luftës, vuajtjet e grave gjatë luftës, e deri tek të mbijetuarat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, dhe cilido prej kombinimeve të përmendura më lartë. Po ashtu është e paqartë, nëse ka për qëllim ti përkujtoj gratë nga të gjitha grupet etnike, apo vetëm ato shqiptare.¹¹⁶

115 Heroinat është shumësi i fjalës heroinë në Gjuhën Shqipe.

116 Në përrurimin e memorialit, në qershor të vitit 2015, Kryeministri Isa Mustafa iu referua Heroinave si përkujtim i kontributit të grave gjatë luftës dhe “të gjitha përvojave tragjike të grave shqiptare, gjatë tmerreve të kësaj lufte, por edhe gjatë gjithë historisë sonë kombëtare”. Kryeministri Isa Mustafa, fjalimi i kryeministrit Isa Mustafa në inaugurimin e memorialit “Heroinat” në Pejton në Prishtinë/Priština,

Memoriali "Heroinat" është imazhi 3D i profilit të fytyrës së një gruaje, i realizuar nga 20.000 medalje. Sipas artistit, i cili e ka konceptuar këtë memorial, numri i medaljeve paraqet një llogaritje të përafërt të mëhershme, të numrit të viktimave të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë¹¹⁷. Hulumtimet e mëvonshme kanë treguar se metodologjia, e vlerësimet të përdorur, është e pabazë, pasi që ishte aplikuar gabimisht. Numri i viktimave të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë mbetet i panjohur.¹¹⁸

Pavarësisht se është bërë me qëllim të mirë, shumë të mbijetuara janë të pakënaqura me memorialin "Heroinat". Shumë kanë raportuar me konfuzion mbi atë se për çfarë është memoriali. "Heroinat është term shumë i gjerë, nuk mund të dini se çfarë do të thotë kjo". Disa të mbijetuara janë ndër të ofenduara me retorikën rreth këtij memoriali, sidomos kur nënkupton se dhuna seksuale është sakrificë apo kontribut për çështjen. Po ashtu janë shprehur shqetësime lidhur me atë se "Heroinat" përfaqëson vetëm gratë shqiptare, duke i përjashtuar kështu viktimat e grupeve të tjera etnike, si dhe burrat dhe djemtë që kanë pësuar dhunë seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Të tjerët e konsiderojnë ngritjen e një këso memoriali si të parakohshëm duke preferuar forma materiale të reparacioneve në vend të formave simbolike.

12 qershor 2015: Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://kryeministri-ks.net/?page=2,9,5030>.

117 Një fotografi e memorialit bashkë me përshkrimin e bërë nga artisti mund të gjindet në vegzën vijuese: <https://competition.adesignaward.com/design.php?ID=33265>.

118 UN Women në Kosovë i ka shkruar një memorandum Këshillit Kombëtar ku i përshkruan metodologjitë kërkimore, që duhet të shfrytëzohen, për të arritur vlerësimet e ndryshme të viktimave të dhunës seksuale në Kosovë (të cilat ndryshojnë nga 20,000 deri në 45,600). Hulumtimi përshkruan se si secila prej metodologjive është zbatuar gabimisht, dhe se nuk ka asnjë mënyrë për të ditur një numër paraprak, më të saktë, për momentin. Numri i vetëm i ditur është ai i të mbijetuarve të dhunës seksuale që janë vetë identifikuar, të cilët kanë kërkuar shërbime nga organizatat e shoqërisë civile njëkohësisht ose që nga konflikti, dhe ky numër në total është 767. Pa dyshim se kjo shifër jep një pamje jo të plotë pasi që shumë të mbijetuar nuk janë të gatshëm të identifikohen si të tillë: UN Women në Kosovë, dokument i pabotuar për Këshillin Kombëtar, 16 mars 2016.

Gjatë punëtorisë me të mbijetuarat, të mbajtur në prill të vitit 2016, një numër i vogël i tyre ka treguar se e mirëpresin përkujtimin në formën e memorialit "Heroinat", ose të një memoriali të ngjashëm fizik. Një e mbijetuar, e cila është në favor të konceptit të përkujtimit u ankua se "Heroinat" nuk është në një pozitë të duhur, *është lënë në errësirë, ashtu si të mbijetuarat*". Një tjetër deklaroi se *"unë do të isha krenare nëse do të kishte monument, sepse ajo që ka ndodhur është një krim dhe nuk është faji i askujt. Unë kam dëshirë të ketë një memorial të përbashkët me burrat, për shkak se kjo iu ka ndodhur edhe burrave. Ne nuk mund të ndahemi kështu"*.

Ndryshimi në qëndrime, i disa të mbijetuarave, ndaj përkujtimit dhe "Heroinat", është i rëndësishëm. Duket se të mbijetuarat nuk janë konsultuar para vendosjes së memorialit "Heroinat". Që nga konsultimi lidhur me konceptin e përkujtimit në përgjithësi, vërehet qartë se shumë kanë filluar të marrin në konsideratë, se cila do të duhej të ishte forma e duhur e përkujtimit për të mbijetuarat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Të mbijetuarat janë të paduruara dhe të afta që të marrin pjesë në diskutimet për këtë temë. Ato kërkojnë që të konsultohen, për ndërtimin e një pllake për të shpjeguar "Heroinat", dhe të çdo memoriali tjetër, që do të ndërtohet në të ardhmen apo për ndonjë formë tjetër të reparacionit simbolik.

IV. REKOMANDIMET PËR NJË PROGRAM GJITHËPËRFSHIRËS TË REPARACIONEVE PËR VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE QË NDËRLIDHET ME KONFLIKTIN NË KOSOVË

A. Për Qeverinë e Kosovës

1. Të zbatohet korniza aktuale ligjore dhe të sigurohet që Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mund të funksionoj në mënyrë efektive, efikase dhe pa diskriminim.

Rekomandimet specifike:

- a. Të ketë zotime për afatin kohor sipas të cilit Komisioni do të themelohet dhe do të jetë në gjendje të zbatoj mandatin e vet, dhe ky afat kohor t'ju komunikohet drejtpërdrejt të mbijetuarve.
- b. Të ndahet menjandë një shumë buxhetore për skemën e pensioneve të parashikuar me ligjin nr. 04/L-054 (siç është ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-172) për viktimat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.
- c. Të caktohen shuma të përcaktuara, për të mbijetuarit e dhunës seksuale, në bazë të dëmit që kanë pësuar dhe nevojave të tyre. Konsideroni një shumë shtesë për të mbijetuarat, të cilat, janë kryefamiljare dhe ato me fëmijë. Për shembull, të ofrohet një shumë e caktuar, për çdo vit, për mjete shkollore për fëmijët e tyre (për libra, stilolapsa, lapsa, uniforma).
- d. Të sigurohet që të gjithë personat, që kanë të bëjnë me punën e Komisionit dhe anëtarët e Komisionit, të trajtohen si duhet për të drejtat e njeriut, për mënyrat e ndjeshme në aspektin gjinor të ndërveprimit me viktimat dhe për kërkesat e mbajtjes së konfidencialitetit. Të siguroni përgjegjësinë dhe llogaridhënien për shkeljen e konfidencialitetit, sado e vogël që të jetë.
- e. Ti jipet prioritet ofrimit të informacionit lidhur me përfitimet dhe pranueshmërinë për njohje dhe verifikim nga ana e Komisionit. Të përdoret fushata e vetëdijesimit

që në të njëjtën kohë të adresoj stigmatizimin e të mbijetuarve dhe të parandaloj dhunën ndaj tyre.

2. Të ndryshohet dhe të plotësohet korniza aktuale ligjore për të garantuar të drejtën për reparacion, për të gjithë të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, dhe të siguroj masa reparative që mund t'ju ndihmojnë të mbijetuarve në rindërtimin e jetës së tyre.

Rekomandimet specifike:

- a. Të ndryshohet afati kohor për njohjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale që përfshijnë periudhat menjëherë para dhe pas konfliktit. Për civilët e zhdukur është propozuar afati kohor (1 janar 1998 deri me 31 dhjetor 2000).
- b. Të miratohet një definicion i dhunës seksuale që shkon përtej përdhunimit; që është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe shkresën udhëzuese të Sekretarit të Përgjithshëm.
- c. Të ndryshohet titulli i Komisionit, në versionet shqip dhe serbisht, në Ligjin nr. 04/L-172 (tani në ligjin nr. 04/054) në "Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës".
- d. Të ndryshohet Ligji nr. 04/054 neni 14 (2.6), (siç është futur nga Ligji nr. 04/L-172, neni 7), në mënyrë që versionet shqip dhe serbisht të parashohin që të gjitha viktimat, e dhunës seksuale gjatë luftës, të përjashtohen nga shkalla e invaliditetit.
- e. Të mbijetuarit dhe fëmijët e tyre të përfshihen, në kategorinë e "grupeve të rrezikuara", në Ligjin për sigurime shëndetësore duke i liruar ata nga pagesat e participimit që kërkohen sipas ligjit.

- f. Të ndryshohet neni 6 (1.3) i Ligjit nr. 04/L-054 për ti përfshirë të mbijetuarit e dhunës seksuale dhe fëmijët e tyre në mesin e personave që kanë të drejtë për kujdes shëndetësor falas në Kosovë.
- g. Të shtrihet më tej qasja në tarifatat e reduktuara të konsumit të energjisë elektrike për të mbijetuarit, të cilët përballen me vështirësi ekonomike (neni 6 (3) Ligji nr. 04/ L-054).
- h. Të sigurohet qasje, për të mbijetuarit dhe fëmijët e tyre, në programet e arsimit dhe aftësimin. Të lirohen fëmijët e të mbijetuarve nga pagesat administrative të universitetit (neni 6 (8) Ligji nr. 04 / L-054).
- i. Të shtrihet më tej dhënia e përparësisë në punësim për fëmijët e të mbijetuarve (neni 8 (1.2) Ligji nr. 04 / L-054).

3. Ti jipet prioritet njohjes së dhunës dhe vuajtjeve të të mbijetuarve dhe të përforcohen mesazhet e përkatësisë dhe dinjitetit.

Rekomandimet specifike:

- a. Të vazhdohet me njohjet publike. Të merret parasysh një njohje, në Kuvend dhe Qeveri, e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Njohja duhet të jetë e qartë dhe gjithëpërfshirëse; të pranoj keqbërjen nga të gjitha anët dhe ti njoh të mbijetuarit, e të gjitha grupeve, si viktimat e konfliktit. Të inkurajoj udhëheqësit e komunitetit që të pranojnë publikisht mbështetjen e tyre për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.
- b. Të trajtohen shqetësimet e të mbijetuarve në lidhje me memorialin "Heroinat". Të angazhohen të mbijetuarit, në një sqarim të përshtatshëm, mbi qëllimin e memorialit. Të vendoset një shenjë mbi memorial për ti shmangur keqinterpretimet e qëllimit dhe njohjen e memorialit.

4. Të sigurohet që të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin janë të përfshirë në konsultimet dhe të gjitha fazat e vendimmarrjes që i prek ata.

Rekomandimet specifike:

- a. Të sigurohet përfshirja e të mbijetuarve në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha programeve dhe politikave që i prekin ata. Vetë proceset duhet të kërkojnë që ti fuqizojnë viktimat duke prioritetizuar autonominë dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes, dhe të adaptohen me kapacitetet e tyre në zhvillim e sipër.
- b. Të sigurohet që aspekti gjinor është integruar, duke siguruar qasjen dhe pjesëmarrjen e grave në këto procese – nga hartimi i tyre deri tek zbatimi i rekomandimeve. Masat e veçanta, shpesh janë të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e plotë të grave, siç janë shtrirja në terren dhe programet informative, për rregullimin e kuotës, për të siguruar që gratë janë të përfaqësuara në këto procese në nivelet drejtuese, procedurat për mbrojtjen e sigurisë dhe dinjitetit të viktimave dhe dëshmitarëve, masa për të kompensuar për kufizimet dhe lëvizshmërinë duke përfshirë udhëtimin dhe shpenzimet e kujdesit të fëmijës, si dhe të siguruarit, që këto procese mbahen në gjuhët lokale, dhe nëse është e nevojshme edhe ofrimi i dokumenteve të identitetit për të lehtësuar pjesëmarrjen e grave.
- c. Viktimat dhe të mbijetuarit duhet të jenë në qendër të përpjekjeve të avokimit dhe të vetëdijesimit. Të mbijetuarit janë të pozicionuar më së miri për të komentuar mbi ndikimet e mundshme negative të fushatave vetëdijësuese dhe për të lehtësuar shpërndarjen efektive të porosive.

- d. Të lehtësohet qasja në informacion, në lidhje me shkeljet dhe proceset e reparacionit. Aq sa është e mundur, jipni prioritetet kanaleve të drejtpërdrejta, për t'ju mundësuar të mbijetuarve të parashtrajnë pyetje dhe të dëgjojnë me qëllim të shmangies së dezinformatave dhe keqinterpretimeve.
- e. Shmangeni përjashtimin e grupeve të marginalizuara. Duhet të bëhen përpjekje për të përfshirë të mbijetuar nga grupet etnike të romëve, ashkalinjëve, egjiptianëve, dhe të serbëve, pakica të tjera etnike, si dhe burrat dhe djemtë.
- f. Të sigurohet që procesi kombëtar i konsultimit (i udhëhequr nga Grupi Ndërmintor Punues për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtimin - GPNM BKP), për hartimin dhe zbatimin e një strategjie kombëtare të drejtësisë tranzicionale, është gjithëpërfshirës dhe se të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin të kenë hapësira të përshtatshme të angazhimit, duke përfshirë si në vijim:
 - I. Tu jipet prioritet grupeve të fokusit me vetëm gra dhe vajza
 - II. Të krijohen metoda të qasjes anonime, në procesin e konsultimit, përmes mjeteve siç janë parashtrësat me shkrim dhe ato verbale.
- g. Të sigurohet se proceset e vendimmarrjes së GPNM BKP-së janë të balancuara në aspektin gjinor.

5. Të vazhdohet edukimi i komuniteteve për dhunën seksuale

Rekomandimet specifike:

- a. Të përfshihen të mbijetuarit e dhunës seksuale, që ndërlidhet me konfliktin, në procesin e hartimit të fushatave edukative që

synojnë ngritjen e vetëdijesimit lidhur me faktet e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.

- b. Të vazhdohet me edukimin e komunitetit, rreth dhunës seksuale, dhe të nxirret në pah lidhja mes abuzimeve të kaluara dhe shkeljeve të vazhdueshme.
- c. Të inkurajohen udhëheqësit e komuniteteve që publikisht të dënojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave, dhe të tregojnë mbështetje për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, si dhe ti përforcojnë mesazhet e përkatësisë dhe dinjitetit të tyre.

6. Të lehtësohet procesi i riintegritimit social dhe ekonomik i të mbijetuarve

Rekomandimet specifike:

- a. Të krijohet një mekanizëm koordinues dhe lehtësues për të mbijetuarit që të kenë qasje në nisma, të cilat nuk i synojnë ata drejtpërdrejt, por nga të cilat mund të përfitojnë (p.sh., aktivitete për zhvillimin ekonomik, skema të granteve, arsimim dhe mundësi punësimi). Ky mekanizëm duhet të:
 - i. Të hartoj një listë aktuale (dhe ta mirëmbajë atë) të nismave dhe programeve ekzistuese nga të cilat mund të përfitojnë të mbijetuarit (qeveritare dhe jo-qeveritare), dhe ti identifikojë zbrazëtitat.
 - ii. Të inkurajohen institucionet dhe palët, që kanë programe dhe nisma të rëndësishme, për ti bërë programet sipas nevojave të të mbijetuarve, për t'ju mundësuar atyre qasjen.
 - iii. Të ofrohen këshilla, për këto institucione dhe palë të përfshira, mbi metodat përkatëse për angazhim me të mbijetuarit.
 - iv. Të lehtësohet qasja e të mbijetuarve, në programet dhe nismat ekzistuese, përmes ofrimit të informacioneve dhe lidhjes me palët e duhura.

- v. Të mbështetet dhe të lehtësohet pjesëmarrja e të mbijetuarve në hartimin e programeve dhe nismave në të ardhmen.

- vi. Të sigurohet që vendimet, në lidhje me ofrimin e programeve dhe nismave të qeverisë, ti transformojnë pabarazitë gjinore dhe diskriminimin gjinor dhe jo ti përforcojnë ato.

- b. Ti jipet prioritet përfshirjes së të mbijetuarve në strategjitë e krijimit të vendeve të punës dhe aktivitetet e zhvillimit ekonomik.

- c. Ti jipet prioritet qasjes së të mbijetuarve në kujdesin shëndetësor në dispozicion:

- i. Të sigurohet qasje e lirë në ilaçet e listës esenciale për të mbijetuarit dhe fëmijët e tyre. Të miratohet një strategji më e lehtë, për rimbursimin ose sigurimin e këtyre barnave, kur ato nuk janë në dispozicion nga ofruesit publik vendor.

- ii. Të sigurohet qasje, për të mbijetuarit, në njësitë shëndetësore të lëvizshme siç është mamografia mobile, nëpërmjet ofrimit të informacionit të duhur dhe koordinimit me ofruesit e shërbimeve që iu ndihmojnë të mbijetuarve.

- d. Të sigurohet një metodë nëpërmjet të cilës viktimat e dhunës seksuale në mënyrë anonime mund të marrin informacione dhe referime për shërbimet. Mundësitë përfshijnë dhënien e këtyre informatave nëpërmjet linjës telefonike që do të krijohet nga Komisioni, ose duke krijuar një linjë telefonike të veçantë pa pagesë, ku ofrohen informata për një grup më të gjerë, duke përfshirë edhe viktimat e dhunës seksuale dhe viktimat e dhunës në familje, si dhe të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.

- e. Ti jipet prioritet regjistrimit të tokës dhe pronës që është në pronësi të grave.

- f. Të vazhdohet me zbatimin e planit të veprimit për qasje në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, për të shpërbërë kulturën e mosndëshkimit. Të krijohet një mekanizëm monitorues për zbatimin e saj.
- g. Të veprohet me prioritet të lartë për të siguruar zbatimin e plotë të ligjeve dhe angazhimeve ekzistuese që avancojnë mbrojtjen dhe fuqizimin e grave. Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB – e cila e njohu ndikimin e ndryshëm të konfliktit mbi gratë dhe vajzat dhe e afirmoi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në zgjidhjen e konflikteve dhe rimëkëmbjen pas konfliktit, nuk është zbatuar plotësisht.

të dhunës seksuale që ndërlihet me konfliktin, dhe për ti inkurajuar ata që të regjistrohen tek Komisioni.

- b. Të bashkëpunohet në identifikimin dhe trajtimin e zbrazëtirave, të kapaciteteve të qeverisë në sigurimin e reparacioneve si në vijim:

- i. Trajtimi i çështjes së qasjes në shërbime të specializuara shëndetësore në Kosovë për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlihet me konfliktin. Në partneritet me Qeverinë e Kosovës, palët e përfshira në zhvillim mund të ndërtojnë objekte të specializuara shëndetësore, të lehtësojnë sigurimin e objekteve shëndetësore lëvizëse (siç janë njësitë lëvizëse të mamografisë), të lehtësojnë furnizimin me barna, me pajisje ose kapacitete diagnostikuese (sidomos testet seksuale dhe ato të shëndetit riprodhues), si dhe në ato objekte të trajnojnë profesionistë, për standardet ndërkombëtare të reagimit, kur ka dhunë seksuale që ndërlihet me konfliktin.

B. Për Qeverinë e Kosovës dhe institucionet jo-qeveritare dhe palët e përfshira

1. Të kërkohet sinergji ndërmjet reparacioneve dhe programeve të zhvillimit

Rekomandimet specifike:

- a. Të bashkëpunohet për të lehtësuar krijimin e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës Çlirimtare të Kosovës. Palët që merren me zhvillim mund të ndihmojnë me detyrat si më poshtë:
 - i. Në trajnimin e anëtarëve të Komisionit dhe të Sekretariatit, si dhe të personelit të qeverisë dhe të organizatave të shoqërisë civile, të cilët do të shërbejnë si pika pritëse, për formularët e aplikimit, për Komisionin lidhur me standardet ndërkombëtare të dokumentimit dhe identifikimit të dhunës seksuale që ndërlihet me konfliktin.
 - ii. Në hartimin dhe krijimin e një baze të sigurt të dhënash për Komisionin.
 - iii. Në aktivitetet sensibilizuese për të identifikuar të mbijetuarit potencial,
- ii. Të identifikohen dhe të mbështetën metodat e komunikimit dhe të ofrimit të shërbimeve për burrat dhe djemtë që janë të mbijetuar të dhunës seksuale që ndërlihet me konfliktin.
- iii. Të krijohet një sistem i bursave për fëmijët e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlihet me konfliktin.
- c. Të ketë partneritet në promovimin e strukturave vendore, që janë në dispozicion, për ti ndihmuar personat në nevojë dhe grupet e marginalizuara, dhe për ti ndihmuar të mbijetuarit që të ndërlihen me këto programe të ndihmës. Për shembull, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si

dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka skema të ndryshme të ndihmës në dispozicion, nga të cilat të mbijetuarit mund të përfitojnë. Të konsiderohet krijimi i marrëveshjeve mikro-financiare për nismat e vetëpunësimit të të mbijetuarve.

- d. Të zbatohen politika zhvillimore të cilat mund ti plotësojnë qëllimet e reparacionit dhe të fuqizojnë mesazhin e përkatësisë dhe të dinjitetit. Për shembull politikat zhvillimore të cilat përqendrohen te dhuna seksuale dhe gjinore, diskriminimin në baza gjinore dhe në pabarazinë gjinore, mund të ndihmojnë në trajtimin e diskriminimit afatgjatë dhe stigmatizimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin si dhe të grupeve të tjera të marginalizuara.

C. Për Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës Çlirimtare të Kosovës

- a. Të sigurohet që operacionalizimi i reparacioneve përmes ofrimit të përfitimeve, pas verifikimit nga Komisioni, nuk do të përjashtoj, marginalizoj, ose penalizoj gratë ose burrat.
- b. Të miratohet një definicion më i gjerë, për dhunën seksuale, që shkon përtej përdhunimit; që është në përputhje me të ligjin ndërkombëtar dhe shkresën udhëzuese të Sekretarit të Përgjithshëm.
- c. Të sigurohet konfidencialiteti i rreptë i procesit dhe punës së Komisionit. Të kërkohet llogaridhënie për shkelje të konfidencialitetit.
- d. Ti jipet prioritet sigurisë së kandidatëve që aplikojnë tek Komisioni. Të caktohet rregullorja e punës që i specifikon metodat e punës, kushtet e trajnimit, protokollet e konfidencialitetit dhe metodat për shtrirje në terren.

D. Për institucionet jo-qeveritare dhe palët e përfshira

1. Për organizatat lokale të shoqërisë civile dhe palët e përfshira

- a. Ti jipet prioritet rritjes së numrit të agjencive për të mbijetuarit. Qasjet në shërbimet rehabilituese dhe mbështetëse nuk duhet të vijnë në dëm të humbjes së agjencisë. Ndërlidhja e grave të mbijetuara të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, me grupet e grave mund të ndihmoj në këtë aspekt.
- b. Të lehtësohet pjesëmarrja e të mbijetuarve në konsultime për drejtësinë tranzicionale dhe vendimmarrjen për projekte dhe programe që i prekin ata. Pjesëmarrja duhet të përshtatet me kapacitetet në zhvillim.
- c. Të ketë lehtësim më të mirë dhe shtim të dyanshëm të ideve në mes shoqërisë civile dhe grupeve të viktimave.

2. Për bashkësinë ndërkombëtare

- a. Të ndihmohen autoritetet dhe institucionet e Kosovës me detyrimin për të siguruar reparacionet për të gjithë të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.
 - i. Të ndihmohet në plotësimin e çdo mangësie, të burimeve të identifikuar, në programin e shtetit për reparacion. Sipas kërkesës të mbështetët zhvillimi i strukturave të financimit.
 - ii. Të mbështeten projektet e infrastrukturës në zonat në të cilat të mbijetuarit nuk kanë qasje të lehtë në shëndetësi, arsim, ujë dhe në objekte sanitare.
 - iii. Të mbështeten projektet mikro-kreditore dhe aktivitetet ekonomike për të mbijetuarit në kuadër të programeve të zhvillimit.

- iv. Të mbështeten, ashtu siç kërkohet, format e tjera të zbatimit dhe zgjerimit të programit shtetëror të reparacionit (shih më lartë fushat e mundshme të bashkëpunimit në seksionin V.B.) Të bëhen përpjekje për të siguruar që të gjitha proceset janë të përqendruara në viktimën, të kenë ndjeshmëri gjinore dhe transformuese sipas natyrës.
- b. Ti jipet prioritet, të inkurajohet dhe të lehtësohet përfshirja e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në procesin e vendimmarrjes së programeve të zhvillimit. Pjesëmarrja duhet të përshtatet me kapacitetet në zhvillim.
- c. Të vazhdohet angazhimi për proceset e sundimit të ligjit si një mjet për forcimin e garancive të mospërsëritjes.
- d. Ti jipet prioritet fuqizimit të transparencës në Kosovë për të ndihmuar me rrjedhën e qartë të informacionit, rindërtimin e besimit qytetar dhe garancitë e mospërsëritjes.

3. Për UN Women:

- a. Të zhvillohen treguesit në linjë me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit për të monitoruar zbatimin e programeve të reparacionit.

SHTOJCAT

Shtojca I: Përmbledhje e nismave reparative për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë

Data	Veprimi
nëntor 2003	Medica Kosova ka mbajtur një konferencë ligjore tre ditore për krimet seksuale gjatë luftës. Kjo ishte nisma e parë publike në Kosovë për të njohur gjendjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale, që ndërlidhet me konfliktin, si dhe është kërkuar që të identifikohen pengesat në dokumentimin e kësaj dhune.
Në fillim të vitit 2005	Ombudspersoni (i atëhershëm) ndërkombëtar në Kosovë, Marek Antoni Nowick, i ka dërguar një letër Kryeministrit (të atëhershëm) të Kosovës, Ramush Haradinaj, duke kërkuar nga autoritetet e Kosovës që të marrin masa, për të siguruar, që shërbimet e duhura të jenë në dispozicion për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.
2006-2007	Medica Kosova dhe UN Women (atëherë UNFIEM) kanë avokuar për ndryshim në projektligjin, i cili i njeh viktimat civile të luftës, për ti përfshirë edhe të mbijetuarit e dhunës seksuale, që ndërlidhet me konfliktin (kryesisht gra), si një kategori të veçantë të viktimave civile.
dhjetor 2011	Është miratuar Ligji nr. 04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre. Viktimat e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin nuk janë përfshirë si kategori e veçantë e viktimave civile.
22 shkurt 2012	Një grup punues, nën patronazhin e Zyrës së Kryeministrit dhe i udhëhequr nga Agjencia për Barazi Gjinore, u themelua për të zhvilluar një Plan Veprimi për zbatimin e Rezolutës 1325 së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
8 mars 2012	Rrjeti i Grave të Kosovës – një organizatë që i mbledh bashkë mbi 90 OJQ të grave në vend, – e ka theksuar çështjen e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin gjatë përkujtimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas.
mars 2012	Grupi i Grave Deputete në Kuvendin e Kosovës ka iniciuar një rezolutë parlamentare, e cila bën thirrje për mbështetje për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, dhe i fton prokurorët vendor dhe ata ndërkombëtar për ti ndëshkuar autorët e këtyre krimeve. Si përgjigje ndaj përkujtimit të 8 marsit dhe dorëzimit të rezolutës parlamentare, ministrja (e atëhershme) e Integritimit Europian, Vlora Çitaku e ka themeluar një task forcë për dhunën seksuale dhe torturën. Çitaku gjithashtu e mbështeti një fushatë publike për të ngritur vetëdijesimin lidhur me të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.

qershor 2012	Ministrja (e atëhershme) e Integritimit European, Vlora Çitaku , deputetja (e atëhershme) Suzan Novobërdaliu, Medica Kosova, QKRMT-ja, Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin mbajtën një diskutim, mbi dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, gjë që çoi në dhënien e zotimeve, nga palët e përfshira, për të bërë përpjekje të mëtejshme për avokim.
4 qershor 2012	Grupi Punues Ndërmintor për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Partimin u krijua nën patronazhin e Zyrës së Kryeministrit.
12 shtator 2012	Është mbajtur një forum i shoqërisë civile, Dita e Hapur Globale, për ti ngritur shqetësimet e saja, tek udhëheqësia e OKB-së në Kosovë. Forumi është organizuar nga UN Women, dhe duke përfshirë gratë deputete dhe të mbijetuarit, forumi u përqendrua në nevojën e menjëhershme për të siguruar reparacion për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.
4-6 dhjetor 2012	UN Women ka mbajtur një debat dhe dy tryeza të rrumbullakëta, mbi temën e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, me palët kryesore të angazhuara në këtë proces në Kosovë, duke përfshirë institucionet e Kosovës dhe përfaqësues të EULEX-it. Tryezat e rrumbullakëta shërbyen gjithashtu si një forum, për palët e interesuara, nga Bosnja dhe Hercegovina, për të ndarë praktikën e tyre më të mira dhe mësimet e nxjerra, lidhur me të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, për të përmbushur të drejtën e tyre për reparacion. Këto aktivitete janë mbajtur në Prishtinë/Priština dhe në Gjakovë/ Đakovica.
8 mars 2013	Agjencia për Barazi Gjinore ka organizuar një tryezë të rrumbullakët, ku Ministri (i atëhershëm) i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, është zotuar për tu siguruar, që Ligji nr. 04 / L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, do të ndryshohet për të njohur ligjërisht statusin e të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.
14 mars 2013	Kuvendi i Kosovës e miratoi, në leximin e parë, projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054, i cili do të siguroj njohjen ligjore të statusit të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Amendamenti është paraqitur nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. Komisionet e ndryshme relevante të Kuvendit kanë bërë ndryshime të mëtejshme, në këtë amendament, para se i njëjti të shkoi në leximin e dytë në vitin 2014.
23 prill 2013	Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore (një grup shumë palësh i përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile, qeverisë dhe organizatave ndërkombëtare, i kryesuar nga UN Women) pas leximit të parë të amendamentit, ka organizuar një konsultim publik ndërmjet deputetëve dhe avokuesëve të çështjeve të grave dhe të shoqërisë civile. Pas këtij diskutimi, Grupi ka dërguar komentet për përmirësimin e ndryshimit tek të gjithë kuvendarët.

Vera e vitit 2013	<p>OHCHR ka botuar “Shërimi i shpirtit: Reparacioni për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin e armatosur në Kosovë” të autores Victoria S. Rames.</p> <p>Studimi ka për qëllim të nxjerrë në pah pasojat, më të përhapura, si rezultat i dhunës seksuale të kryer gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë; për të analizuar gjendjen aktuale në lidhje me reparacionet për këto krime; dhe për të nxjerrë në pah format dhe metodat më të dëshirueshme për të siguruar reparacionin, për këto krime, nga perspektiva e të mbijetuarve.</p>
29 janar 2014	<p>Qeveria e ka miratuar Planin e Veprimit, për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, me një zotim për të mbuluar 51 për qind të buxhetit për zbatimin e tij. Plani i veprimit i ka tre rezultate të synuara, duke përfshirë edhe një rezultat që përqendrohet në sigurimin e reparacionit për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin: “Të mbijetuarit e dhunës seksuale, torturës dhe formave të tjera të dhunës që ndërlidhet me konfliktin/luftën kanë qasje të përmirësuar në mbrojtje, qasje në drejtësi, rehabilitim dhe riintegrim”.</p>
5 mars 2014	<p>Presidentja (e atëhershme) e Kosovës, Atifete Jahjaga, me një dekret të veçantë presidencial, e ka themeluar Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë Luftës. Këshilli mblodhi së bashku përfaqësues të ministrive kyçe, shoqërisë civile dhe të përfaqësuesve ndërkombëtar, për të punuar drejt një reagimi të përmirësuar, më mirë të koordinuar, në trajtimin psiko-social dhe shëndetësor, në qasjen në drejtësi, njohjen ligjore, si dhe fuqizimin ekonomik për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin dhe ngritjen e vetëdijes lidhur me këtë temë.</p>
20 mars 2014	<p>Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Amendamenti ligjorish njeh statusin e të mbijetuarve të dhunës seksuale, në Kosovë, brenda periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.</p>
qershor 2014	<p>Nën patronatin e Këshillit Kombëtar, në Prishtinë/Priština u organizuan ngjarje paralele, me Samitin Global, për t’i dhënë fund Dhunës seksuale në konflikt, me qëllim të ngritjes së vetëdijes publike mbi çështjen e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.</p>
14-17 janar 2015	<p>Një takim është organizuar, për shkëmbimin e përvojave, ndërmjet anëtarëve të Këshillit dhe palëve të interesuara nga Bosnja dhe Hercegovina, me qëllim të ofrimit të kontributit në hartimin e legjislacionit sekondar, themelimin e Komisionit, si dhe procedurat për njohjen dhe verifikimin e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.</p>
16 mars 2015	<p>Një grup pune, i kryesuar nga përfaqësues të Zyrës Ligjore të Kryeministrit, duke përfshirë edhe përfaqësues të institucioneve, shoqërisë civile dhe të UN Women-it, u formua për të hartuar një rregullore për zbatimin e njohjes, të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, sipas ligjit të ndryshuar.</p>

mars – qershor 2015	Një numër i punëtorive u organizuan, me anëtarët e lartpërmendur të grupit punues, për të punuar në rregulloren që do të përcaktoj procedurat për njohjen e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, për të themeluar Komisionin relevant, dhe për të punuar në formularin e aplikimit që do ta përdor Komisioni në të ardhmen.
maj – qershor 2015	Këshilli e ka organizuar instalacionin “Mendoj për ty”, ku në tërë Kosovën, janë mbledhur mijëra fustane/funde të grave dhe janë varur në telin për tharje të rrobave, më 12 qershor, në stadiumin e Prishtinës/Priştina. Instalacioni i konceptuar dhe i realizuar nga artistja Alketa Xhafa Mripa, i prodhuar nga Anna di Lellio, ka tërhequr vëmendjen e shumë mediave vendore dhe ndërkombëtare. Mbi procesin e mbledhjes dhe të vetë instalacionit është prodhuar një dokumentar, i cili në disa raste është shfaqur brenda dhe jashtë Kosovës.
nëntor 2015	Plani i veprimit për qasje në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës është miratuar nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Këshilli Gjyqësor, si dhe nga Zyra e Presidentit. Plani i veprimit është hartuar nga grupi punues i Këshillit, për qasje në drejtësi, i kryesuar nga Ministria e Drejtësisë, si dhe me anëtarë nga institucionet, sektori i sundimit të ligjit, shoqëria civile dhe nga UN Women.
30 dhjetor 2015	Qeveria e ka miratuar Rregulloren nr. 22/2015 për Përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës. Rregullorja u nënshkrua nga kryeministri Isa Mustafa më 2 shkurt 2016.
Shkurt 2016	Kryeministri Isa Mustafa ka emëruar nëpunësit civilë, nga Zyra e Kryeministrit, si anëtarë të Sekretariatit të Komisionit, sipas dispozitave të Rregullores nr. 22/2015.
mars 2016	Zyra e Presidentit dhe Ministria e Shëndetësisë kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi. Përmes këtij memorandumi, Ministria është zotuar të bëjë harmonizimin e legjislacionit ekzistues, të intensifikoj bashkëpunimin me OJQ-të dhe të sigurojë që OJQ-të, që ofrojnë shërbime për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin, të kenë barna nga lista esenciale.
30 mars 2016	Këshilli Kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës ka mbajtur takimin përmbyllës. Ministrinë përkatëse dhe organizatat e shoqërisë civile janë zotuar për të vazhduar punën në sigurimin e reparacionit për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.

Shtojca III: Lista e palëve të përfshira që janë konsultuar

Të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin

Një numër takimesh janë mbajtur me rreth 70 të mbijetuar të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin.

Institucionet e Kosovës

Organizata ose Institucioni	Pozita në organizatë ose institucion	Emri
Agjencia për Barazi Gjinore	Udhëheqëse e departamentit ligjor	Leonora Selmani
Grupi Punues Ndërmintor për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin (GPNM BKP)	Nëngrupi për te drejtën për riparacion	Përfaqësuesit e nëngrupit
Instituti Gjyqësor i Kosovës	Ushtrues i detyrës së drejtorit, Koordinator i Programit	Besim Morina
Policia e Kosovës	Shëf i Sektorit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës	Kapiten Ramadan Ahmeti
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Drejtoreshë e departamentit për zhvillim të politikave, Udhëheqëse e Autoritetit Menaxhues	Shqipe Dema
Ministria e Shëndetësisë	Këshilltar politik i Ministrit	Dr. Valbon Krasniqi
Ministria e Drejtësisë	Këshilltare Ligjore e Ministrit	Dafina Buçaj
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Këshilltare e CDF-së për Ministrinë	Merita Gashi
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë	Udhëheqës i Sektorit për promovimin e eksportit, promovimin e sektorit privat, Drejtorja për Promovim të eksportit, sektori për promovim të eksportit	Remzi Ahmeti
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Udhëheqës i Zyrës Ligjore	Valon Kryeziu
Zyra Ligjore e Kryeministrit	Drejtor i Zyrës Ligjore	Besim Kajtazi
Zyra e Presidentit	Këshilltare Politike e ish-presidentes Atifete Jahjaga	Jeta Krasniqi
Prokuroria e Shtetit	Zëvendës Prokurore e Shtetit	Sevdije Morina
Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë	Bashkëpunëtor profesional	Baki Svirca

Organizatrat e shoqërisë civile

Organizata ose Institucioni	Pozita në organizatë ose institucion	Emri
Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave	Drejtoreshë Ekzekutive	Kadire Tahiraj
Forumi i Shërbimit Civil Paqësor – Forum ZFD	Menaxher i Programit	Nehari Sharri
Fondi për të Drejtën Humanitare	Drejtor Ekzekutiv	Bekim Blakaj
INTEGRA	Drejtor Ekzekutiv	Kushtrim Koliqi
Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës	Drejtoreshë Ekzekutive	Feride Rushiti
Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RrGGK)	Drejtoreshë Ekzekutive	Igballe Rogova
Medica Gjakova	Drejtoreshë Ekzekutive	Mirlinda Sada
Medica Kosova	Drejtoreshë Ekzekutive	Veprorë Shehu
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut- Kosovë	Drejtoreshë Ekzekutive	Edona Tolaj

Organizatat ndërkombëtare

Organizata ose Institucioni	Pozita në organizatë ose institucion	Emri
Misioni i Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX	Udhëheqës i Zyrës së Prokurorit Special të Kosovës	Jonathan Ratel
Misioni i Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX	Këshilltare Ndërkombëtare për çështje gjinore	Lina Andeer
Misioni i Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX	Prokuror, Zyra e Prokurorit Special të Kosovës	Damaré Theriot
Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale	Bashkëpunëtor i lartë, Programi për Drejtësi dhe Reparacion	Cristián Correa
Organizata Ndërkombëtare për Migrim	Zyrtar për toka, pronë dhe reparacione	Igor Cvetkovski
Organizata Ndërkombëtare për Migrim	Zyrtar për zhvillim të projektit	Patrik Shirak
Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut	Zyrtar vendor i programit	Ljubiša Baščarević
Zyra e Koordinatorit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Kosovë	Koordinator i OKB-së për Zhvillim dhe Përfaqësues i Përhershëm i UNDP-së në Kosovë	Andrew Russell
Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar	Menaxher i projektit për Programin e të Drejtave pronësore që zbatohet nga Tetra Tech	Don Cuizon

Shtojca IV: Lista e dokumenteve kyçe të konsultuara

Literaturë e përgjithshme

- Qendra për Hulimtim, Dokumentim dhe Publikim, *Raporti për Ligjin: Monitorimi i Ligjit nr. 04 / L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre* (mars 2014). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2014/03/2014-raporti-mbi-ligjin-WEB-FINAL.pdf>
- Coomaraswamy, Radhika. *(Parandalimi i konfliktit, transformimi i drejtësisë dhe sigurimi i paqes*, 2015 Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://wps.unwomen.org/~media/files/un%20women/wps/highlights/unw-global-study-1325-2015.pdf>
- Correa, Cristián. *Integrimi i zhvillimit dhe i reparacioneve për viktimat e krimeve në masë* (Universiteti i Notre Dame, 2014).
- Farnsworth, Nicole (red) Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Historia është edhe tregimi i saj: *Historia e Grave në Shoqërinë Civile në Kosovë 1980 – 2004*. (Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2008).
- Heinman, Elizabeth. *Dhuna seksuale në zonat e konfliktit: Nga bota antike deri tek epoka e të Drejtave të Njeriut* (Filadelfia, Pensilvania, Shtypi i Universitetit të Pensilvanisë, 2011).
- Human Rights Watch, *Kosovo: Kosova: Dhunimi si armë e spastrimit etnik* (2000). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.hrw.org/legacy/reports/2000/fry/index.htm#TopOfPage>
- Fondi për të Drejtën Humanitare, *Romët e Kosovës: Shënjestër e abuzimit dhe dhunës 24 mars – 1 shtator 1999*. Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.greekhelsinki.gr/english/reports/hlc-march-sept-1999.html>
- Fondi për të Drejtën Humanitare, *Libri i kujtimit i Kosovës 1998 -2000*. Në dispozicion në vegzën vijuese: http://www.kosovomemory-book.org/?page_id=48&lang=de
- Hyde, Melanie, Emma Palmer dhe Sarah Williams. *Reparacionet transformuese për dhunën seksuale dhe dhunën në baza gjinore në Dhomat e Jashtëzakonshme të gjykatave të Kamboxhias: Raporti i punëtorisë* (28 nëntor 2014). Në dispozicion në vegzën vijuese: http://www.eastwestcenter.org/sites/default/files/filemanager/Research_Program/Politics_Governance_and_Security/AIJI/Reparations%20Workshop%20Report.pdf
- Ní Aoláin, Fionnula, Catherine O'Rourke, dhe Aisling Swaine. *Transformimi i reparacioneve për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin: Parimet dhe praktika*, *Revista e Harvardit për të Drejtat e Njeriut*, vëllimi 28, botimi 1 (Korrik 2015)
- Rames, Victoria S. *Healing the Spirit: "Shërimi i shpirtit: Reparacioni për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin e armatosur në Kosovë"* (Prishtinë/Priština: OHCHR Zyra në Kosovë 2013). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.ohchr.org/Documents/Issues/Women/WRGS/PeaceAndSecurity/StudyHealingTheSpirit.pdf>
- Rubio-Marin, Ruth. "Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin dhe dhuna riprodhuese: Rregullat themelore" *Revista e grave dhe e drejtësisë William & Mary* 19(1) (2012). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://scholarship.law.wm.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1349&context=wm-jowl>
- Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar; Programi për të drejtat pronësore - studimi bazë në nivelin nacional mbi të drejtat pronësore në Kosovë, (Uashington, 2015). Në dispozicion në vegzën vijuese: <https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/1.%20National%20Baseline%20Survey%20for%20Property%20Rights%20in%20Kosovo.pdf>

Legjislacioni i Kosovës

Vendimi nr. 03/77 draft vendimi për themelimin e Grupi Punues Ndërminstoror për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin (GPNM BKP) (4 qershor 2012).

Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.recom.link/wp-content/uploads/2012/06/Decision-on-the-establishment-of-Inter-Ministerial-Working-Group-on-Dealing-with-the-Past-and-Reconciliation1.pdf>

Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve zyrtare (27 korrik 2006). Në dispozicion në vegzën vijuese: http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/2006_02-L37_per_Perdorimin_e_Gjuheve_Zyrtare.pdf

Ligji nr. 04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre (8 dhjetor 2011). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20statusin%20e%20deshmoreve.pdf>

Ligji nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre (20 mars 2014). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-172%20sh.pdf>

Rregullorja nr. 18/2014 për punën e Grupit Punues për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtimin (7 nëntor 2014). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://gzk.rks-gov.net/Act-DocumentDetail.aspx?ActID=10501>

Rregullorja nr. 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës (20 shkurt 2016). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/>

[docs/Rregullore_\(QRK\)_nr__222015__per_percaktimin_e_procedurave_per_njohjen_dhe_verifikimin_e_statusit_te_viktimave_te_dhunes_seksuale_gjate_lufte.pdf](docs/Rregullore_(QRK)_nr__222015__per_percaktimin_e_procedurave_per_njohjen_dhe_verifikimin_e_statusit_te_viktimave_te_dhunes_seksuale_gjate_lufte.pdf)

Dokumentet Zyrtare të Kombeve të Bashkuara

Kombet e Bashkuara veprimi kundër dhunës seksuale në konflikt. *Korniza analitike dhe konceptuale e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin*. Maj 2011.

Kombet e Bashkuara, Komiteti kundër torturës. Komenti i Përgjithshëm nr. 3. 19 nëntor 2012. CAT/C/GC/3.

Kombet e Bashkuara, Komiteti për Eliminimin e diskriminimit ndaj grave (CEDAW). Rekomandimi i përgjithshëm nr. 30 për gratë në parandalimin e konfliktit, situatat e konfliktit dhe të pas konfliktit. 18 tetor 2013. CEDAW/C/GC/30.

Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme. Parimet dhe udhëzimet themelore për të drejtën për zgjidhje efektive dhe riparacion për viktimat e shkeljeve të rënda sipas Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, dokument i OKB-së. 21 mars 2006. A/RES/60/147.

Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme. Konventa kundër torturës dhe trajtimeve të tjera mizore në njerëz apo trajtim degradues apo ndëshkim. 10 dhjetor 1984.

Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme. Konventa mbi të drejtat e fëmijës, Asambleja e përgjithshme. 20 nëntor 1989.

Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme. Raporti i Raportuesit Special për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, riparacionit dhe për garancitë e mospërsëritjes. Pablo de Greiff. 23 tetor 2014. A/69/518.

- Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme. Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike. 23 mars 1976. A/RES/2200A(XXI).
- Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme. Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial. 21 dhjetor 1965. A/RES/2106(XX).
- Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme. Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë. 20 dhjetor 2006. A/RES/61/177.
- Kombet e Bashkuara, Komisioni i Drejtave të Njeriut. Komenti i përgjithshëm nr. 31: Natyra e obligimit të përgjithshëm ligjor që u ngarkohet shteteve anëtare të konventës. 29 mars 2004. CCPR/C/21/Rev.1/Add.13.
- Kombet e Bashkuara, Këshilli i Drejtave të Njeriut. Raporti i Raportuesit Special për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, reparacionit dhe garancive për mospërsëritje, për Këshillin e të Drejtave të Njeriut, Pablo de Greiff. 9 gusht 2012. A/HRC/21/46.
- Kombet e Bashkuara, Këshilli i Drejtave të Njeriut. Grupi punues për zhdukjet me forcë. Komenti i përgjithshëm rreth Gratë e ndikuara nga zhdukjet me forcë, miratuar nga Grupi punues për zhdukjet me forcë ose zhdukjet jo vullnetare. 14 shkurt 2013. A/HRC/WGEID/98/2.
- Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit. Rezoluta 1325. 31 tetor 2000. S/RES/1325.
- Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit. Rezoluta 1820. 19 qershor 2008. S/RES/1820.
- Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit. Rezoluta 1960. 16 dhjetor 2010. S/RES/1960.
- Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit. Rezoluta 2106. 26 qershor 2013. S/RES/2106.
- Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit. Rezoluta 2122. 18 tetor 2013. S/RES/2122.
- Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit. Rezoluta 2242. 13 tetor 2015. S/RES/2242.
- UN Women. *Raporti nga takimi i Grupit të ekspertëve të UN Women për Parandalimin e dhunës kundër grave dhe vajzave*. 20 shtator 2012. EGM/PP/2012/Report.
- Kombet e Bashkuara. *Shkresa udhëzuese e Sekretarit të përgjithshëm për reparacionet nga dhuna seksuale që ndërlidhet me konfliktin*. Qershor 2014.
- Kombet e Bashkuara. *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*. 10 dhjetor 1948.

Lajmet dhe Mediat

Booth, Kate. "5000 fustane kanë transferuar stadiumin e futbollit në Kosovë në një vend që adreson dhunimin gjatë kohës së luftës", *The New York Times*, (11 qershor 2015). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://nytlive.nytimes.com/womenintheworld/2015/06/12/5000-dresses-transform-soccer-stadium-in-kosovo-to-venue-for-addressing-wartime-rape/>

Carlman, Åsa. "Turne teatrore për përvojën e gravenëluftë". *Kvinnatillkvinna* (24 prill 2013). <http://kvinnatillkvinna.se/en/2011/07/04/theatre-tour-on-womens-experiences-of-war/>.

Ferizaj, Adem, "Dhunimi gjatë kohës së luftës nuk po mbahet më i fshehur në Kosovë", *Open Democracy*, (1 korrik 2015). Në dispozicion në vegzën vijuese: <https://www.opendemocracy.net/5050/adem-ferizaj/wartime-rape-is-no-longer-kept-under-wraps-in-kosovo>

Haveit, performanca grupe rrugore. "Examination - ekzaminimi." Në dispozicion në vegzën vijuese:

- <http://www.womensnetwork.org/?-FaqeID=1&n=65>
- “Memoriali ‘Heroinat’ nga Ilir Blakçori”. Dizajni, shpërblimi dhe gara (26 shkurt 2014). Në dispozicion në vegzën vijuese: <https://competition.adesignaward.com/design.php?ID=33265>
- Hoxha, Eliza. “Heshtja e Kangës.” (16 maj 2014). Në dispozicion në vegzën vijuese: <https://www.youtube.com/watch?v=Kv7Qhid8PhE>
- Konushevci, Arton. “Rrëfimi i një burri, viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë” (23 mars 2016). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.evropaelire.org/a/27630991.html>
- Kosovalive. “Eliza Hoxha theu ‘Heshtjen e Kënges’” (14 maj 2014). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.kosovalive360.com/eliza-hoxha-theu-heshtjen-e-kanges.html>
- Mari, Cristina. “Mendoj në Ty: Shërim kolektiv në mesin e fustanëve”, Kosovo 2.0, 11 qershor 2015. Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.kosovotwopointzero.com/en/article/1689/thinking-of-you-a-collective-healing-among-skirts>
- Qosja, Isa. *Filmi “Tri dritare dhe një varje”* (2015). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.arpafilmfestival.com/feature-film-three-windows-and-a-hanging-2015-arpa-film-festival-selection/>
- Simon, Alissa. Kritikë e filmit: *Three Windows and a Hanging*,” *Variety* (9 tetor 2014). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://variety.com/2014/film/festivals/film-review-three-windows-and-a-hanging-1201315280/>
- Smith, Helena. “*Foshnjat e viktimave të dhunimit e paguajnë çmimin e luftës*”. *The Guardian* (16 prill 2000). Në dispozicion në vegzën vijuese: <https://www.theguardian.com/world/2000/apr/16/balkans>
- Testa, Andrew, “*Përfundimi i luftës në Kosovë*” *New York Times* (9 dhjetor 2007). Në dispozicion në vegzën vijuese: http://www.nytimes.com/packages/html/world/20071209_KOSOVO_FEATURE/index.html
- Gjykata e grave – qasje feministe në drejtësi (2012). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.zenskisud.org/en/index.html>
- Zejneli, Amra. “Sa gjatë mund të mbash një sekret? Për viktimat e dhunimit të kohës së luftës në Kosovë, përgjigja është: Ndosh-ta përgjithmonë,” *Radio Free Europe* (2014). Në dispozicion në vegzën vijuese: <http://www.rferl.org/content/kosovo-wartime-rape-victims-kept-secret/25403115.html>

UN WOMEN ËSHTË ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA, PUNA E SË CILËS I DEDIKOHET BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMIT TË GRAVE. NJË KAMPI- ON GLOBAL PËR GRATË DHE VAJZAT, UN WOMEN ËSHTË THEMELUAR PËR TË PËR- SHPEJTUAR PROGRESIN DREJT PLOTË- SIMIT TË NEVOJAVE TË TYRE NË MBARË BOTËN.

UN Women përkrah shtetet anëtare të OKB-së përdorin ato vendosin standardet globale për arritjen e barazisë gjinore, dhe punon me qeveritë dhe shoqërinë civile për të hartuar ligjet, politikat, programet dhe shërbimet e nevojshme për zbatimin e këtyre standardeve. UN Women mbështet pjesëmarrjen e barabartë të grave në të gjitha aspektet e jetës, duke u përqëndruar në pesë fusha prioritare: rritja e udhëheqjes dhe pjesëmarrjes së grave; dhënia fund dhunës ndaj grave; angazhimi i grave në të gjitha aspektet e proceseve të paqes dhe sigurisë; fuqizimi i mëtutjeshëm ekonomik i grave; dhe bërja e çështjes së barazisë gjinore një çështje kyçe në planifikimin dhe buxhetimin e zhvillimit kombëtar. UN Women gjithashtu bashkërendon dhe nxit punën e sistemit të OKB-së në avancimin e barazisë gjinore.



UN Women zyrja në Kosovë
rr. Hyzri Talla 26/1
10000 Prishtinë
Kosovë

Tel: +381 38 554 645
www.unwomen.org
www.facebook.com/unwomen
www.twitter.com/un_women